



KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

RAPORT VJETOR 2021

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE.....	4
2. KUADRI LIGJOR MBI BARAZINË DHE ANTIDISKRIMINIMIN.....	5
2.1 Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.....	5
2.1.1 Instrumentet në kuadrin e OKB-së	5
2.1.2 Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës	8
2.1.3 Standardet e Bashkimit Evropian	10
2.1.4 Kuadri Ligjor Shqiptar	11
2.2 Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funkcionimin e KMD.....	25
2.2.1 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative e tij	25
2.2.2 Zyra e KMD	26
2.2.3 Kompetencat e Komisionerit	26
3. VEPRIMTARIA NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMI I BARAZISË.....	29
3.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit.....	29
3.2 Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	29
3.3 Proçedura e shqyrtimit të ankesave.....	29
3.3.1 Çështjet e trajtuara nga KMD, gjatë vitit 2021.	30
3.3.2 Ankesat	31
3.3.3. Ankuesit.....	32
3.3.4 Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së).....	34
3.3.5 Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive	34
3.3.6 Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara	35
3.3.7 Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.	36
3.3.8 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.	37
3.3.9 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.....	38
3.3.10 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.	39
3.3.11 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.	40
3.4 Vendimet sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat	41
3.5 Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve	43
3.5.1Vendimet e çështjeve me shkak racën	43
3.5.2 Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar	44
3.5.3 Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike	45
3.5.4 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike	45
3.5.5 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore	46
3.5.6 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen arsimore.....	47
3.5.7 Vendimet e çështjeve me shkak moshën.	48
3.5.8 Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.	49
3.5.9 Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.	50
3.5.10 Vendimet e çështjeve me shkak orientimin seksual, identitetin gjinor, karakteristikat e seksit.	50
3.5.11 Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.	51
3.5.12 Vendimet për konstatimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe diskriminimit ndërsektorial	52

3.6 Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara	53
3.7 Proçeset Gjyqësore	55
3.7.1 Pjesëmarrja në proçeset gjyqësore	55
3.7.2 Vendime Gjyqësore	57
3.8 Rekomandime të Zyrës së KMD	64
3.8.1 Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore	65
3.8.2 Rekomandime për çështje të veçanta	71
3.8.3 Kontribute të tjera të KMD-së	72
3.9 Ndërgjegjësimi	74
3.9.1 Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media	75
3.10 Veprimtaria monitoruese e KMD	83
3.10.1 Projekte	83
3.10.2 Publikime të KMD	86
3.10.3 KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë.....	92
3.10.4 Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstitucionale.....	93
3.10.5 Trajnime dhe Webinare.....	95
3.11 Programi i transparencës	96
4. ZYRAT RAJONALE	97
4.1 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër	97
4.2 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë	113
4.3 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier	126
5. ASPEKTE TË SHËRBIMEVE	142
5.1 Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2021	142
5.2 Menaxhimi i burimeve financiare	144

1. Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Referuar nenit 26, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, si dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e 6 mujorit të parë të vitit të veprimtarisë institucionale.

Raporti përfshin analizë të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përgjithësi, si dhe puna e Komisionerit dhe Zyrës janë reflektuar me qëllim njohjen dhe informimin me veprimtarin konkrete të ushtruar, sipas fushës së kompetencës që mbulon.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Vlerësimet dhe Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2020”, kanë përbërë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Nisur nga përpjekjet e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe vullnetit pozitiv të treguar në përf forcimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim garantimin sa më efektiv të parimit të barazisë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi individual dhe i strukturuar, uroj një vazhdimësi të përhershme dhe të përditshme të këtij impenjimi të Kuvendit me të gjitha institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë të gjithanshme dhe kërkojnë një aktivizëm të të gjithë aktorëve publikë dhe shoqërorë në promovimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, si instrumente vitale në gëzimin me dinjitet të të gjitha të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventave Ndërkombëtare.

Shpreh besimin e plotë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjithë subjekteve në ndreqjen e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit, duke garantuar përfshirjen pa rezerva të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë sfidë dhe detyrë publike dhe qytetare.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA

2. Kuadri ligjor mbi barazinë dhe antidiskriminimin

2.1 Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

2.1.1 Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument *“soft law”*, ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave. DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta ...”*. Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Në nenin 7 kemi *“të drejtën për barazi përpara ligjit”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹, parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991². Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

¹ Ligji Nr. 7510 date 08.08.1991.

² Ligji Nr. 7511 date 08.08.1991.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³ (CRPD) është miratuar në 13 Dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 Maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012⁴. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010.

KDPAK ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të.

Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë.

Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7, që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵ (CEDAW), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993⁶. Ndërsa Protokolli Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh., në vitin 2003⁷.

Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit “*diskriminim ndaj grave*” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të

³ Convention on the Rights of Persons with Disabilities.

⁴ Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012.

⁵ Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women.

⁶ Ligji Nr. 1769, date 09.11.1993.

⁷ Ligji Nr. 9052, date 17.04.2003.

lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshtetimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t'i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t'u siguruar, mundësitë për të përfutur shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa për dhunën dhe ngacmimin, 190, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me Ligjin Nr. 13/2022. Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojë punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qoftë privatë apo publikë, si në ekonominë formale, edhe në atë joformale, dhe qoftë në zonat urbane apo rurale.

Me ratifikimin e saj shteti shqiptar, merr përsipër detyrimin për të miratuar ligje, rregullore dhe politika që garantojnë të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim në punësim dhe profesion, duke përfshirë për punëtoret femra, si dhe për punëtorët dhe personat e tjerë që i përkasin një ose më shumë grupeve të prekshme ose grupeve në situata të prekshmërisë që preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës. Njëkohësisht duhet të garantojë që dispozitat mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare, marrin parasysh instrumentet e barazisë dhe mosdiskriminimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë Konventën për Shpërblimin e Barabartë (Nr. 100) dhe Rekomandimin (Nr. 90), 1951 dhe Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesione) (Nr. 111) dhe Rekomandimin (Nr. 111), 1958, si edhe instrumente të tjera përkatëse.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸, ka përcaktuar në Preambulën e saj se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”*.

⁸ Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993.

Sipas kësaj Konvente, “*diskriminimi racial*” nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1).

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore.

Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5).

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁹, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992¹⁰.

Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve pale që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinionëve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.

Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së “*Për të Drejtat e Fëmijëve*”, Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet të Armatosur¹¹ dhe Protokolli Opsional i Konventës Së OKB-së “*Për të Drejtat e Fëmijëve*”, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë¹².

2.1.2 Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, legjislacioni për trajtimin e barabartë duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi,

⁹Convention on the Rights of the Child.

¹⁰Ligji datë 27.02.1992.

¹¹Ratifikuar me Ligj Nr. 9833, datë 22.11.2007.

¹²Ratifikuar me Ligj Nr. 9834, datë 22.11.2007.

midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë.

Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si aksesin në mallra dhe shërbime, strehimi, arsimi, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është nënshkruar në Romë me 4 Nëntor 1950 dhe hyri në fuqi me 3 Shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996¹⁴.

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, *“ndalimi i diskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”*. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollin e saj shtesë.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në Nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 Prill 2005i, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar). Në nenin 1 *“ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit”*, sanksionohet në mënyrë të shprehur se: *“Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër”* dhe se *“Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1”*.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar¹⁵, e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

¹³KEDNJ u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut.

¹⁴Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", i ndryshuar.

¹⁵Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999¹⁶, ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t'u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹⁷ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

2.1.3 Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislative, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislative për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë "barazisë". Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për *çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionin politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, mosha ose orientimi seksual*.

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

¹⁶Ligji Nr. 8496, date 03.06.1999.

¹⁷Ligji Nr. 104 date 11.08.2012 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje".

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyt me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19 i **Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian** (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin *në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual*. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës” 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe **identiteti gjinor**.

2.1.4 Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe në nenin 18/2, *“Parimi i mosdiskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”*.

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes Ligjit Nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”*, duke sanksionuar, në nenin 134, se: *“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”*.

Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përafruar plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”*, Direktivën 2000/78/KE për *“Përcaktimin e një kuadri të 12 përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”*, Direktivën 2004/113/KE për *“Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”* dhe Direktivën 2006/54/KE për *“Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”*.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi. Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij

ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë¹⁸, ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët¹⁹.

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me: a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloji dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë; b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë; c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën; ç) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruara nga këto organizata.

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimit të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërblim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: “1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e

¹⁸Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.

¹⁹Ndryshuar me Ligjin Nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”;

Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësive të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar.”* etj.

Kodi Penal²⁰ ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se: *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijojnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”*

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor²¹.

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, *“Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”*. Nevoja për ndryshime në Kodin Penal është ende prezente, Komisioneri ndër vite ka rekomanduar heqjen e termit *“marrëdhënie homoseksuale”* që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale. Shprehja *“marrëdhënie homoseksuale”* përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të të njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye,

²⁰Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; ndryshuar në vitin 2017.

²¹Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me Ligjin Nr. 144/2013, datë 02.05.2013.

marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet këtyre veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtjen e neneve të mësipërme termin *“marrëdhënie homoseksuale”*.

Kodi i Familjes²². Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesë është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtit seks nuk janë ende të pranueshme. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurave Administrative²³ parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë” dhe “3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me mjetet e kërkimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar shprehimisht se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Kodi i Procedurës Civile. Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 98, datë 5 Maj 2017, kanë hyrë në fuqi në Nëntor 2017.

KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, në Kreun VI *“Procedurat përpara gjykatës”*, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit

²²Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.

²³Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare Nr. 87/2015.

detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh.

Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: *“Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj”*. Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’a kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin prima facie - *“në pamje të parë”*²⁴, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu Ligjin Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin Nr. 37/2017, datë 30 Mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 Janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale. Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet *“Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi”*, neni 11, i cili parashikon shprehimisht se:

²⁴ Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

“1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit”, dhe “2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni”.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç’ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në Shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në Qershor të vitit 2017.

Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1).

Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime: 1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. 2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. 3. **Barazia dhe mosdiskriminimi**. 4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës. 5. Ndarja e përgjegjësive ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës. 6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit. 7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj. 8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë. 9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës. 10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. 11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, “parime të përgjithshme”).

Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuar (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligji Nr. 129/2021 “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, rregullon kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status.

Qëllimi i këtij ligji është marrja në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit të fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga Ligji “Për statusin ‘Dëshmor i Atdheut’”, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike apo mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi, për shkak të plagëve të marra apo të sëmundjeve të shkaktuara si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”, rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2). Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit: “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet”.

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media. Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 32, pika dh), monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje

të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji. Ky ligj bazohet në parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”*, Konventën e Këshillit të Evropës, *“Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”* dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në Nëntor 2017.

Sipas objektit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me Ligjin Nr. 8496, datë 03.06.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se: *“1. Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilitdo personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare. 2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme: a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës; b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional; c) për të forcuar dialogun ndërkulturor; ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. 3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi”*.

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë ligj janë miratuar vetëm një pjesë e akteve nënligjore, të parashikuara nga vetë Ligji. Mos miratimi i plotë i akteve nënligjore i bën disa nga segmentet e ligjit jo efektiv, duke lënë të pa zbatuara një numër të drejtash të rëndësishme të pakicave.

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të

garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre: a) viktimave të dhunës në familje; b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal; c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal; ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror; d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor; dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit; e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore; f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi; g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor; gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale; h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 93/2014 *“Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”*, ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si *“Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara”*, *“Mohim i përshtatjes së arsyeshme”* apo edhe *“Përshtatje e arsyeshme”* të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar.

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, "Monitorimi", paragrafi 2, parashikon se: "Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.

Ligji Nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor", sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi "diskriminim" përkufizohet në përputhje me Ligjin Nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit "Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë".

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK përsa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përfundimisht në neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 "Për statusin e invalidit të punës", i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin në mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t'u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoz, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t'u krijojnë mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2).

Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike. b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) me mjete ndihmëse kardiale etj; - Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndër-qytetas bëhet me 50 përqind të vlerës së biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar. Bazuar në nenin 1 të tij, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesëshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale.

Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni 3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1).

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4). Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

Ky ligj ka për qëllim: a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore; b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura; ç) mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Ligji parashikon se një ndër parimet bazë, në bazë të të cilit funksionojnë programet e asistencës sociale është edhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit

shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit e të përfitimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij. (neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (neni 3, pika 19).

Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj Nr. 22/2018 “Për strehimin social”. Ky ligj është miratuar rishtazi në maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.”

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës. Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punë, janë përballur me situata diskriminuese.

Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”. Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe *“orientimin seksual”*. Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor parauniversitar²⁵.

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se: *“1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.”*

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: *“Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral”*.

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Sipas këtij ligji, të burgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Të burgosurit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

²⁵ KMD, Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”

Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas lirimit.

Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të Kodit të Udhëzimeve Etike për Transmetimet Audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër.*

2.2 Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksionimin e KMD

2.2.1 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative e tij

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 25 Shkurt 2010.

Në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi me 18 Nëntor 2020.

Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD ushtron kompetencat në tre sfera kryesore: (I) ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile; (II) monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe (III) rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

2.2.2 Zyra e KMD


Bazuar në nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit.

Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri ne vitin 2018.

Me Vendimin Nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastër dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



2.2.3 Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së

organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve.

Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe Ligjit “Për Barazi Gjinore në Shoqëri”.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;

- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

3. Veprimtaria në Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Promovimi i Barazisë

3.1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), asistenca ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

- Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
- Pjesëmarrjes së KMD-së në procese gjyqësore me objekt diskriminimin.

3.2 Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- Të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.
- Të bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.
- Të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

3.3 Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese.

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar).

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, si dhe shpjegime dhe fakte që ankuesi disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të Ligjit "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspekte apo seanca dëgjimore mes palëve.

Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve dita e regjistrimit të ankesës. Nëse gjatë procedurës administrative është zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera.

Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.


Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për çështjet me objekt gjuhën e urrejtjes, operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i bërë me ndryshimet e LMD-së në vitin 2020.


3.3.1 Çështjet e trajtuara²⁶ nga KMD, gjatë vitit 2021.

Në periudhën nga 1 Janar 2021 deri në 31 Dhjetor 2021, KMD ka trajtuar gjithsej 324 çështje, (302 ankesa dhe 22 çështje ex-officio). Nga këto, 257 çështje (242 ankesa dhe 15 çështje ex-officio) janë të regjistruara në vitin 2021 dhe 67 çështje (60 ankesa dhe 7 çështje ex-officio) janë të mbartura nga viti 2020.

²⁶ Çështjet e trajtuara përfshijnë, çështjet e mbyllura me vendim dhe ato në proces gjatë vitit 2021.



Grafiku 1. Çështje të vitit 2021.



Grafiku 2. Të dhëna krahasimore 2020-2021.

Gjatë vitit 2021 rezulton një rritje me 43% e numrit të çështjeve të trajtuara nga KMD në raport me vitin 2020, gjatë të cilit janë trajtuar gjithsej 226 çështje. Në mënyrë progresive sikurse numri total i çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti rezulton edhe numri i çështjeve të reja të regjistruara në 2021, 257 të tilla, në raport me 174 çështje të reja që janë regjistruar gjatë 2020. Konstatohet një rritje me rreth 47% e çështjeve të reja për 2021 në raport me vitin 2020.

3.3.2 Ankesat

Gjatë vitit 2021 pranë KMD janë shqyrtuar paraprakisht dhe regjistruar 242 ankesa ndër të cilat:

- 14 (katërmbëdhjetë) subjekte kanë ardhur në institucion dhe e kanë ngritur ankesën fizikisht pranë institucionit, duke u asistuar nga specialistët për plotësimin e formularit tip dhe dokumentacionit përkatës.
- 49 (dyzetë e nëntë) ankesa kanë ardhur me postë dhe janë menaxhuar më tej duke i shqyrtuara paraprakisht dhe kontaktuar ankuesit, për çdo rast kur nevojitet plotësimi i dokumentacionit, apo sqarime e ndihmë në lidhje me rubrikat e formularit të ankesës.
- 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) ankesa kanë ardhur përmes adresës info@kmd.al, për

të cilat është ndjekur e njëjta procedurë: Shqyrtim paraprak për plotësim dokumentacioni dhe vijim i procedurës së regjistrimit²⁷.

- 63 (gjashtëdhjetë e tre) ankesa kanë ardhur nga Zyra Rajonale²⁸, konkretisht:
 - 23 (njëzetë e tre) ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Shkodër
 - 19 (nëntëmbëdhjetë) ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Korçë
 - 21 (njëzetë e një) ankesa ardhur nga Zyra Rajonale Fier

Numri i ankesave të paraqitura, të cilat kanë ngelur në pritje dhe nuk janë regjistruar është 30 (tridhjetë). Kjo për shkak se ankuesit ose nuk i janë përgjigjur kërkesave për plotësim të dokumentacionit ose nuk kanë plotësuar saktë të dhënat e formularit: adresa e banimit, adresa e subjektit të pretenduar diskriminues, numër telefoni apo adresa e emaili.

Pranë KMD janë pritur 102 subjekte të interesuar për:

- të paraqitur ankesë ose për të marrë informacion për mënyrën e ngritjes së saj,
- kriteret ligjore që duhen plotësuar nga ankuesi,
- mënyrat e përcjelljes së saj drejtëpërdrejtë, me postë ose me email,
- vijimin e procedurës deri në daljen e vendimit.

Në institucion janë pritur në total 237 (dyqind e tridhjetë e shtatë) telefonata nga subjekte ankues, institucione publike ose private, si dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të interesuar për marrjen e informacionit në kuadër të një ankese, plotësim dokumentacionit, vijueshmërinë e saj drejt hetimit administrativ apo procedurën e ndjekur për çështjet në gjykatë.

Gjithashtu janë përgatitur dhe përcjellë për kompetencë:

- Avokatit të popullit, 2 (dy) ankesa. Ky i fundit i ka dërguar KMD 6 (gjashtë) ankesa për shqyrtim.
- Autoritetit të Mediave Audio-Vizive, 4 (katër) ankesa.
- Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 4 (katër) ankesa.
- Shërbimit Ligjor Falas, TLAS (Tirana Legal Aid Society), 4 (katër) ankesa
- Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve, 2 (dy) ankesa. Ky i fundit i ka dërguar KMD gjithashtu 2 (dy) ankesa për shqyrtim.
- Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë i ka përcjellë KMD 1 (një) ankesë për shqyrtim.


3.3.3. Ankuesit

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërmat a dhe b, të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

²⁷ Për çdo ankesë të regjistruar pranë DPA, ankuesit janë njoftuar me e-mail ose telefon, duke i bërë me dije numrin e ankesës, datën dhe vijimin e mëtejshëm të procedurës në Drejtorinë e Hetimit Administrativ.

²⁸ Për ankesat e ardhura nga Zyra Rajonale, ndiqet e njëjta procedurë nga DPA, deri në regjistrimin e saj.


Nga 324 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2021, për 302 çështje ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në 261 raste ankesat janë paraqitur nga individë (214 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe 47 ankesa të regjistruara në vitin 2020), në 28 raste, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (20 ankesa të regjistruara në vitin 2021 dhe 8 ankesa të regjistruara në vitin 2020), në 13 raste ankesat janë paraqitur nga grup personash (8 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe 5 ankesa të regjistruara në vitin 2020).



Grafikët 3 & 4. Ankesat e regjistruara dhe të mbartura sipas subjekteve ankuese.


Gjatë 2021, konstatohet një rritje në masën 33% e kategorisë së ankuesve që i pëkasin kategorisë së organizatave me interesa legjitime, në krahasim me vitin 2020, gjatë të cilit rezulton se organizatat me interesa legjitime kanë qenë në cilësinë e ankuesit në 21 raste. Numri i ankesave të trajtuara të paraqitura nga organizatat me interesa legjitime gjatë vitit 2021 ka vazhduar të ruajë një trend rritës.

Grafiku 5. Çështjet e trajtuara, të paraqitura nga OJF për vitet 2019-2021.



Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2021 përveç ankesave individuale, janë shqyrtuar edhe 28 ankesa nga organizata me interes legjitim dhe sindikata (8 ankesa të regjistruara në vitin 2020 dhe 20 ankesa të regjistruara në vitin 2021). Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e punonjësve të Policisë së Shtetit, të punonjësve të Policisë së Burgjeve, të Minatorëve, komunitetit Rom/Egjiptian, personave me aftësi të kufizuara, etj. Në çështjet e rregjistruara në vitin 2020 dhe të trajtuara gjatë vitit 2021, 6 ankues janë mbështetur nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2021, në 19 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë.

Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile, sindikatave dhe medias ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen kryesisht të çështjeve. Gjatë këtij viti ka vijuar një sensibilizim i sindikatave të ndryshme, të cilat kanë adresuar pranë Komisionerit, problematikat që lidhen me grupet e punonjësve që ato përfaqësojnë.



Grafiku 6. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2021.

Gjatë vitit 2021, vazhdon i njëjti trend, ku numri i ankuesve burra është më i lartë se ankueset gra.


3.3.4 Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, gjatë vitit 2021, janë trajtuar gjithësej 22 çështje ex-officio, nga të cilat 7 çështje janë të mbartura nga viti 2020. Gjatë vitit 2021, KMD ka filluar hetimin administrativ për 15 raste, pas marrjes së informacionit të besueshëm. 5 (pesë) çështje janë shqyrtuar kryesisht nga KMD, në bazë të informacionit të marrë nga media dhe 7 (shtatë) të tjera janë trajtuar mbështetur në informacionin e përcjellë nga individë apo OJF të ndryshme. Ndërkohë që, 3 (tri) çështje janë filluar kryesisht mbështetur në problematika të evidentuara nga vetë Komisioneri.

Gjatë vitit 2021, ka një rritje të numrit të çështjeve të filluara kryesisht nga KMD, në raport me vitin 2020, gjatë të cilit numri i këtyre çështjeve ka qenë 9.

3.3.5 Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2021, ka patur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimi, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Shkodër, Berat, Fier, Korçë, etj. Është për t’u theksuar fakti që gjatë vitit 2021, janë paraqitur ankesa edhe nga disa Bashki si p.sh.: Selenica, Divjaka dhe Gramshi, nga të cilat Komisioneri nuk ka patur ankesa më parë.



Grafiku 7. Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2021, sipas Bashkive.

3.3.6 Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.


Mbështetur në LMD, është parashikuar një listë e hapur shkaqesh, duke përfshirë dhe rastet për “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh se, **shkaku i mbrojtur** mund të jetë një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri, i cili nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1, të LMD-së.

Gjatë vitit 2021, janë depozituar 102 ankesa, në raport me 57 ankesa të paraqitura gjatë 2020, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.


LMD, nuk ka ndaluar mbrojtjen nga diskriminimi për më shumë se një shkak, por pas ndryshimeve ligjore që pësoi ligji në vitin 2020, duke rregulluar ligjërisht konceptet e diskriminimit të shumëfishtë dhe diskriminimit ndërsektorial, pretendimet për diskriminim bazuar në më shumë se një shkak janë qartësuar dhe mirëpërcaktuar.

Një fakt për tu evidentuar është edhe shqyrtimi i ankesave me pretendim diskriminimi, referuar shkaqeve të shtuara pas ndryshimeve të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, siç është shkaku i pamjes së jashtme, karakteristikat e seksit dhe jetesën me HIV/AIDS.

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2021 dhe atyre të regjistruara në vitin 2020, të ndara sipas shkaqeve:



Grafiku 8. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2021




Grafiku 9. Shkaqet e ankesave të regjistruara në vitin 2020

Gjatë vitit 2021 vazhdojnë të mbeten mbizotëruese pretendimet për diskriminim për shkak të bindjeve politike, aftësisë së kufizuar, racës, përkatësisë në një grup të veçantë, gjendjes ekonomike dhe gjendjes arsimore.

3.3.7 Fushat në të cilat janë paraqitur ankesat.

Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar, ofron mbrojtje në 3 (tre) fusha: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve. Gjatë vitit 2021, nga totali prej 324 çështje të trajtuara gjithsej, (302 ankesa dhe 22 çështje ex-officio), nga këto 13 çështje në fushën e arsimit, 168 çështje në fushën e punësimit dhe 143 çështje në fushën e të mirave dhe shërbimeve.




Grafikët 10 & 11. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2021, të ndara sipas fushave.

Gjatë vitit 2021, shpërndarja e çështjeve të trajtuara sipas 3 fushave, punësim, arsim, të mira shërbime, vazhdon të jetë e ngjashme me atë të vitit 2020. Çështjet në fushën e arsimit zënë 4% të totalit të çështjeve të trajtuara duke pësuar me një zbritje të lehtë krahasuar me 2020, ku këto çështje zinin 7% të totalit të çështjeve.

Çështjet në fushën e punësimit zënë 52% të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë vitit 2021 me një zbritje të vogël (në përqindje) krahasuar me vitin 2020, ku këto çështje zinin 56% të totalit të çështjeve, edhe pse numri i çështjeve në këtë fushë gjatë vitit 2021 ka patur rritje krahasimisht me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve zënë 44% të totalit të çështjeve të trajtuara krahasuar me 2020, ku këto çështje zinin 37% të totalit të çështjeve të trajtuara. Gjatë vitit 2021, krahasimisht me 2020 vihet re një rritje e konsiderueshme e çështjeve në fushën e të mirave dhe shërbimeve.




Grafiku 12. Shpërndarja e çështjeve sipas fushave për vitet 2020-2021.

3.3.8 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Numri total i çështjeve të trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve është 143, nga të cilat 114 çështje janë regjistruar në vitin 2021 dhe 29 çështje të mbartura nga 2020. Në total 112 ankesa drejtohen kundër subjekteve publike dhe 31 ankesa drejtohen kundër subjekteve private.

Krahasuar me vitin 2020, ku numri i çështjeve në këtë fushë kundër subjekteve publike ka qenë 60 ndërsa kundër subjekteve private 23, rezulton një shpërndarje e ngjashme e çështjeve në këtë fushë midis subjekteve publike dhe atyre private, edhe gjatë vitit 2021, me një rritje të vogël prej 6.3% të totalit të çështjeve të kësaj fushe që drejtohen kundër subjekteve publike, në raport me subjektet private. Nga 112 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 42 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 70 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.

Në krahasim me vitin 2020, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor ka pësuar ndryshim. Në vitin 2020, janë paraqitur kundër pushtetit qendror 32 raste ose 53% e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike dhe 28 raste kundër subjekteve publike vendore ose 47% e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike.



Grafiku 13. Çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gjatë 2021.

Gjatë vitit 2021, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 37.5% të totalit të çështjeve në këtë fushë ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 62.5% të totalit të çështjeve në këtë fushë. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2021 ka një rritje me 15.5% të çështjeve që drejtohen kundër pushtetit vendor krahasuar me vitin 2020. Kjo tregon se pretendimet për diskriminim drejtohen më shumë kundër pushtetit vendor krahasuar me pushtetin qendror.

Ankesat e paraqitura në këtë fushë, kanë të bëjnë kryesisht me mos dhënien e shërbimeve të nevojshme nga njësitë e qeverisjes vendore ndaj individëve të ndryshëm, që u përkasin komuniteteve të ndryshme apo shtresave vulnerabël. Problematikat e trajtuara kanë patur të bëjnë edhe me përfitimin e regjistrimit të fëmijëve të minoritetit rom dhe egjiptian, në kopësht pa pagesë. Një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe ndaj institucioneve të administratës qendrore, ku objekti i ankesave konsiston në mosofrimin apo garantimin e një sërë shërbimesh si shërbimi shëndetësor dhe mjekimi me medikamentet e nevojshme, si dhe mosofrimi i transportit publik qytetas pa pagesë, etj. Shkaqet kryesore, për të cilat janë paraqitur ankesat në fushën e shërbimeve kanë qënë: raca, gjendja ekonomike dhe aftësia e kufizuar.


3.3.9 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Ankesat e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të depozituara kundër institucioneve publike, sikurse edhe kundër subjekteve private. Objekti

i ankesave të trajtuara në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura në marrëdhëniet e punës, të tilla si aksesimi në punësim dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës.

Numri i përgjithshëm i ankesave, në fushën e punësimit, që janë trajtuar gjatë vitit 2021, është 168, nga të cilat 36 çështje të regjistruara gjatë vitit 2020 dhe 132 çështje të regjistruara në vitin 2021. Nga të gjithë çështjet e trajtuara në këtë fushë gjatë vitit 2021, 132 çështje drejtohen kundër subjekteve publike dhe 36 të tilla kundër subjekteve private. Gjatë vitit 2021 evidentohet një rritje me 42 ankesa më shumë kundër sektorit publik krahasuar me vitin 2020. Ndërsa numri i ankesave kundër sektorit privat qëndron në të njëjtat nivele, krahasuar me vitin 2020.

Nga 132 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 31 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 101 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Ankesat e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, si rezultat i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.



Grafiku 14. Çështjet në fushën e punësimit, gjatë 2021.

Në krahasim me vitin 2020, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor nuk ka pësuar ndryshime domethënëse. Në vitin 2020, janë paraqitur kundër pushtetit qendror 25 raste ose 28% e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike dhe 65 raste kundër subjekteve publike vendore ose 72% e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike.


Gjatë vitit 2021, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 23% të totalit të çështjeve në këtë fushë drejtuar kundër subjekteve publike ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 77% të totalit të çështjeve në këtë fushë drejtuar kundër subjekteve publike. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2021 ka një rritje me 5% të çështjeve që drejtohen kundër pushtetit vendor krahasuar me vitin 2020.

Ankesat që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë patur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, gjendjen arsimore, përkatësinë në një grup të veçantë, aftësinë e kufizuar etj.

3.3.10 Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 13 çështje, në fushën e arsimit, nga të cilat 3 çështje janë të regjistruara në vitin 2020 dhe 10 çështje janë të regjistruara gjatë vitit

2021. Në të gjitha çështjet e trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike, ndër të cilat në 8 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve qendrore të arsimit dhe në 5 raste kundër institucioneve vendore të arsimit.



Grafiku 15. Çështjet në fushën e arsimit, gjatë 2021

Objekti i ankesave të paraqitura në fushën e arsimit ka qënë vendosja e kriterëve përjashtuese për një kategori studentësh nga institucionet e arsimit të lartë, mospranimi në shkollë të një nxënëseje për shkak të mbulesës/shamisë që mbante, shmangien e segregimit në shkollë, sigurimin në mënyrë efektive të ngrohjes në shkollë etj. Shkaqet kryesore të pretenduara në këto ankesa janë aftësia e kufizuar, gjendja arsimore, etj.

3.3.11 Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar për shkak të detyrës, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Komisioneri gjatë vitit 2021, ka trajtuar në total 10 çështje ku janë trajtuar problematikat që lidhen me fëmijët, nga të cilat 7 ankesa, 2 çështje të nisura kryesisht dhe një çështje e ardhur si informacion.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri ka përfunduar shqyrtimin e 9 çështjeve ku janë trajtuar problematikat e fëmijëve. Nga këto 9 çështje, Komisioneri është shprehur si vijon:

- 2 vendime për diskriminim në formën më të rëndë, në të cilat janë gjetur përgjegjëse dy subjekte në mënyrë solidare, QSUNT dhe MSHMS, lidhur me mospagimin e medikamenteve mjekësore të fëmijëve që vuajnë nga sëmundja e leucemisë dhe marrin trajtim pranë QSUNT-së.
- Në 3 raste, problematikat e adresuara janë zgjidhur gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës para Komisionerit dhe çështjet janë mbyllur pa një vendim përfundimtar pasi është arritur qëllimin për të cilin ishin paraqitur ankesat. Nga këto 3 raste për të cilat Komisioneri ka arritur qëllimin e ankesës, në 1 rast problematika lidhej me faktin e mospranimi në shkollë të një nxënëse për shkak të mbulesës/shamisë që mbante. Pas ndërmjetësimit të KMD-së, fëmijës I'u krijuan kushtet duke i dhënë akses në ndjekjen e mësimi si të gjithë nxënësit e tjerë. Në 2 rastet e tjera është ngritur pretendimi nga ana e prindit, lidhur me përfitimin e regjistrimit të fëmijës të minoritetit rom, në kopësht pa pagesë. Pas ndërmejtësimit të KMD-së, fëmijët u regjistruan në kopësht pa pagesë.

- 3 rekomandime ku subjekt kanë qenë fëmijët, nga të cilat, 2 (dy) rekomandime lidhen me regjistrimin e fëmijëve të komunitetit rom dhe egjiptian në shkolla, kopshte dhe çerdhe. Për një të tretën të nisur kryesisht, problematika lidhet me regjistrimin pa pagesë në kopshte dhe çerdhe të fëmijëve të komuniteteve rom dhe egjiptiane, ndërsa për çështjen tjetër të paraqitur nga një OJF, Komisioneri doli me një rekomandim për shmangien e segregimit në shkollat e qytetit të Elbasanit. Në një çështje të nisur kryesisht, Komisioneri i ka rekomanduar Bashkisë Elbasan marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin në mënyrë efektive të ngrohjes në Shkollën 9-vjeçare “Europa”, Bradashesh, Elbasan.
- në 1 (një) rast ankuesi është tërhequr nga ankimi.

Gjuha e urrejtjes.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri ka shqyrtuar në total 7 çështje me objekt përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 6 ankesa (5 ankesa regjistruar në vitin 2021 dhe 1 ankesë e mbartuar nga viti 2020) dhe 1 çështje ex-officio e regjistruar në vitin 2021. Në 2 (dy) raste është pretenduar përdorimi i gjuhës së urrejtjes për shkak të racës, në 1 rast për shkak të gjinisë dhe në 4 (katër) raste kundër komunitetit LGBTI.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me vendim për 6 ankesa dhe 1 çështje ex-officio. Në 2 (dy) raste palët me ndërmjetësimin e Komisionit janë pajtuar dhe çështja ka përfundur pa një vendim përfundimtar. Me pajtimin e palëve çështja është konsideruar e zgjidhur pasi është arritur qëllimi për të cilin kishte filluar çështja.

Komisioneri ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në dy raste. Në një rast ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI nga ana e një përfaqësuesi dhe udhëheqësi fetar dhe në rastin tjetër është konstatuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes për shkak të racës nga ana e një politikani.

Në 3 (raste) Komisioneri nuk ka konstatuar përdorim të gjuhës së urrejtjes të pretenduar kundër komunitetit LGBTI, nga ana e personazheve publike (gazetare, psikologe) dhe medias.

3.4 Vendimet sipas fushave, në të cilat janë paraqitur ankesat

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej **110 vendime dhe 3 rekomandime**²⁹, nga të cilat, 25 vendime për çështjet e mbartura nga viti 2020 dhe 88 vendime për çështjet e regjistruara në vitin 2021. Nga 113 vendime, 91 vendime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 22 vendime janë dhënë kundër subjekteve private.

Nga këto, KMD është shprehur me:

- **19** vendime diskriminimi, nga të cilat **12** vendime kundër subjekteve publike dhe **7** vendim kundër subjekteve private;
- **19** vendime për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore;

²⁹ Rekomandimet janë në kuadër të çështjeve kryesisht.

- 28 vendime mosdiskriminimi;
- 36 vendime për mospranim të ankesës;
- 5 vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri;
- 3 vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak të pamundësisë për të siguruar informacionin e nevojshëm, për shkak së ankuesi ndërroi jetë dhe për shkak se çështja po shqyrtohej në gjykatë;
- 3 Rekomandime;
- 1 sanksion me gjobë për shkak se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej **114 vendime**, nga të cilat, 31 vendime për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2021 dhe 83 vendime për çështje të mbartura nga viti 2020. 86 vendime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 28 vendime kundër subjekteve private.

Nga këto, KMD është shprehur me:

- **35** vendime diskriminimi, nga të cilat **30 vendime** kundër subjekteve publike dhe **5 vendime** kundër subjekteve private;

Në vendimet ku është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka kërkuar nga subjektet përkatëse, rregullimin e situatave diskriminuese, si dhe rikthimin në punë të individit të diskriminuar.

- 33 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore;
- 28 vendime për mospranimin e ankesës;
- 3 vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi;
- 7 vendime për pushimin e çështjeve, për shkak se subjektet ankuese i janë drejtuar organeve gjyqësore me ankim për diskriminim;
- 2 vendime për pushimin e çështjeve, për shkak se nuk është arritur të sigurohet informacioni i mjaftueshëm për të dalë me një vendim përfundimtar.

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej **8 vendime dhe 2 rekomandime**, të cilat, janë të gjitha të drejtuara kundër subjekteve publike.

Nga këto KMD është shprehur me:

- 3 vendime diskriminimi;
- 1 vendim mosdiskriminimi;
- 3 vendime për mospranimin e ankesës;
- 1 vendim për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankimi;

- 2 rekomandime.


3.5 Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve³⁰

3.5.1 Vendimet e çështjeve me shkak racën³¹

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 15 vendime dhe 1 rekomandim, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime diskriminimi;
- 4 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore.
- 2 vendime mospranimi;
- 5 vendime mosdiskriminimi;

Gjithashtu, është marrë edhe 1 sanksion me gjobë për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim.



Grafiku 16. Vendimet e vitit 2021 me shkak racën

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qëndrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, janë si vijojnë:

- Regjistrimi në arsimin parashkollor të fëmijëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian;
- Përdorimi në media i shprehjeve diskriminuese nga persona që bëjnë pjesë në jetën publike të vendit, për të etiketuar persona të komunitetit egjiptian;
- Vonesat në procesin e legalizimit të banesave të anëtarëve të komuniteteve rom dhe egjiptiane;
- Mosofrimi e shërbimeve, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore (si p.sh.: ndihma ekonomike).


³⁰ Komisioneri shprehet me vendim për çështje ku pretendohet diskriminim për një ose më shume shkaqe të përcaktuara në nenin 1, të LMD. Në këtë kontekst, Komisioneri shprehet në të njëjtin vendim, për 2 ose më shumë shkaqe diskriminimi. Për këtë arsye, numri total i vendimeve të miratuara nga KMD, mund të mos përputhet me numrin e vendimeve të dhëna sipas shkaqeve të raportuara në këtë pjesë të Raportit Vjetor.

³¹ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 "Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".

3.5.2 Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 34 vendime, 1 rekomandim dhe 3 vendime me gjobë për moszbatim vendimi, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 11 vendime diskriminimi;
- 5 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 11 vendime mospranimi;
- 3 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave;
- 2 vendime pushimi për pamundësi të vazhdimit të shqyrtimit të çështjes.



Grafiku 17. Vendimet e vitit 2021 me shkak aftësinë e kufizuar

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

- Mungesa e aksesueshmërisë në objekte që ofrojnë të mira dhe shërbime, si p.sh.: Zyrat e Postës Shqiptare apo Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore.
- Mungesa e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit;
- Aksesueshmëria në linjat e transportit publik, në qendrat e votimit në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2021 dhe në stadiumin "Air Albania";
- Zgjidhja e marrëdhënieve të punësimit;
- Përfitimi i aftësisë së kufizuar nga KMCAP Epror;
- Përfitimi i medikamenteve mjekësore.


Referuar subjekteve ankues në çështjet e shqyrtuara, rezultojnë se subjekti ankues ka qenë femër në 6 raste, në 20 raste subjekti ankues ka qenë mashkull, në 5 raste subjektet ankues kanë qenë organizatë me interesa legjitime, në 1 rast kanë qenë grup personash dhe në 2 raste subjekti që ka iniciuar çështjen ka qenë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Sa më sipër, vlen të theksohet fakti që numri më i lartë i vendimeve të mospranimi, ka ardhur si rezultat i ankesave me objekt jashtë kompetencave të Komisionerit, si p.sh.: mospërfitimi i pagesës së invaliditetit për një diagnozë apo sëmundje të caktuar etj.

3.5.3 Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 55 vendime dhe 2 vendime gjobë për moszbatim vendimi mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendura janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 23 vendime diskriminimi;
- 2 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 17 vendime mosdiskriminimi;
- 8 vendime mospranimi;
- 1 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave;
- 4 vendime pushimi për shkak se ankuesit i janë drejtuar gjykatës për shqyrtimin e çështjes.



Grafiku 18. Vendimet e vitit 2021 me shkak bindjen politike


Çështjet me pretendim diskriminimin për shkak të bindjes politike kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak.

3.5.4 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 15 vendime dhe 1 rekomandim mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendim diskriminimi;

- 2 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 3 vendim mosdiskriminimi;
- 5 vendime mospranimi;
- 1 vendim pushimi për shkak se ankuesi i është drejtuar gjykatës për shqyrtimin e çështjes.



Grafiku 19. Vendimet e vitit 2021 me shkak gjendjen ekonomike

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, janë si vijojnë:


- Mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë, nga ana e institucioneve të pushtetit vendor.
- Mosofrimi i shërbimeve apo mungesa e parashikimeve që lidhen me përjashtimin e familjeve në nevojë nga tarifa të caktuara, si p.sh.: lidhjen e kontratës së energjisë elektrike;
- Vonesat në procesin e legalizimit të banesave të komuniteteve rome dhe egjiptiane, ku gjendja ekonomike ndërthuret me shkakun e racës.
- Mungesa e trajtimit me medikamente të cilat janë të kushtueshme, në institucionet spitalore publike, për trajtimin e fëmijëve që vuajnë nga leucemia.

3.5.5 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 10 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendura janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim mosdiskriminimi;

- 6 vendime mospranimi.



Grafiku 20. Vendimet e vitit 2021 me shkak gjendjen shëndetësore

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore, në fushën e punësimit dhe shërbimeve. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, janë si vijojnë:


- Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes shëndetësore.
- Mungesa e trajtimit me medikamente në institucionet spitalore publike, për fëmijët që vuajnë nga leucemia.
- Mungesa e medikamenteve të rimbursueshme për persona që vuajnë nga Hemofilia.

3.5.6 Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen arsimore.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 11 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendim diskriminimi;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore.
- 3 vendime mosdiskriminimi;
- 4 vendime mospranimi;

- 1 vendim pushimi për shkak se ankuesi i është drejtuar gjykatës për shqyrtimin e çështjes.




Grafiku 21. Vendimet e vitit 2021 me shkak gjendjen arsimore

Çështjet me pretendim diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak, si dhe kriteret e vendosura nga institucionet arsimore publike lidhur me rekrutimin në programet e ciklit të dytë të studimeve.

3.5.7 Vendimet e çështjeve me shkak moshën.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 10 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes arsimore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 4 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim mosdiskriminimi;
- 2 vendime mospranimi.



Grafiku 22. Vendimet e vitit 2021 me shkak moshën


Çështjet me pretendim diskriminimin për shkak të moshës kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me vendosjen e një moshe limit për të patur akses në punësim dhe

profesion, për të përfituar nga shërbimet e ofruara për nxitjen e punësimit, apo kur autoritetet përgjegjëse dështojnë që të adresojnë në mënyrë efektive nevojat e posaçme për kujdes shëndetësor të fëmijëve që vuajnë nga sëmundje të rënda, si një kategori e cila gëzon një mbrojtje të posaçme.

3.5.8 Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 7 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 1 vendim diskriminimi;
- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore.



Grafiku 23. Vendimet e vitit 2021 me shkak përkatësinë në një grup të veçantë


Çështjet me pretendim diskriminimin për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë kanë konsistuar kryesisht në problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione private dhe të administratës shtetërore qendrore ose vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjet ku pretendohet diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, janë si vijojnë:

- Përjashtimi nga e drejta e përfitimit të përgjysmimit të tarifës së kërkuar për studimet në ciklin e dytë të studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për studentët që kishin diplomë bachelor të një universiteti jo publik;
- Largimet nga puna nga ana e punëdhënësve, pikërisht pasi ata kanë marrë dijeni për veprimtarinë e ankuesve si pjesë e këtyre grupeve të veçanta, psh. qenia në një grupim sindikal mbrojtje të të drejtave të punonjësve;
- Trajtimi i ndryshëm i punonjësve në vendin e punës, pas marrjes dijeni nga punëdhënësi të përfshirjes në një grupim të caktuar të subjekteve ankues.

3.5.9 Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me 15 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjininë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi;
- 3 vendime ndërprerje e procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime ndërprerje e procedurave hetimore pasi nuk është arritur të sigurohet informacioni i mjaftueshëm për të dalë me një vendim përfundimtar;
- 1 vendim pushimi për shkak se ankuesi i është drejtuar gjykatës për shqyrtimin e çështjes.



Grafiku 24. Vendimet e vitit 2021 me shkak gjininë


Pretendimet e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhen kryesisht me diskriminimin në punësim dhe kryesisht:

- Shqetësim seksual në vendin e punës;
- Viktimizim nga ana e punëdhënësit duke marrë masë disiplinore për shkak të paraqitjes së një ankimi për diskriminim gjinor;
- Ecuria në karrierë në forcat e policisë.

3.5.10 Vendimet e çështjeve me shkak orientimin seksual, identitetin gjinor, karakteristikat e seksit.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me **8 vendime**, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor ose karakteristikave të seksit. Këto shkaqe të cilat përfshihen në termin ombrellë që i adresohet personave të cilët i përkasin komunitetit LGBTI, kryesisht janë shkaqe të cilat bashkëshoqërojnë njëri tjetrin në çështjet e trajtuara. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 4 vendime mosdiskriminimi;
- 1 vendim mospranimi;



Grafiku 25. Vendimet e vitit 2021 me shkak orientimin seksual, identitetin gjinor, karakteristikat e seksit.

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim kundrejt personave që i përkasin komunitetit LGBTI, janë si vijojnë:


- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes;
- Mosofrimi i shërbimit të transportit nga subjekt privat.

3.5.11 Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri është shprehur me **49** vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim në kuadër të termit “për çdo shkak tjetër”. Shumica e vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në çështjet respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 6 vendime diskriminimi;
- 2 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 7 vendime mosdiskriminimi;

- 32 vendime mospranimi.



Grafiku 26. Vendimet e vitit 2021 për "çdo shkak tjetër"

Çështjet me pretendim diskriminimi për "çdo shkak tjetër" kanë konsistuar kryesisht në fushën e punësimit, në lidhje me trajtimin në vendin e punë dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e ankimeve ose denoncimeve kundër punëdhënësve, prononcimeve publike dhe qëndrimeve kritikë të mbajtura për menaxhimin e situatës së pandemisë nga strukturat shtetërore, të cilët në pjesën kryesore i përkasin punëdhënësve të sektorit publik.

Nga analiza e vendimeve të mospranimit të çështjeve me pretendim diskriminimi në kuadër të parashikimit për "çdo shkak tjetër", rezulton se këto çështje kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk i ka marrë ato në shyrtrim. LMD ka pajisur Komisionerin me kompetencën për të shqyrtuar ankesat me pretendim diskriminimi, sipas parashikimeve të këtij ligji. Sipas, LMD jo çdo pretendim për trajtim të pafavrrshëm dhe të pabarabartë përbën diskriminim, por vetëm ato diferenca në trajtim që bazohen në një shkak që konsiderohet i mbrojtur sipas ligjit. Ankuesit i drejtohen Komisionerit duke pretenduar se sjellja e padrejtë që i janë nënshtruar përbën diskriminim, duke mos identifikuar asnjë shkak. Në mënyrë të vazhdueshme në vendimet e tij Komisioneri thekson se, çdo sjellje diskriminuese është një sjellje e paligjshme, por jo çdo pretendim për paligjshmëri përbën diskriminim, për sa kohë nuk bazohet në një shkak i cili konsiderohet shkak i mbrojtur sipas ligjit.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se rritja e përgjithshme e numrit të ankesave, pavarësisht numrit të vendimeve për mospranimin e tyre pasi kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD, për arsyet e mësipërme, tregon një rritje të besimit të subjekteve tek institucioni i Komisionerit, të cilit i drejtohen për të zgjidhur problematikat e tyre.

3.5.12 Vendimet për konstatimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe diskriminimit ndërsektorial

Forma e rëndë e diskriminimit dhe diskriminimi ndërsektorial, janë dy forma të diskriminimit të cilat u parashikuan në LMD, me ndryshimet që pësoi ligji në vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, Komisioneri ka konstatuar në 4 raste, konsumimin e formës së rëndë të diskriminimit, të cilat kryesisht kanë patur të bëjnë me konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak, kryesisht për shkaqet e gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar,

gjendjes ekonomike. Kjo formë e diskriminimit është konstatuar si rezultat i mungesës në ofrimin e kujdesit shëndetësor dhe barnave nga autoritetet shëndetësore publike.

Gjatë vitit 2021 Komisioneri ka konstatuar në një rast diskriminim ndërsektorial në fushën e punësimit, si rezultat i ndërveprimit të dy shkaqeve, bindjeve politike dhe ankimit kundër punëdhënësit.

3.6 Rezultatet e vendimeve të ankesave të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, Kur e çmon të nevojshme, Komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër. Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka patur mungesë të informacionit, që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që brenda 10 ditëve pune nga dita që ka marrë njoftimin të plotësojë kriteret e kërkuara nga KMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Fierit dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2021, është shprehur me **232 Vendime** dhe **5 Rekomandime**³². Nga këto, 58 vendime dhe 1 rekomandim për ankesa/çështje ex-officio të regjistruara në vitin 2020 dhe 174 vendime dhe 4 rekomandime, për ankesa të depozituara apo çështje ex-officio të iniciuara gjatë periudhës së vitit 2021.

Vendimet e dhëna nga KMD, klasifikohen si më poshtë:

- 57 vendime konstatim diskriminimi;
- 26 vendime për ndërprerje të procedurave të hetimit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave;
- 62 vendime konstatim mosdiskriminimi;
- 67 vendime për mospranim të ankesës;
- 8 vendime pushimi për shkak se ankuesi është tërhequr nga procedura hetimore;
- 8 vendime pushimi për shkak se po ndiqet në gjykatë;
- 4 vendime pushimi për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave;
- 5 rekomandime.


Për vitin 2021, Komisioneri është shprehur me vendime gjobë, si vijojnë:

- 11 vendime me gjobë për moszbatim të vendimit në themel të Komisionerit;

³² Këtu nuk përfshihen vendimet me gjobë për moszbatim vendimi apo mosdhënie informacioni nga subjektet përkatës, vendimet për bashkim ankesash, si dhe vendimet e pezullimit;

- 1 vendim me gjobë kundër subjektit, që nuk ka dhënë informacion, pas kërkesës zyrtare së KMD-së.

Në total, numri i vendimeve/rekomandimeve të Komisionerit për vitin 2021, është 249 vendime (ku përfshihen edhe 12 vendimet me gjobë).



Grafiku 27. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2021

Për sa më sipër, vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2021, subjektet kanë zbatuar masat e vendosura nga KMD për rregullimin e situatës diskriminuuese për 12 vendime.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka dërguar 782 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të ankesave, ka zhvilluar 6 inspektive dhe 93 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Nga 57 ankesa/çështje ex-officio, për të cilat, KMD është shprehur me vendime diskriminimi gjatë vitit 2021, për 44 prej tyre janë zhvilluar seanca dëgjimore, fakt që dëshmon mbi rëndësinë e zhvillimit të seancave të tilla, për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, përgjatë kryerjes së hetimit administrativ.

Referuar subjekteve ankues, rezulton se subjekti ankues ka qenë femër në 13 vendime diskriminimi, në 31 vendime diskriminimi subjekti ankues ka qenë mashkull, në 3 vendime subjektet ankues kanë qenë grup personash dhe në 10 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë komunitet apo grup vulnerabël.

3.7 Proçeset Gjyqësore

3.7.1 Pjesëmarrja në proçeset gjyqësore

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e vendos Komisionerin në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përse i takon pjesëmarrjes së institucionit në proçeset gjyqësore. Vendimet e dhëna nga Komisioneri, janë të ankimeshme në gjykatë. Gjithashtu, ligji parashikon detyrimin e gjykatës për t’a njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t’i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të proçedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika 1/gj).

Gjatë vitit 2021, KMD është thirrur në **119** proçese gjyqësore³³ në raport me **101** proçese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2020.³⁴

Rritja e numrit të proçeseve gjyqësore ndër vite, vjen si pasojë e një numri në rritje të ankesave të depozituara pranë KMD-së, që tregon se tashmë ky institucion luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe konsiderohet tanimë, si një mjet efektiv për vënien në vend të të drejtave të shkelura. Gjithashtu, ka një rritje të çështjeve gjyqësore me objekt konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin, me qëllim ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre.

Roli i Komisionerit në proçeset gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

A. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si palë e paditur në **53** proçese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi apo pavlefshmëria e vendimeve të KMD-së, nga subjektet e gjetur në shkelje të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, me vendim të KMD, në raport me **50** proçese gjyqësore për vitin 2020:

- Në **18** proçese, Komisioneri është paditur nga **individë** lidhur me vendimet ku është konstatuar mosdiskriminim (11 raste), vendime ku është konstatuar diskriminim (2 raste), vendime ku është vendosur mospranim (4 raste), dhe vendime ku është vendosur sanksion me gjobë (1 rast);
- Në **35** proçese Komisioneri është paditur nga **persona juridikë** (institucione), lidhur me vendimet ku është konstatuar diskriminim (32 raste), si dhe vendimet ku është vendosur sanksion me gjobë (1 rast).

B. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si person i interesuar/palë e

³³ Të shpërndara gjeografikisht sipas kompetencës në: 77 raste nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, 10 raste nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, 2 raste nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, 2 raste nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, 1 rast nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, 8 raste nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, 6 raste nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, 3 raste nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, 2 raste nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, 1 rast nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, 2 raste nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

³⁴ Përfshirë këtu edhe proçeset gjyqësore të iniciuara nga KMD me objekt lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, si dhe gjykimet në Gjykatën Kushtetuese.

tretë në 49 proçese gjyqësore, në çështje ku kërkohet konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi në gjykatë, në raport me 40 proçese të tilla gjatë vitit 2020. Në këto çështje, KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, dhe parashtrohet mendim me shkrim për gjykatën, sipas përcaktimeve ligjore:


- 29 raste janë çështje të pa shqyrtuara më parë nga Komisioneri, ku palët i janë drejtuar direkt gjykatës për konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim;
- 15 raste janë çështje të shqyrtuara nga Komisioneri me vendim konstatim diskriminimi, ku palët i janë drejtuar gjykatës për dëmshpërblim;
- 5 raste janë çështje të shqyrtuara nga Komisioneri me vendim konstatim mosdiskriminimi (3 raste), me vendim pushimi (1 rast) dhe me vendim mospranimi (1 rast), ku palët i janë drejtuar gjykatës për konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim.

C. Në përputhje me parashikimet ligjore, KMD i është drejtuar gjykatës me 16 kërkesa për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, për vendimet me gjobë të KMD, krahasuar me 11 të tilla gjatë vitit 2020. Në raport me Gjykatën, KMD ndërvepron gjithashtu si kërkues, duke i'u drejtuar asaj me kërkesa për lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit, për vendimet me gjobë të Komisionerit. Në vijim të procedurave të ekzekutimit të vendimeve me gjobë, pas lëshimit nga Gjykata të Urdhërimit të Ekzekutimit, KMD ka kërkuar pranë Zyrrave përkatëse Përmbarimore, vënien në ekzekutim të 13 titujve ekzekutivë, një pjesë e të cilave lidhen me kërkesa për lëshim urdhri të pranuar nga gjykata, gjatë vitit 2020.

- Në 2 raste debitor në kërkesën për lëshim urdhëri ekzekutimi ka qenë një person fizik;
- Në 2 raste debitor ka qenë një person fizik brenda personit juridik; dhe
- Në 12 raste debitorë kanë qenë kryesisht institucione publike dhe shoqëri tregtare.

D. Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", me ndryshimet e pësura me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit paraqitjen e kërkesë-padive në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive; si dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve (neni 32, pika 1, gërma "i" dhe "i/1").

Gjatë vitit 2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është bërë pjesë e procedurave para Gjykatës Kushtetuese, e cila e ka ftuar për të dhënë mendimin e tij me shkrim në lidhje me kërkesën me objekt: "Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e RSH i pikës 1 të nenit 162 të Ligjit Nr. 10 019 datë 29.12.2008 "Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë". Në parashtrimet e tij, Komisioneri ka theksuar faktin që në bazë të frymës së Kushtetutës dhe standarteve ndërkombëtare mbi zgjedhjet, brenda mundësive, ligji duhet të garantojë barazinë e votës dhe përmes saj barazinë e shanseve për të gjithë kandidatët dhe forcat politike pjesëmarrëse në zgjedhje.



Grafiku 28. Roli i KMD-së në proceset gjyqësore ndër vite.

3.7.2 Vendime Gjyqësore³⁵

Gjatë vitit 2021, Gjykatat kompetente kanë dalë me **119 vendime** për çështje ku KMD ka qenë palë, në raport me **87 vendime** të komunikuara në gjatë vitit 2020. Nga këto 119 vendime, në 58 vendime gjyqësore KMD ka qenë në cilësinë e palës së paditur, në 49 vendime gjyqësore në cilësinë e palës së tretë dhe në 12 vendime në cilësinë e kërkuar.

A. Në 58 vendime të dhëna nga gjykatat kompetente (civile dhe administrative) ku Komisioneri ka qenë palë e paditur dhe objekt ka qenë shfuqizimi i vendim-marrjes së KMD-së, është vendosur si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka dhënë **50 vendime** nga të cilat:
 - Në **29** raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e diskriminimit**. Në këto raste, gjykata ka vendosur:
 - a. Në **15** raste rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - b. Në **9** raste pranimin e padisë, duke shfuqizuar tërësisht vendimin e Komisionerit,
 - c. Në **1** rast pranimin e pjesës së padisë, duke shfuqizuar pjesërisht vendimin e Komisionerit,
 - d. Ndërsa **4** raste kanë qenë gjykime jo në thell të çështjeve.
 - Në **15** raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e mosdiskriminimit**. Në këto raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në **12** raste rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - b. Në **2** raste pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit,

³⁵ Kjo pjesë nuk detajon të dhënat në lidhje me përfundimin e proceseve gjyqësore, si më sipër. Këtu trajtohen vendimet e komunikuara zyrtarisht nga Gjykata gjatë periudhës janar - dhjetor 2021 (mund të përfshihen këtu edhe vendime të marra gjatë vitit 2020, por komunikimi i të cilave është bërë gjatë vitit 2021).

- c. Ndërsa **1** rast, ka qenë gjykim jo në themel të çështjes.
- Në **2** raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **pushimin e procedimit administrativ**. Në këto raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në **1** rast pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit,
 - b. Në **1** rast rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
 - Në **2** raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **mospranimin e ankesës**. Në këto 2 raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Rrëzimin e padive, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
 - Në 2 raste objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **sanksione me gjobë**. Në këto raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në **1** rast rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - b. Në **1** rast mospranimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
2. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë në rrethe³⁶, kanë dhënë **2 vendime**, për çështje të trajtuara nga KMD me vendim diskriminimi në një rast dhe mosdiskriminimi në rastin tjetër, duke vendosur kthimin e kërkesëpadisë në rastin e parë dhe deklarimin e moskompetencës në rastin e dytë.
3. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore³⁷ kanë dhënë **2 vendime**, në një rast për çështje të patrajtuar nga KMD, duke vendosur pushimin e gjykimit të çështjes dhe në një rast për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi, duke vendosur rrëzimin e padisë.
4. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **1 vendim**, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi, duke vendosur kalimin e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore.
5. Gjykatat e Apelit në rrethe³⁸ kanë dhënë **2 vendime**, për një çështje të trajtuar nga KMD me vendim mospranimi, dhe një çështje të shqyrtuar nga KMD me vendim diskriminimi. Në rastin e parë gjykata vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, për rrëzimin e padisë, dhe në rastin e dytë gjykata vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (pranim padie), dhe kthimin e çështjes për rigjykim.
6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka dhënë **1 vendim**, me objekt shfuqizimin e vendimit me gjobë të KMD-së, duke vendosur mospranimin e rekursit.

³⁶ Konkretisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë dhe Gjirokastrë.

³⁷ Konkretisht, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

³⁸ Konkretisht nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe Gjirokastrë.

B. Në 49 vendime të dhëna nga gjykatat kompetente (civile dhe administrative) ku Komisioneri ka qenë palë e tretë, me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka marrë vendimet si më poshtë³⁹:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë **15 vendime** për Komisionerin në cilësinë e palës së tretë duke vendosur:
 - **3 vendime** për pranim i pjeshëm të padisë (të treja rastet të trajtuara nga KMD me vendim diskriminimi);
 - **2 vendime** për rrëzimin e padisë (një rast trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi dhe një rast me vendim pushimi);
 - **1 vendim** për pezullimin e gjykimit (rasti ishte trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi);
 - **1 vendim** për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike falas (rasti i trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi);
 - **2 vendime** për rrëzimin e kërkesës për sigurim padie (raste të patrajtuara nga KMD me vendim);
 - **2 vendime** për pushimin e gjykimit (një rast i trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi dhe një rast i patrajtuar më parë nga KMD);
 - **3 vendime** për kthimin e padisë (të treja raste të pashqyrtuara nga KMD);
 - **1 vendim** për kthimin e ankimit (rast i trajtuar nga KMD me vendim mospranimi).
2. Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë në rrethe⁴⁰ kanë dhënë **9 vendime** gjithësej, ku në **dy** raste gjykata ka vendosur pranimin e padisë (1 rast i trajtuar me vendim diskriminimi nga KMD dhe 1 rast i patrajtuar nga KMD), në **dy** raste gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë (raste të pashqyrtuara më parë nga KMD), në **një** rast gjykata ka vendosur pranimin e pjeshëm të padisë (rast i trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi), në **dy** raste gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit (1 rast i trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi dhe **1 rast** i patrajtuar nga KMD), në **një rast** gjykata ka vendosur pranimin e ankimit (rast i patrajtuar nga KMD), si dhe në **një rast** gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit për masën e sigurimit të padisë (rast i patrajtuar nga KMD).
3. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore⁴¹ kanë dhënë **14 vendime gjithësej**, duke vendosur:
 - **1 vendim** për pezullimin e gjykimit, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi;
 - **1 vendim** për shpalljen e moskompetencës, për çështje të patrajtuar më parë nga KMD;
 - **3 vendime** për rrëzimin e padisë, për çështje të patrajtuar nga KMD më parë;
 - **1 vendim** për pranimin e padisë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi;

³⁹ Totali i vlerës së dëmshpërblimit të dhënë për vitin 2021 nga gjykatat kompetente, si pasojë e diskriminimit të konstatuar, është 21 047 327.2 Lekë.

⁴⁰ Konkretisht nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë (4 raste), Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë (3 raste) dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër (2 raste).

⁴¹ Konkretisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier (6 raste), Berat (3 raste), Mat (2 raste), Sarandë (1 rast), Shkodër (1 rast), Tiranë (1 rast).

- **4 vendime** për pranimin e pjesës së padisë, (1 rast çështje e trajtuar me vendim mospranimi nga KMD, 1 rast çështje në proces shqyrtimi pranë KMD-së; 1 rast çështje e shqyrtuar nga KMD me vendim diskriminimi dhe 1 rast çështje e patrajtuar nga KMD);
- **3 vendime** për pushimin e gjykimit, për çështje të patrajtuara nga KMD më parë;
- **1 vendim** për pranimin e pjesës së padisë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim mosdiskriminimi.

4. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **3 vendime** duke vendosur:

- **1 vendim** për pushimin e gjykimit të çështjes, për çështje të pashqyrtuar nga KMD më parë;
- **1 vendim** për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi;
- **1 vendim** për ndryshimin pjesërisht të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë (e cila kishte pranuar pjesërisht padinë duke konstatuar diskriminimin), për çështje të shqyrtuar nga KMD me vendim diskriminimi.

5. Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë **2 vendime**, ku njëri rast ka qenë i trajtuar me vendim diskriminimi nga KMD, dhe gjykata vendosi ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, duke rrëzuar padinë. Ndërsa rasti tjetër, i patrajtuar nga KMD, gjykata vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, për moskonstatimin e diskriminimit.

6. Gjykatat e Apelit në rrethe⁴² kanë dhënë **5 vendime**, për **3 çështje** të trajtuara nga KMD me vendim diskriminimi, ku në njërin rast gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (pranimin e padisë), në rastin e dytë gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor (rrëzimin e padisë), dhe në rastin e fundit, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor (pranimin e pjesës së padisë). Në **2 raste** të pashqyrtuara më parë nga KMD, në një rast gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë (rrëzim padie), dhe në rastin tjetër gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë (pranim padie), dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

C. Në çështjet ku KMD ka kërkuar lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kjo e fundit gjatë vitit 2021 ka dhënë 12 vendime⁴³, ku:

- **10 vendime** për pranimin e kërkesës së KMD-së dhe lëshimin e urdhërimit të ekzekutimit (për të cilat janë ndjekur procedurat e vënies në ekzekutim pranë Zyrave Përmbarimore përkatëse, dhe deri aktualisht vetëm dy prej tyre janë ekzekutuar tërësisht si vlerë);

⁴² Konkretisht nga Gjykata e Apelit Vlorë (3 raste) dhe Gjirokastrë (2 raste).

⁴³ Vendimet lidhen me kërkesa të drejtuara gjykatës gjatë vitit 2021, por edhe kërkesa të depozituara më përpara.

- **1 vendim** është për refuzimin e kërkesës për lëshimin e urdhërit (ankimuar nga KMD pranë Gjykatës Administrative të Apelit);
- **1 vendim** për pushimin e gjykimit lidhur me kërkesën e KMD-së (ankimuar nga KMD pranë Gjykatës Administrative të Apelit).

Në total nga viti 2012 – 2021, KMD ka kërkuar pranë Gjykatës kompetente, lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për **53** vendime gjobe të nxjerra prej tij. Nga të cilat:

- **4** janë ende në fazë shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (KMD i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit).
- **5** janë në fazë shqyrtimi pranë Gjykatës Administrative të Apelit (KMD ka ankimuar vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për refuzimin e kërkesës për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit).
- **28** janë në procedura përmbartimore (Gjykata ka pranuar kërkesën e KMD-së për lëshimin e urdhërit, dhe KMD i është drejtuar me shkresë Zyrës Përmbartimore për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv).
- **12** janë ekzekutuar tërësisht (Zyra Përmbartimore ka dalë me vendim pushimi, pra gjoba është arkëtuar në buxhetin e shtetit).
- **3** janë shfuqizuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë (vendimet të paankimueshme nga KMD për shkak të vlerës).
- **1** është pezulluar nga KMD.

Në lidhje me debitorin (subjektin që KMD ka gjobitur), nga totali i gjithë vendimeve të gjobës, rezulton që në **13** raste debitor ka qenë një subjekt juridik privat/individ, dhe në **40** raste debitor ka qenë një organ publik/person fizik brenda personit juridik.

Në lidhje me vlerën totale të gjobave të vendosura nga KMD gjatë periudhës 2012 - 2021, ajo rezulton në **6 120 000** Lekë, nga të cilat **1 180 000** Lekë gjobë vendosur për subjekte private/individë, dhe **4 940 000** Lekë gjobë vendosur për organe publike.

Për periudhën 2012 – 2021, në buxhetin e shtetit janë arkëtuar **1 050 000** Lekë, vlerë gjobe e ekzekutuar nga KMD.

Theksojmë se nga totali i gjobave të ekzekutuara, vetëm **3** prej tyre i përkasin një subjekti juridik privat/individ, ndërsa **9** të tjera janë gjoba të ekzekutuara nga organet publike/persona fizikë brenda personit juridik.

➤ **Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.**

Sikurse rezulton edhe më sipër (pika A/1), Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, si gjykata kompetente për shqyrtimin në shkallë të parë të ligjshmërisë së vendim-marrjevetë Komisionerit, gjatë vitit 2021, ka komunikuar në total **71** vendime gjyqësore, ku KMD është thirrur në cilësinë e palës paditëse/palës kërkuuese dhe objekt gjykimi ka qenë shfuqizimi i vendimit të KMD-së për konstatimin e diskriminimit, shfuqizimi i vendimit të KMD-së për

konstatimin e mosdiskriminimit, shfuqizimi i vendimit të KMD-së për pushimin e procedimit, shfuqizimi i vendimit të KMD-së për mospranimin e ankesës, apo shfuqizimi i vendimit të KMD-së për sanksion me gjobë dhe 12 vendime gjyqësore, ku KMD ka qenë palë kërkuuese për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit.

Nga 71 vendime ku KMD është thirrur si palë e paditur, në vetëm 12 prej tyre, Gjykata ka vendosur pranimin e padisë duke shfuqizuar si të paligjshëm vendimin e Komisionerit, dhe në 1 rast ka vendosur pranimin e pjesës së padisë, duke shfuqizuar vetëm masën e urdhëruar nga KMD në vendim-marrjen e tij.

Referuar arsytimit të gjykatës në këto vendime, të cilët theksojmë se nuk janë të formës së prerë, rezulton se arsyet e shfuqizimit të vendimeve të Komisionerit janë kryesisht si më poshtë vijon:

- akti administrativ i Komisionerit është i pambështetur në ligj dhe prova⁴⁴;
- vlerësimi i Komisionerit ka tejkaluar diskrecionin e dhënë me ligjin organik⁴⁵;
- Komisioneri ka tejkaluar kompetencat kur konkludon gjatë hetimit administrativ të një ankese për diskriminim, se marrëdhënia e punës është zgjidhur në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme⁴⁶;
- Komisionerit nuk i takon të sillet si gjykatë dhe të ushtrojë kompetencat e pushtetit gjyqësor për të zgjidhur një konflikt mes dy palëve, duke urdhëruar punëdhënësin të paguajë pagën dhe lejen vjetore në favor të punëmarrësit⁴⁷;

⁴⁴ Me vendimin Nr. 1552 datë 19.05.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë ka shfuqizuar vendimin e KMD-së përmes të cilit ishte konstatuar diskriminimi i ankuesit, me arsyetimin se: "(...) Fakti që personit të tretë (ankuesit) i është bërë e ditur në çdo moment motivacioni i procedimit disiplinor duke u shoqëruar edhe me pretendime e prova konkrete që lidhen drejtpërdrejtë me përmbushjen e detyrimeve kontraktuale në një marrëdhënie pune, atëherë kjo është e mjaftueshme për të shmangur prezumimin e diskriminimit. Ndërsa në vendimin Nr. 1492 datë 17.05.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë u shpreh se: "(...) Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit për të respektuar veprimtarinë e tij profesionale, si pjesë e jetës së tij private, nuk e kaloi atë që ishte "e nevojshme në një shoqëri demokratike", për të ndjekur qëllimin legjitim të mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve duke siguruar funksionimin e mirë të dhe të duhur të sistemit të sigurtë në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale. Konsideratat e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i dhënë mundësi gjykatës të konkludojë se nuk ka patur shkelje të Ligjit Nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

⁴⁵ Me vendimin Nr. 1457 datë 11.05.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë, u shpreh se: "(...) Gjykata çmon se ky vlerësim i Komisionerit e tejkalon diskrecionin e dhënë me ligjin organik, pasi si çdo institucion tjetër, përfshirë edhe gjykatën, duhet respektuar dhe garantuar liria akademike dhe autonomia e Universitetit në të gjitha elementët e saj, dhe nuk mund të çenohet sipas veprime të karakterit të tillë ku arrihet një vlerësim i pambështetur mbi studime të dhënash për lëndën e trajtimit apo mbi dokumentat zyrtarë të cilësisë dhe standarteve të shpallura."

⁴⁶ Në vendimin Nr. 608 datë 05.03.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë u shpreh se: "(...) pala e paditur nga kuadri i provave të marra prej saj në hetimin administrativ dhe nga kuadri ligjor i zbatuar prej saj nuk mund të konkludojë dhe të kualifikojë vetë praktikën e aplikuar nga pala paditëse zgjidhje marrëdhënie pune. KMD nuk mund që nga një hetim administrativ me ankesë diskriminim për bindje politike të konkludojë për ligjshmërinë e marrëdhënies së punës që ka ekzistuar mes palëve ndërgjyqëse, apo për paligjshmëri të zgjidhjes së kontratës së punës. Ky katapultim faktik dhe ligjor i bërë nga KMD nuk ka asnjë bazë ligjore. Për më tepër KMD nuk e ka kompetencën e saj të vlerësojë bazueshmërinë e zgjidhjes së kontratës së punës në ligj pasi kjo është kompetencë vetëm e gjykatës që do të shqyrtonte një padi të paraqitur nga personi i tretë për këtë qëllim".

⁴⁷ Në vendimin Nr. 2373 datë 23.07.2021 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është shprehur se: "Gjykata arsyeton se nuk mjafton që trajtimi të jetë i padrejtë apo i paligjshëm për të qenë përpara diskriminimit, por është e domosdoshme që trajtimi i padrejtë t'vëndosë individin në kushtet e pabarazisë me persona të tjerë që ndodhen në rrethana të ngjashme apo të njehta me të. Në rastin objekt gjykimi, përfundimi i marrëdhënies së punës mes Shoqërisë dhe personit të tretë nuk ka rezultuar i padrejtë apo i paligjshëm sepse ende nuk ka një vendim gjyqësor të formës së prerë që ta vlerësojë si të tillë. Personi i trete ende nuk i është drejtuar një gjykatë kompetente për të cmuar në kuptim të ligjit,

- Komisioneri nuk provon faktin se ankuesi është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër apo një grup tjetër personash, duke paraqitur për këtë provë shkresore me të cilën të provohej si trajtimi në mënyrë më pak të favorshme, ashtu edhe personi konkret apo grupi i personave i cili është trajtuar në mënyrë më të favorshme⁴⁸;
- e drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore, ndaj disponimi i Komisionerit për të rikthyer në punë ankuesin është në tejkalim të kompetencave të tij⁴⁹;
- vendimi i KMD-së është akt administrativ i paligjshëm pasi ai është nxjerrë në kundërshtim me rrethanat e faktit dhe dispozitat urdhëruese të ligjit material, përsa kohë që provohet lidhja shkakësore midis shkakut të mbrojtur “bindja politike” dhe trajtimit të pafavorshëm;⁵⁰
- çështja e diskriminimit nuk është ngritur në gjykatë dhe as nuk është gjykuar nga gjykata në vendimin e saj, pra nuk ka patur një mbivendosje juridiksioni të tillë që KMD të pushonte hetimin administrativ.⁵¹

mënyrën sesi ka përfunduar marrëdhëniet e tij me punës me shoqërinë, rregullimin e pasojave që vijnë nga zgjidhja e marrëdhënies së punës, ... Jo çdo trajtim i paligjshëm përbën diskriminim. ... **Detyrimi i Komisionerit për të verifikuar nëse në një situatë të caktuar ka diskriminim apo jo, nuk mund të zhvendoset dhe të përfundojë në hetimin nëse jemi para një shtate paligjshmërie apo jo. Këtë gjë ka bërë Komisioneri në rastin objekt gjykimi.**”

⁴⁸ Në vendimin Nr. 2438 datë 09.09.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është shprehur se: “... Në këndvështrim dhe mbështetje të këtij parashikimi ligjor, pala e paditur nuk ka provuar faktet që ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Konkretisht **pala e paditur nuk ka provuar faktin se personi i tretë është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër apo një grup tjetër personash, duke paraqitur për këtë provë shkresore me të cilën të provohej si trajtimi në mënyrë më pak të favorshme, ashtu edhe personi konkret apo grupi i personave i cili është trajtuar në mënyrë më të favorshme.** Pra nuk provohet ekzistenca e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin të kryera nga pala paditëse. ... Ashtu si përgjegjësia penale, e cila kërkon ekzistencën e fajit si element subjektiv të saj, edhe përgjegjësia administrative lind për shkak të ekzistencës së elementit faj. Mungesa e këtij elementi shkarkon subjektin nga pasojat administrative. Në rastin konkret krahas mungesës së veprimeve/mosveprimeve në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Gjykata eidenton edhe mungesë të elementit faj nga pala paditëse, në trajtimin e personit të tretë për shkak të racës së tij. ...

⁴⁹ Në vendimin Nr. 2806 datë 15.10.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka shfuqizuar pjesërisht vendimin e KMD-së, vetëm për masën urdhëruese të rikthimit në detyrë të ankuesit, duke u shprehur se: “... e drejta e rikthimit në punë, nuk gëzon mbrojtje ligjore, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje, thonë në vendimin e tyre me Nr. 31 datë 14.04.2003 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë ... nga sa më sipër Gjykata çmon se vendimi i KMD-së në pikën 2 të tij është i paligjshëm duke qenë se është disponuar në tejkalim të kompetencave nga ana e KMD-së”.

⁵⁰ Në vendimin Nr. 2438 datë 09.09.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, është shprehur se: “... Në këndvështrim dhe mbështetje të këtij parashikimi ligjor, pala e paditur nuk ka provuar faktet që ka parashtruar dhe ka vënë në themel të veprimtarisë së kundërshtuar në gjykatë. Konkretisht pala e paditur nuk ka provuar faktin se personi i tretë është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër apo një grup tjetër personash, duke paraqitur për këtë provë shkresore me të cilën të provohej si trajtimi në mënyrë më pak të favorshme, ashtu edhe personi konkret apo grupi i personave i cili është trajtuar në mënyrë më të favorshme. Pra nuk provohet ekzistenca e veprimeve apo mosveprimeve në kundërshtim me ligjin të kryera nga pala paditëse. ... Ashtu si përgjegjësia penale, e cila kërkon ekzistencën e fajit si element subjektiv të saj, edhe përgjegjësia administrative lind për shkak të ekzistencës së elementit faj. Mungesa e këtij elementi shkarkon subjektin nga pasojat administrative. Në rastin konkret krahas mungesës së veprimeve/mosveprimeve në kundërshtim me Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Gjykata eidenton edhe mungesë të elementit faj nga pala paditëse, në trajtimin e personit të tretë për shkak të racës së tij. ...

⁵¹ Me vendimin Nr. 1736 datë 04.06.2021, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e padisë duke shfuqizuar vendimin e KMD-së për pushimin e procedimit administrativ për shkak se çështja po shqyrtohej në gjykatë. Gjykata ka argumentuar se: “(...) Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin Nr. 217 datë 01.02.2021, ka zgjidhur pretendimet e paditësit për pavlefshmëri të Vendimit Nr. 122 datë 15.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë për lirimin nga detyra dhe të Vendimit Nr. 124 datë 15.10.2020 të Komisionit të Shërbimit Civil (...). Në përmbajtjen e këtij vendimi gjyqësor nuk është analizuar asnjë pretendim i paditësit lidhur me

Sa i takon kërkesave për lëshim urdhëri ekzekutimi për titujt ekzekutivë “vendim gjobe” të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Gjykata në dy raste ka vendosur refuzimin/ pushimin e tyre, duke argumentuar se nga njëra anë Ligji i posaçëm “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nuk përcakton si titull ekzekutiv dhe ngarkimin e përmbarimit për ekzekutimin e tij për rastin e vendim-marrjes së KMD-së sipas pikës 11 të nenit 33, dhe nga ana tjetër veprimet administrative të kryera prej KMD-së nuk janë në asnjë prej rasteve të fushës së zbatimit të nenit 20 të Ligjit “Për kundravajtjet administrative”, dhe rrjedhimisht nuk gjen zbatim neni 22 i tij. Pra, akti administrativ nuk është titull ekzekutiv që vihet në ekzekutim prej shërbimit përmbarimor.⁵²

Duhet theksuar se tashmë që Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar në nenin 33/1 se: “1. Gjohet paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 45 ditë nga komunikimi i tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit, me kërkesë të Komisionerit. 2. Gjohet arkëtohet në buxhetin e shtetit”, një arsytim i tillë i Gjykatës si më sipër nuk mund të qëndrojë, dhe si rrjedhojë në të ardhmen nuk pritët të ketë refuzime të kërkesave të tilla, me këtë arsytim.

3.8 Rekomandime të Zyrës së KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik, të atributëve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; përmblotjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; si dhe zbatimit të nenit 32, pika 1, gërma “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë t’u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues”, **gjatë vitit 2021, me iniciativën e tij apo me kërkesë të**

diskriminimin e tij nga Bashkia. Për këtë arsye nuk është thirrur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe as nuk është marrë mendimi i tij lidhur me këtë çështje, sepse objekt i saj nuk ka qenë konstatimi i diskriminimit të paditësit nga Bashkia (...) Çështja e diskriminimit nuk është ngritur nga paditësi në atë gjykim dhe as gjykata nuk e ka shqyrtuar atë gjatë gjykimit (...) Duke krahasuar çështjen e zgjidhur nga Gj.Adm.Sh.I Tiranë nëpërmjet Vendimit Nr. 217 datë 01.02.2021 (vendim jo i formës së prerë), me çështjen që është shtruar për zgjidhje nga paditësi para Komisionerit, gjykata çmon se çështja gjyqësore me procedimin administrativ para Komisionerit, nuk kushtëzohet njëra – tjetrën (...) në nenin 32 të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, nuk bën pjesë pushimi i procedimit administrativ”.

⁵² Vendim Nr. 734 Akti datë 10.03.2021 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Të njëjtin qëndrim gjykata ka mbajtur edhe në Vendimin Nr. 799 Akti datë 05.03.2021, ku argumentoi se: “(...) gjykimi i kësaj çështje duhet të pushohet pasi është një kërkesë që nuk mund të ngrihet. Në rastin objekt verifikimi, akti për të cilin kërkohet lëshimi i urdhërit të ekzekutimit, Vendimi Nr. 126 datë 06.10.2020 nuk është një titull ekzekutiv. Vendim-marrja e palës kërkuese, qoftë kjo e formalizuar në një shumë lekësh, nuk përbën titull ekzekutiv në kuptim të ligjit, pasi vetë Ligji (Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”) nuk e parashikon këtë vendim-marrje si titull ekzekutiv. (...) gjithashtu në rastin konkret nuk jemi as para një kundravajtje administrative të parashikuar nga ligji. Pasi në rastin konkret vendim-marrja nuk është për një kundravajtje administrative, dhe vetë ky ligj (Ligji “Për kundravajtjet administrative”), nuk parashikon kundravajtjen administrative për këtë rast.”

institucioneve përkatëse, ka dhënë rekomandimet dhe opinionet ligjore, si më poshtë vijnë:

3.8.1 Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore

- **Rekomandime mbi “Planin kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve 2021-2025”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.⁵³**

Në kuadër të hartimit të Planit të ri të Veprimit për periudhën 2021-2025, me kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Komisioneri ka dhënë rekomandimet dhe sugjerimet e tij, ku në lidhje me fushën e arsimit, punësimit dhe mbrojtjes sociale. Ku ndër të tjera ka theksuar rëndësinë e inkurajimit të regjistrimit të popullsisë rome dhe egjiptiane, si një masë paraprake për realizimin e objektivit të regjistrimit të detyrueshëm të të gjithë nxënësve romë dhe egjiptianë të moshës 6-16 vjeç, duke përfshirë gjithashtu edhe rastet e nxënësve që e kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm, dhe kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë.⁵⁴

Në lidhje me fushën e mbrojtjes sociale, së pari, Komisioneri ka sjellë në vëmendje se, situata financiare e familjeve në nevojë që përfitojnë ndihmë ekonomike, të cilët kanë në përbërje të tyre fëmijë që ndjekin rregullisht procesin mësimor në shkolla, është rënduar më tepër për shkak të detyrimeve të përcaktuara në protokollet e sigurisë në shkolla, sipas të cilave nxënësit duhet të jenë të pajisur me masa mbrojtëse: maska, dizinfektantë dhe letra higjienizuese. Në kushtet kur ata nuk mund të përballojnë financiarisht një detyrim të tillë, duhet shqyrtuar mundësia e krijimit të një pakete financiare në ndihmë të tyre, nga institucionet përgjegjëse shtetërore. Për këtë arsye, në objektivin Nr. 6 “Marrja e masave të menjhërshme për përmirësimin e situatës post COVID-19 për romët dhe egjiptianët” pika 6.2 “Përforsim të masave të mbrojtjes sociale për romët dhe egjiptianët nëpërmjet kombinimit të stimulave financiarë dhe shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”, si dhe pika 6.3 “Vazhdimi i mbështetjes së familjeve në nevojë me pako ushqimore, barna dhe mjete higjienike”, KMD ka sugjeruar që të shtohet një parashikim ku të identifikohen rastet e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, pasi kjo situatë ka krijuar një barrë të tepruar tek kjo kategori, ndaj duhet parë mundësia që të miratohet një pagesë shtesë tek këto familje, me qëllim përmbushjen e detyrimit për përdorimin e barrierave mbrojtëse nga fëmijët gjatë frekuentimit të mjediseve shkollore.⁵⁵ Së dyti, në objektivin Nr. 1 “Përfshirja e Romëve dhe Egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale”, pika 1.7 “Rishikim i VKM-së për familjet rome dhe egjiptiane në nevojë, që përfitojnë nga kompensimi

⁵³ Referuar Shkresës Nr. 901 Prot., datë 14.06.2021 të KMD-së.

⁵⁴ Referuar Raportit të ECRI-t (cikli i gjashtë monitorues), datë 07.04.2020, Kreu III “Integrimi dhe përfshirja”, Pika A “Romët dhe egjiptianët”, paragrafi Nr. 43: “Ndërkohë që në vitin 2011, vetëm 48% e fëmijëve romë dhe egjiptianë kanë qenë të regjistruar në arsimin e detyrueshëm (që zgjat nga moshë 7 deri në 15 vjeç), në krahasim me 91% të popullsisë së përgjithshme, në vitin 2018 kjo u rrit në 66%. 50 Sidoqoftë, është gjithashtu e qartë se ky numër është ende shumë i ulët dhe prandaj ECRI u kujton autoriteteve që qëllimi i përgjithshëm duhet të jetë mbjllja, dhe jo vetëm ngushtimi i boshllëkut të regjistrimit midis fëmijëve me origjinë rome dhe egjiptiane, dhe fëmijëve të tjerë, në mënyrë që aksesimi në arsim të sigurohet në një bazë të barabartë.”

⁵⁵ Referuar Shkresës Nr. 1398 Prot., datë 15.10.2020 “Rekomandim për miratimin e një fondi shtesë të skemës së ndihmës ekonomike, në vlerën prej 500 lekë në muaj, për çdo fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, të cilët ndjekin rregullisht procesin mësimor”, te KMD-së, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

i energjisë elektrike të përcaktuar nga Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, KMD ka sugjeruar që familjet romë me fëmijë minorenë, të përfshihen në listën e familjeve që përfitojnë nga kompensimi i energjisë elektrike, dhe të shmangen procedurat administrative që mund të përbëjnë pengesë në përfshirjen e tyre në këtë program.

KMD ka theksuar faktin që këtij institucioni i janë lënë në përgjegjësi shumë aktivitete, në rolin e instituconit përgjegjës dhe duke patur parasysh misionin e tij, duhet që në këtë matricë roli i tij të jetë monitorues dhe jo zbatues siç është parashikuar. Parë kjo edhe në kuadër të pavarësisë së instituconit, të cilit nuk duhet t’i rëndojnë kostot dhe shpenzimet për implementimin e këtij plani.

➤ **Rekomandim në lidhje me “Draft matricën e planit të veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje të romëve dhe egjiptianëve (2021-2025)”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.**⁵⁶

Komisioneri ka rekomanduar se për nxitjen e zbatimit të këtij plani, duhet që vlerësimi dhe monitorimi i zbatimit të masave të bëhet në mënyrë periodike, për periudhë 1-vjeçare.

Lidhur me terminologjinë e përdorur në këtë Plan Veprimi, KMD ka rekomanduar përdorimin e një gjuhe sa më pak diskriminuese, dhe të unifikuar sa i takon termave të tillë si “minoritet”, apo “komunitet”.

KMD ka evidentuar mungesën e parashikimit në disa aktivitete, të institucioneve përgjegjëse. KMD gjithashtu ka vlerësuar si element të rëndësishëm parashikimin e burimit financiar dhe kostove për të siguruar realizimin e objektivave të përcaktuara.

Është parë e nevojshme që Plani të strukturohet në një mënyrë të tillë që çështje të veçanta të cilat kërkojnë prioritet dhe zgjidhje të menjëhershme, të fillojnë direkt me zbatimin e tyre.

KMD ka vlerësuar se Plani duhet të parashikojë disa aktivitete si çështje parësore, referuar këtu Rekomandimeve të Raportit të ECRI-t për Shqipërinë, të tilla si:

- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të domosdoshme për Ligjin “Për ndihmën juridike”;
- Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore të domosdoshme për Ligjin “Për strehimin social”;
- Zgjidhje e shpejtë për krizat afatgjata të strehimit që prekin komunitete romë dhe egjiptiane në zonat e Kabashit dhe Gurit të Kuq të Bashkisë Pogradec;
- Miratimi i VKM-së “Për hartimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.”

Të gjitha këto aktivitete prioritare duhet të parashikojnë edhe afatin e realizimit të tyre, sikurse ka rekomanduar ECRI në raportin e tij, treguesit, institucionet përgjegjëse dhe kostot etj.

⁵⁶ Referuar Shkresës Nr. 902 Prot., datë 14.06.2021 të KMD-së.

- **Rekomandime në lidhje me matricën e Planit të Veprimit për “Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.**

KMD ka propozuar që në masat e propozuara si: “Informimi, sidomos i grave dhe vajzave në zonat urbane e rurale, mbi legjislacionin e përmirësuar në lidhje me të drejtat pronësore të grave, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore”, informimi të bëhet jo vetëm për të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, por mbi të drejtën e pronësisë në përgjithësi, si një e drejtë e garantuar në Kushtetutë për çdo individ. Ndërsa për masën e propozuar “Shtimi i gamës së kurseve që ofrohen në QFP të përshtatura me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, përfshirë dhe kurse/module të reja, që kanë të bëjnë me teknologjinë, dixhitalizimin, të punuarit online, etj”, KMD ka propozuar që të shtohet një modul specifik ku të trajtohet pjesa e diskriminimit gjinor, mbrojtja ligjore që parashikohet nga ligji, në mënyrë që gratë dhe të rejtat të jenë të informuara paraprakisht për këtë pjesë, pa dalë ende në tregun e punës. (Në konceptin e një masë parandaluese).

- **Rekomandime lidhur me Projektvendimin “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021 – 2025”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.⁵⁷**

Komisioneri në komentet e tij ka vënë në dukje disa problematika ku ndër të tjera përmendim faktin e mospasqyrimin të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, dhe të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion me rol monitorues në lidhje me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Komisioneri ka rekomanduar që plani të harmonizohet me Konventën “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, të shtohen personat me aftësi të kufizuara që i përkasin komunitetit LGBTI si grupe të identifikuar si më të cënueshme nga diskriminimi.

KMD ka rekomanduar që në radhë të parë, ky plan veprimi duhet të nxisë zbatimin e VKM-së Nr. 708/2015 “Për llojet, periodicitetin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore për aftësinë e kufizuar nga strukturat shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, si një akt i cili është në fuqi dhe më pas të vlerësohet nevoja për rishikimin e tij. Me qëllim vënien në zbatim të kësaj VKM-je, KMD ka propozuar që të parashikohen si aktivitete:

- Përmirësimi i mekanizmit të monitorimit dhe vjeljes së penaliteteve që rrjedhin nga moszbatimi i kuotave të punësimit të PAK;
- Zyrat e punësimit duhet të informojnë bizneset me programet e nxitjes së punësimit dhe përfitimit që ata mund të kenë në rastet e punësimit të të rinjve me aftësi të kufizuara nëpërmjet këtyre programeve;
- Krijimi i një partneriteti të strukturuar për punësimin e personave me aftësi të kufizuara duke përfshirë qendrat e rehabilitimit, bizneset sociale, arsimin profesional, zyrat e punës dhe bizneset;

⁵⁷ Referuar Shkresës Nr. 76 Prot., datë 21.01.2021 të KMD-së dhe Shkresës Nr. 545/1 Prot., datë 09.04.2021 të KMD-së.

- Zyrrat pranë bashkive, që merren me çështjet e punësimit, të koordinohen me zyrrat rajonale të punës (punësim i ndërmjetësuar);
- Bizneset që nuk zbatojnë ligjin “Për nxitjen e punësimit”, lidhur me kuotën e punësimit të PAK, të përjashtohen nga prokurimet publike;
- Trajnimi i mësuesve të shkollave speciale për të ofruar trajnime me fokus aftësimin për jetën;
- Mësuesit e shkollave speciale të mund të punojnë si mësues ndihmës në arsimin gjithëpërfshirës;
- Në kurrikulat e universiteteve, në degën e ciklit të ulët, duhet të përfshihen programet për aftësimin e mësuesve të ardhshëm, në mënyrë që ata të përgatiten për të punuar me fëmijë me aftësi të kufizuara;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore të trajnohen për të përdorur dhe tërhequr fonde nga fondi social;
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore të trajnohen për të ofruar shërbime komunitare me fokus trajnimin e personave me aftësi të kufizuara për jetesë të pavarur etj.

➤ **Rekomandime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Projektligjin “Për krijimin e regjistrit për autorët e krimeve seksuale”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.⁵⁸**

Në lidhje me këtë Projektligj të hartuar nga Linja e Këshillimit të Grave dhe shoqata të tjera, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka parashtruar komentet e tij, duke propozuar që të parashikohet një nen i posaçëm me titull “Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit”, i formuluar si më poshtë: “Të dhënat e këtij regjistri dhe aksesit i publikut në të, duhet të përdorën duke mbajtur parasysh parimin e mosdiskriminimit si për autorët e krimeve seksuale, të afermit e tyre dhe viktimat e krimeve seksuale”.

Ndërsa në nenin 12 të Projektligjit, KMD ka propozuar që të parashikohet “Kohëzgjatja e detyrimeve të regjistrit”, i cili parashikon mundësinë e daljes nga regjistri të autorëve të krimeve seksuale në përmbushjen e kushteve të parashikuara nga neni 12. Me qëllim mbajtjen parasysh të interesit më të lartë të fëmijës, të parashikohet një pikë 2 në vijim të nenit 12 si më poshtë: “2. Pavarësisht afateve kohore të parashikuara me sipër, nga regjistri kombëtar i autorëve të krimeve seksuale, nuk do dalin autorët të cilët e kanë ushtruar këtë vepër penale ndaj fëmijëve gjatë ushtrimit të profesionit të tyre ose duke përfutur nga profesioni.”

➤ **Rekomandime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Projektligjin “Për krijimin e regjistrit kombëtar për të dënuarit për krime seksuale”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.⁵⁹**

Në lidhje me këtë projektligj të hartuar nga CRCA/ECTAP, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka parashtruar komentet e tij, duke propozuar që në nenin 21 (Kreu IV), pika 2 “Dosja unike e personalizuar”, të shtohet e dhëna personale “amësia”, për sa kohë është e

⁵⁸ Përcjellë me shkresën Nr. 1706 Prot., datë 13.12.2021, të KMD-së.

⁵⁹ Përcjellë me shkresën Nr. 1707 Prot., datë 13.12.2021, të KMD-së.

dhënë thelbësore për identifikimin e individit. Në po këtë nen, pika 2 (Formulari A) shkronja “f” është parashikuar edhe termi “kombësi”, për të cilin KMD ka propozuar që të hiqet si element identifikimi, përse kohë ky term është shfuqizuar nga regjistrat e gjendjes civile, me vendimin Nr. 52, datë 01.12.2011 të Gjykatës Kushtetuese.

Në nenin 34 të Projektligjit, *“Të drejtat e të dënuarit për krime seksuale”*, krahas parashikimeve ekzistuese KMD ka propozuar të shtohen edhe dy pika të tjera të cilat garantojnë të drejtat e të dënuarit, si më poshtë: *“ - E drejta e të dënuarit për t’u përfaqësuar me një avokat kryesisht në rast të pamundësisë ekonomike. - E drejta për t’u mosdiskriminuar për shkak të statusit të tij, përveç rasteve të justifikimit objektiv nga një synim i ligjshëm.”*

Ndërsa në nenin 40 të Projektligjit *“Kohëzgjatja e regjistrimit dhe dalja nga regjistri”*, ku parashikohet dalja nga regjistri në momentin e rehabilitimit, KMD ka propozuar se duhet që të ketë një dispozitë ku të parashikohet heqja e së drejtës për të ushtruar ato lloj profesioneve që lidhen në mënyrë direkte me fëmijët, në mënyrë të përhershme, pavarësisht rehabilitimit sipas nenit 69 të Kodit Penal.

➤ **Rekomandime në lidhje me “Draft – tabelën e aktiviteteve të planit të ri për personat LGBTI në Shqipëri për vitet 2021 – 2027”, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.⁶⁰**

Komisioneri në komentet e tij ka rekomanduar vendosjen si institucione përgjegjëse të të dy organeve të barazisë, në lidhje me aktivitetet e parashikuara për rritjen e aksesueshmërisë së personave LGBTI në shërbimet publike, duke propozuar për këtë qëllim edhe shtimin e aktiviteteve të ndryshme si realizimi i një cikli trajnimesh për nëpunësit civilë mbi respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI, raportimin mbi numrin e ankesave, çështjeve të shqyrtuara kryesisht, si dhe vendimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KMD lidhur me aksesin e personave LGBTI në shërbimet sociale etj.

Në lidhje me zbatimin si duhet të legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI, Komisioneri ka rekomanduar të shtohet si aktivitet raportimi mbi numrin e çështjeve të shqyrtuara dhe vendimeve/rekomandimeve të dhëna, ku është konstatuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, dhe të shtohet si institucion përgjegjës KMD për pjesën e raportimit. Ndërkohë për arritjen me efektivitet të këtij objekti duhet të vendoset si institucion përgjegjës edhe Prokuroria e Përgjithshme, pasi luan një rol kyç në klasifikimin e krimeve të urrejtjes, dhe në mbajtjen e të dhënave respektive për këto raste. Për më tepër që raportimi i krimeve që lidhen me gjuhën e urrejtjes është i ulët, ndaj rekomandohet që të ketë në këtë drejtim një gjithëpërfshirje të organeve përgjegjëse.

Në lidhje me çështjet dhe protokollet LGBTI përfshirjen si pjesë e detyrueshme e trajnimit në Akademinë e Sigurisë dhe në Shkollën e Magjistraturës të çështjeve dhe protokolleve të LGBTI-së, KMD ka rekomanduar realizimin e një sondazhi lidhur mbi diskriminimin e personave LGBTI me qëllim që të evidentohen rastet e raportuara dhe të paraportuara, si dhe vendosjen

⁶⁰ Përcjellë me shkresën Nr. 1079 Prot., datë 14.07.2021, të KMD-së.

e KMD-së si institucion përgjegjës, për pjesën e trajnimeve në Akademinë e Sigurisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

Në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut mbi të drejtat e njeriut LGBTI dhe pranimi i personave LGBTI mes publikut të gjerë, KMD ka rekomanduar që institucione përgjegjëse për pjesën e sondazhit të jenë të dyja organet e barazisë, në mënyrë që edhe niveli i përfshirjes së publikut të jetë sa më i gjerë, si dhe që të mbahet në fokus, bashkëpunimi ndërinstitucional lidhur me kryerjen e aktiviteteve ndërgjegjëse për këtë objektiv.

➤ **Rekomandime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për Projektligjin “Për padinë kolektive”, drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.⁶¹**

Në lidhje me këtë projektligj, Komisioneri me qëllim arritjen e trajtimit të barabartë dhe parandalimit të diskriminimit, ka bërë me dije se në rastet e dyshimeve për diskriminim ndaj një numri të madh personash të papërcaktueshëm, por me të njëjtën karakteristikë ose shkak të mbrojtur sipas parashikimeve të nenit 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nëpërmjet padisë kolektive për pushimin e cenimit mund të kërkohet ndalimi i veprimeve apo tentativës për veprime dhe mospërsëritja e tyre në të ardhmen, që sipas ligjit që rregullon mbrojtjen nga diskriminimi përbëjnë diskriminim.

Përsa më sipër në nenin 54 “Personi i legjitimuar” të Projektligjit “Për paditë kolektive”, Komisioneri ka rekomanduar të shtohet si person i legjitimuar edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në lidhje me nenin 2 të Projektligjit, pika 1, germa “g”, ku është parashikuar që padia kolektive mund të ngrihet në rastet kur ekziston diskriminimi kolektiv, Komisioneri ka propozuar që kjo pikë të riformulohet duke u sjellë në përputhje edhe me parashikimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Komisioneri ka rekomanduar që neni 2, pika 1, germa “g” i Projektligjit “Për paditë kolektive”, të riformulohet si më poshtë: “Shkelja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ndërsa në nenin 5 (Shqyrtimi i padisë kolektive) ku parashikohet që paditë kolektive të gjykohen në Gjykatën e vendit ku ka vendbanimin ose vendqëndrimin pjesa më e madhe e anëtarëve të grupit, dhe kur kjo nuk është e mundur të përcaktohet, kompetente për gjykimin e kësaj padie është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Duke qenë se në ngritjen e një padie ka një rëndësi thelbësore kompetenca lëndore, tokësore e Gjykatës, në kushtet kur përcaktimi “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë” kufizon të drejtën e ngritjes së padisë, Komisioneri ka propozuar që në çdo rast shqyrtimi i padive kolektive duhet të bëhet nga Gjykata kompetente në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

⁶¹ Përcjellë me shkresën Nr. 1705 Prot., datë 13.12.2021, të KMD-së.

3.8.2 Rekomandime për çështje të veçanta

- **Rekomandim i përbashkët i KMD-së dhe KQZ-së, “Për parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore”.**⁶²

Duke patur si fokus fushatën zgjedhore të datës 25.04.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim edhe me Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve kanë dalë në një rekomandim të përbashkët, ku kanë theksuar nevojën dhe detyrimin e partive politike si dhe organeve të medias, për respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

Konkretisht është rekomanduar që partitë politike dhe organet e medias të shqyrtojnë miratimin apo të mbështeten në Kode të Sjelljes për Fushatat Zgjedhore në të cilat ekzistojnë rregulla mbi diskriminimin, ngacmimin dhe gjuhën e urrejtjes; që partitë politike dhe kandidatët, si dhe njerëzit që punojnë për ta, duhet të refuzojnë në programet dhe fushatat e tyre të përdorin gjuhë diskriminuese ose të propozojnë politika dhe ligje diskriminuese, të shprehin ose mbështesin ide apo teori të superioritetit të një grupi personash bazuar në racën, origjinën etnike, fenë, gjininë, moshën, orientimin seksual, identitetin gjinor, aftësinë e kufizuar si dhe karakteristika të tjera të mbrojtura ose një kombinim i tyre; që organet mediatike në mbulimin e fushatave zgjedhore prej tyre të refuzojnë të përdorin apo të mbështesin gjuhë urrejtje; që partitë politike të sigurojnë në listat e tyre një përfaqësim i cili pasqyron diversitetin e njerëzve në shoqëri etj.

- **Rekomandim “Për ndryshimin e nenit 10 dhe nenit 13 të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar dhe përditësimin e teknologjisë së tij, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.**⁶³

Marrë shkas nga fakti që neni 10 dhe 13 i Ligjit Nr. 8098/1996 diferencon një shoqatë të vetme, konkretisht Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë duke e nominuar atë shprehimisht dhe duke e trajtuar atë në mënyrë më të favorshme dhe preferenciale në raport me shoqata të tjera që mbrojnë interesat e personave të verbër në Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka rekomanduar që neni 10 dhe 13 duhen ndryshuar duke hequr parashikimin eksplisit për Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë dhe duke parashikuar gjithpërfshirjen e të gjitha organizatave me interesa legjitime apo subjekteve përfaqësuese të personave me aftësi të kufizuara në shikim, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Gjithashtu, Komisioneri ka rekomanduar përditësimin e terminologjisë të Ligjit Nr. 8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, i ndryshuar, me qëllim unifikimin dhe përafrimin me terminologjinë dhe me modelin bio-psiko-social të Konventës së Kombeve të Bashkuara “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

⁶² Referuar Shkresës Nr. 173 Prot., datë 25.01.2021 të KMD-së.

⁶³ Referuar Shkresës Nr. 740 Prot., datë 10.05.2021 të KMD-së.

- **Rekomandim “Për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”.**⁶⁴

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka parashtuar këtë Rekomandim me qëllim hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.

Rekomandimi synon eliminimin e situatës diskriminuese, në dëm të personave me mungesë të plotë ose të pjesëshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, e krijuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit për nxjerrjen e akteve nënligjore, në bazë e për zbatim të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statutin e invalidit”, i ndryshuar.

Sjellim në vëmendje se KMD i ka adresuar më herët rekomandim me të njëjtën përmbajtje, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me shkresën Nr. 420 Prot, datë 06.03.2020, me lëndë: “Dërgohet Rekomandim për hartimin dhe miratimin e aktit nënligjor përkatës për sigurimin e pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”. Në përfundim, KMD ka kërkuar përcjelljen e informacionit, brenda 30 ditëve nga marrja dijeni, në lidhje me veprimet që do të ndërmerren nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion përgjegjës, për zbatimin e këtij rekomandimi.

Duke qenë se situata e pandemisë së Covid-19, e shpallur menjëherë më pas në vendin tonë, ka përballur Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucion për menaxhimin e situatës dhe ka diktuar një sfidë të madhe, KMD ka mirëkuptuar mos-dhënien e vëmendjes së duhur në adresim të kësaj problematike që parashtrohej në rekomandim.

Për këtë arsye, Komisioneri ka vlerësuar nevojën për ri-adresimin e këtij rekomandimi, i cili në vetvete përmban, nga njëra anë, një çështje sensitive për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe nga ana tjetër, një detyrim për t’u përmbushur nga shteti, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe standarteve për personat me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i këtij Rekomandimi është eliminimi i situatës diskriminuese që është krijuar në dëm të personave me mungesë të plotë ose të pjesshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, e krijuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimit për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të Ligjit Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, si dhe Ligjit Nr. 7889, datë

⁶⁴ Referuar Shkresës Nr. 809 Prot, datë 28.05.2021 të KMD-së.

14.12.1994 *"Për statutin e invalidit"*, i ndryshuar. *"Rregullimi i domosdoshëm dhe i përshtatshëm"* që nevojitet në rastin në fjalë dhe që është rekomanduar nga KMD është sigurimi i pajisjeve ndihmëse tifloteknike për të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesëshme shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët përfitojnë nga Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 *"Për statusin e të verbërit"*.

3.8.3 Kontribute të tjera të KMD-së

- Analizuar databaza e Hudoc, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, për çështjet e komunikuara, lidhur me nenin 14 dhe Protokollin Nr. 12 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Përkthim i disa vendimeve që lidhen me diskriminimin;
- Komente të KMD-së lidhur me Projekt-Vendimin *"Për kushtet dhe normat e projektvendimit të banesave të specializuara"*;
- Komente të KMD-së në lidhje me *"Draft Rekomandimin e Këshillit të Europës mbi luftën ndaj gjuhës së urrejtjes"*;
- Komente të KMD-së që reflektojnë ndryshimet ligjore në *"Studimin Krahësues mbi Gjuhën e Urrejtjes"*;
- Komente të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me *"Draft - Raportin e Rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga Komiteti i Palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"*.
- Komente të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me *"Draft – tabelën e aktiviteteve të Planit të ri për Personat LGBTI në Shqipëri për vitet 2021-2027"*;
- Kontribut i KMD-së lidhur me Konventën *"Për të Drejtën e Organizimit dhe Marrëveshjeve Kolektive, 1949 (Nr. 98)"* të Organizatës Ndërkombëtare të Punës;
- Kontribut i KMD-së lidhur me Projekt Raportin e tretë kombëtar periodik për zbatimin e *"Konventës kundër Torturës dhe Vujatjeve të Tjera ose Trajtimit Mizor, Jonjerëzor dhe Degradues"*;
- Kontribut i KMD-së lidhur me Projektvendimin *"Për miratimin e Raportit të 13-14 të Kombëtar periodik për zbatimin e Konventës Ndërkombëtare "Për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor"*;
- Kontribut i KMD-së lidhur me pyetjen e shtruar nga Komisioneri Evropian, sa është deklaruar në Deklaraten Poznan, lidhur me pyetjen mbi ngritjen e një sektori të pavarur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ose përcaktimi i një Komisioneri, të dedikuar për Romët dhe Egjiptianët;
- Kontribut i KMD-së mbi Rezolutën 75/169 të OKB-së: *"Për të luftuar glorifikimin e nazizmit, neo-nazizmit dhe politikave të tjera që nxisin racizmin, diskriminimin racor, ksenofobinë dhe intolerancën"*;
- Kontribut i KMD-së për Konventën Nr. 100 të ILO-s;
- Kontribut i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *"Mbi zbatimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut 2019 – 2023, Janar – Qershor 2021"*;
- Kontribut i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi *"Mbi zhvillimin e takimit të 13-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri "Drejtësia, Liria dhe Siguria", në dhjetor 2021"*;

- Kontribut lidhur me pyetësonin e SOGI, mbështetur në Rezolutën 32/2 dhe 41/18 të Këshillit të Drejtave të Njeriut, në përgjigje të kërkesës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- Kontributi i dytë i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi lidhur me Raportin e Komisionit European, për Kapitullin 23;
- Kontributi i I-rë i KMD-së për Progres Raportin e 2021, Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”;
- Kontributi i I-rë i KMD-së për Progres Raportin e 2021, Kapitulli 19 “Punësimi”;
- Kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të Raportit Vjetor të Departamentit Amerikan të Shtetit, për të Drejtat e Njeriut, 2021;
- Material lidhur me vendimet e gjobës të ekzekutuara për periudhën 2018 – 2021 nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Përmbledhje informacioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me Raportin për Kartën Sociale 2021, për të drejtat në punë;
- Raportim lidhur me vendimet gjyqësore të komunikuara pranë KMD-së, që lidhen me “gjuhën e urejtjes”, ndaj personave LGBTI;
- Trajtimi i informacionit të ridërguar nga ADRF, sipas shkresës me lëndë: *“Konstatimi i diskriminimit de jure në Kodin Civil, Kodin e Familjes, Kodin e Proçedurës Civile ndaj personave me aftësi të kufizuara apo me gjendje shëndetësore të caktuara të cilëve i hiqet zotësia juridike për të vepruar”*.

3.9 Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vitit 2021 KMD ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin etj, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me daljet në media vizuale dhe e shkruar si më poshtme:

Janar – TTV, Syri.net, ATA, Top Channel, Gazeta-shqip, Ballkanweb, Open data;

Shkurt – RTSH, Informim.al;

Mars – RTSHKorça, Ora News, Top Channel, A2CNN, VloraNews, Newsbomb.al;

Prill – Elbasaninews.tv, Zeri Amerikes, Euro News, Scan Tv;

Maj – Albanian Times.al, Dosja.al, Reportes Albania.al;
 Qershor – Top Channel, Tirana News.al, Dosja.al, Reporter.al, InfoWeb TV, Aler.al;
 Korrik – Faxnews, MCN Tv, RTSH2, Faxweb, Top Channel, Skampa TV;
 Shtator – A2CNN Tv, Reporter Al, Liberale.al;
 Tetor – Syri Tv, Newsbomb.Al, VOA-Zëri i Amerikës, A2CNN, MCNTv, A2 News;
 Nëntor – VOA-Zëri i Amerikës, MCNTv, Euro News Al, Vizion+ Tv, Leviz Al;
 Dhjetor – Euro News Al, RTK, A2 News, Shqiptarja.com.

Në total janë 51 raportime në media për promovimin e luftës kundër diskriminimit dhe të drejtave të njeriut.

3.9.1 Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media

Gjatë vitit 2021, Komisioneri dhe Zyra kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop-e, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Janar

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda zhvilloi një takim me Z. Ilirian Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Në këtë takim u bisedua për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe i diskriminimit gjatë fushatës zgjedhore të pritshme, si dhe nevojën për aksesin në informacion, krijimin e kushteve të përshtatura në personat me aftësi ndryshe, sipas llojit të kufizimit të aftësisë. Të dyja palët dakordësuan miratimin e përbashkët dhe publikimin e një rekomandimi për të parandaluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës zgjedhore si edhe një akt të përbashkët për respektimin e kuotës gjinore.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda zhvilloi një takim me znj. Monika Kryemadhi, Kryetare e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të pritshme të 25 Prillit.
- Përfaqësues të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi morën pjesë në Tryezën Kombëtare të Diskutimit: *“Të drejtat e grave punonjëse në fabrikat “fason”, Covid 19 dhe perspektiva për vitin 2021”*, e organizuar nga Qendra *“Aleanca Gjinore për Zhvillim”* (GADC) në kuadër të projektit *“Të drejtat e grave në tregun e punës”*.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda priti në një takim Ambasadorin e Republikës Franceze në Shqipëri, znj. Elisabeth Barsacq, shoqëruar nga atasheja për bashkëpunim, znj. Anne Elisabeth Gautier-Budai.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda priti në një takim Kryetarin e Prezencës së OSBE në Shqipëri, Z. Vincenzo Del Monaco. Komisioneri vuri në dukje se institucioni i KMD po angazhohet para zgjedhjeve parlamentare me subjektet politike për një kujdes të veçantë për grupet vulnerabël dhe shmangien e gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës elektorale.

- Në kuadër të përgatitjeve të zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit 2021 dhe respektimit të detyrimeve Kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, kanë nënshkruar një dokument me disa Rekomandime të përbashkëta për subjektet politike pjesëmarrëse në fushatën elektorale.

Shkurt

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me Avokaten e Popullit të Shqipërisë, Znj. Erinda Ballanca kanë zhvilluar një takim me Avokati i Popullit të Kosovës, z. Naim Qelaj. Gjatë takimit u diskutua edhe ndikimin i pandemisë Covid-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Shqipëri dhe puna që është bërë nga të dyja institucionet në adresimin e ankesave të subjekteve.
- Akademia e Integritetit European dhe Negociatave zhvilloi një sërë trajnimesh për rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile dhe administratës në kuadër të çeljes së negociatave me BE. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte i ftuar të trajtonte detyrimet e Shqipërisë për mbrojtjen ndaj diskriminimit, kuadrin e minoriteteve, si edhe sfidat e perspektivat e Shqipërisë në përmbushje të kërkesave të Kapitullit 23.

Mars

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në Ceremoninë e Prezantimit të Rrjetit të Mësuesve në shkollën 9-vjeçare "Abdyl Paralloi" Elbasan, organizuar në prag të 7 Marsit dhe në kuadër të projektit të Këshillit të Europës *"Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri"*, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.
- Pranë ambienteve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi u organizua një takim me QBNF-së me qëllim vendosjen e bashkëpunimit për implementimin e projektit me teme: *"Sfido Urrejtjen-Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit"*, i cili financohet nga Autoritetit i Mediave Audiovizive.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në takimin e rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Durrës, ku diskutuam mbi risitë e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mundësitë për bashkëpunim në kuadrin e zbatimit të këtij ligji. Aktiviteti u organizua në kuadrin e projektit *"Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Durrësit"*, i cili po zbatohet nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda zhvilloi një takim në Vlorë me organizatat e shoqërisë civile në terren, zyrën e Avokatit të Popullit dhe Autoritet vendore të qarkut Vlorë për të shpjeguar risitë e ndryshimeve në ligjin për

Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku parashikohet tashmë më shumë të drejta të garantuara për grupet vulnerabël dhe promovimin e barazisë.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ishte në Shkodër së bashku me ofuesit të shërbimit ligjor falas dhe Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare për të diskutuar mbi rëndësinë e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe mundësitë për bashkëpunim në kuadrin e zbatimit të këtij ligji.
- Aleanca kundër Gjuhës së Urrejtjes (AKGJU) së bashku me Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, si dhe përfaqësues të Partive Politike të regjistruar si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme të datës 25 Prill 2021 morën pjesë në një takim prezantues të një Kodi Etik dhe një Udhëzuesi për Sjelljen, gjatë fushatës zgjedhore.
- Zhvillohet online trajnimi i përbashkët me Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit, Zyrrat Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrat për Ndihmë Juridike Falas. Qëllimi ishte diskutimi i praktikave për marrjen e ndërsjellët të ankesave mes ZRve dhe raste të veçanta për trajtim nga organet kompetente.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në Konferencën Rajonale "Në themel të të Drejtave të Njeriut: Institucionet Kombëtare Efektive të të Drejtave të Njeriut për Ballkanin Perëndimor", organizuar nga CIVIL RIGHTS DEFENDERS dhe Instituti Politikave Europiane.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në eventin mbi koordinimin institucional ndaj diskriminimit me bazë gjinore në punë si dhe për ndarjen e praktikës së mirë në Lezhë për reagim, të organizuar nga qendra Komunitare "Sot Për Të Ardhmen".
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim Znj. Lejdi Dervishi, Drejtor i Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE), ku u diskutua mbi veprimtarinë e KMD dhe angazhimin për të monitoruar edhe institucionet publike në raport me respektimin e të Drejtave të Njeriut.

Prill

- Në kuadër të 8 prillit "Ditës Ndërkombëtare të Romëve", Rrjeti i Organizatave R/E Korce, Zyrra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi Korçë me mbështetjen e Bashkisë organizuan takimin me temë: "Të drejtat dhe sfidat e minoritetit Rom në Shqipëri".
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në një aktivitet kushtuar problematikave të autizmit në vend dhe nevojave për të garantuar shërbime cilësore edhe gjatë situatës së Pandemisë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim online me Drejtoreshën e Përgjithshme të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), ku biseda u përqendrua në bashkëpunimin e ndërsjellët dhe rritjen e kapaciteteve të Administratës publike, si dhe mundësinë bashkëveprimi të mëtejshëm në praktikë të ndreqjes së situatave diskriminuese në shërbimet e administratës.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim Nënkryetarin e Komitetit të Pakicave në Republikën e Shqipërisë, si përfaqësues i pakicës rome.

Biseda u përqendrua në bashkëpunimin e ndërsjelltë për të adresuar sfida të pakicave Kombëtare në vendin tonë.

Maj

- Në kuadër të “1 Majit”, “Ditës ndërkombëtare të punëtorëve”, Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome organizoi një aktivitet, me temë “Respektimi i të drejtave të punëtorëve. Shëndeti dhe siguria në vendin e punës” - në Elbasan. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi gjatë fjalës së tij vlerësoi nevojën e nxitjes së një dialogu të shëndetshëm për promovimin dhe garantimin e të drejtave të punëtorëve, shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës.
- Në Ditën Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë u zhvillua një takim rajonal online, me temë: “LGBTI duhen trajtuar si individ. Diversiteti është vlerë sociale”, me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit Republika e Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësive të huaja diplomatike në Shqipëri zyrave rajonale të KMD dhe media.
- Në ditën Kombëtare të Jetimëve, Komisioneri Z. Robert Gajda mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Shoqata e Jetimëve të Shqipërisë, në kishën e Shën Johan Vladimirit, Elbasan.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në aktivitetin “Shqipëri e Barabartë – një fushatë për ta bërë diskriminim dhe gjuhën e urrejtjes të papranueshëm”, i mbështetur nga programi i Komisionit për Demokraci i Ambasadës Amerikane, dhe i zbatuar nga Open Mind Spectrum Albania (OMSA), në bashkëpunim me organizatën Beyond Barriers.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) me mbështetjen e Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA-s) dhe në bashkëpunimin me Qendrën e Bashkëpunimit Ndërfetar zhvilluan takimin me fokus informimin e gazetareve të medias së shkruar dhe vizive mbi rolin e institucioneve të pavarura si mbrojtës të të drejtave të njeriut; si dhe diskutim me gazetarët mbi mënyrën e raportimit të informacionit dhe problematikat që mund të krijohen në përcimin e tij, duke shmangur komunikimin që mund të krijojë shqetësim në komunitetet fetare në formën e stereotimizimit, denigrimit apo stigmatizimit.

Qershor

- Në ditën Botërore të Fëmijëve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda mori pjesë në një takim konsultativ me të rinj dhe palët e interesuara mbi Draft-Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi prezantoi raportin e veprimtarisë vjetore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2020, në Kuvend.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me UNDP Albania dhe organizatat e shoqërisë civile, po marrin pjesë në prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të studimit: “Mbrojtja e përmirësuar ndaj diskriminimit të konsumatorëve

në nevojë përmes zbatimit të kuadrit ligjor dhe rregullator". Aktiviteti zhvillohet si pjesë e projektit "Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri", i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) dhe mundësohet me fonde nga Ambasada Norvegjeze.

- Komisioneri Gajda priti në një takim Avokatin e Popullit të Kosovës dhe delegacionin institucional. Komisioneri Gajda uroi Z. Qelaj për fillimin e detyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës dhe e informoi për veprimtarinë e institucionit të KMD për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe mekanizmat për të luftuar diskriminimin. Në pjesën e dytë të takimit u zhvilluan biseda teknike për çështje të ndryshme, për pasurimin e përvojës në Mbrojtjen e grupeve vulnerabël dhe trajtimin e minoriteteve. Departamenti Antidiskrimin i AP Kosovë do të qëndrojë 3 ditë në institucionin e KMD për shkëmbim eksperiencë dhe njohuri ligjore e institucionale të ndërsjellë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) me mbështetjen e Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës zhvilloi një tryezë diskutimi lidhur me legjislacionin anti-diskriminim në Shqipëri. Qëllimi i kësaj tryeze ishte rritje e njohurive rreth garancive të reja të parashikuara nga ligji dhe të avancojë ligjërimitin anti-diskriminim midis profesionistëve të ligjit dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.
- Në ditën Ndërkombëtare kundër abuzimit me drogën, Komisioneri Z. Robert Gajda vizitoi qendrën e rehabilitimit STREHA të organizatës Teen Challenge Albania. Komisioneri vlerëson qendrën për punën e deritanishme për rehabilitimin e personave me varësi të lëndëve narkotike.

Korrik

- Në moton *"Nëse të gjithë jemi njerëz të gjithë jemi të barabartë"* - KMD dhe Caritas së bashku me Medpak, CSA - Klubi i prindërve të fëmijëve me çrregullime të spektrit autik, Romauniversitas AMARODROM ndihmoni jetën "Së bashku" - qendra shqiptare për integrimin e personave me nevoja të veçanta organizuan aktivitet të personave me aftësi të kufizuara përmes punimeve arizante sportit dhe artit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me Qendrën Ndërfetare Elbasan dhe AMA, në kuadër të projektit *"Sfido Urrejtjen"* zhvilluan një takim informues me gazetarë të qarkut Elbasan. Gjuha e urrejtjes është një nga format më shqetësuese të përdorimit të shprehjes në mënyrë publike. Implikimet e saj kanë rrjedhoja afatgjata dhe një ndikim tepër negativ në shoqëri, pasi krijon, nxit dhe promovon denigrimin, stereotipizimin dhe stigmatizimin e grupeve të ndryshme shoqërore, sidomos atyre më vulnerabël.

Shtator

- Komisioneri Z. Robert Gajda mori pjesë në takim mbi Lirinë e Besimit, të organizuar nga Kolegji Universitar Bedër, dhe moderuar nga Dr. Skënder Bruçaj. Gjatë fjalës së tij, Komisioneri vuri fokusin në parandalimin e diskriminimit të së drejtës së besimit dhe praktikave fetare. Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka

kuruar marrëdhëniet me Institucionet fetare në vend dhe kurdoherë ka reaguar disa herë me deklarata publike për ngjarje që çenojnë lirinë e Besimit dhe çenojnë harmoninë fetare më vend.

- Në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më datë 21.09.2021 u zhvillua trajnimi i rradhës për punonjësit e zyrave rajonale të dy institucioneve. Trajnimi lidhej me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe rolin e pushtetit lokal në zbatimin e tyre. Qëllimi i këtyre trajnimeve është rritja e kapaciteteve të punonjësve të zyrave rajonale të Avokatit të Popullit dhe KMD-së për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen ndaj subjekteve.

Tetor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë si folës në trajtimin e Shkollës së Magjistraturës, në bashkëpunim me Komitetin Hollandez të Helsinkit, mbi *"Të drejtat e komunitetit LGBTI"*. Gjatë këtij trajnimi u trajtuan tema të ndryshme si: Standardet kombëtare, Evropiane dhe ndërkombëtare, krimet e urrejtjes; Legjislacioni shqiptar: vështrim i përgjithshëm dhe vështirësitë; Roli i policisë, prokurorisë, gjyqësorit dhe avokatëve. Roli i viktimës dhe të paditurit, duke përfshirë pjesëmarrjen e OJQ, kompensimi dhe rikuperimi; Raste praktike dhe si shkojnë ato në gjykatë, etj.
- Në kuadër të nismës *"Sfido Urrejtjen"*, u zhvillua në qytetin e Korçës aktiviteti për ndërgjegjësimin e gazetarëve, me temë: *"Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit"* - organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qendra e Bashkëpunimit Ndërfetar Elbasan dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive.
- Komisioneri Z. Robert Gajda mori pjesë në ceremoninë e 10 vjetorit të Gazetës maqedonase *"Ilinden"*, në vendin tonë, me kryeredaktor Z. Nikolla Gjurgjaj, njëkohësisht Kryetar i Shoqatës Maqedonase *"Ilinden"*-Tiranë.
- Projekti *"Sfido Urrejtjen"*, *"Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit"*. Komisioneri organizoi takimin në Tiranë me gazetarët dhe punonjësit e medias.
- Komisioneri Z. Robert Gajda ishte i ftuar në shkollën *"Qamil Guranjaku"*, në Elbasan, si anëtar i Këshillit të Prindërve të kësaj Shkolle, për të biseduar mbi diversitetin dhe pranimin e saj në shoqëri. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të Qeverisë së Nxënësve, prindër, shërbimi psiko-social i Shkollës dhe mësues. Këshilli i Prindërve është një organizëm shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bashkëpunimin prindër-mësues, llogaridhënien e drejtorive për rritjen qytetare dhe përfshirjen komunitare të nxënësve. Përfshirja aktive e prindërve dhe bashkëpunimi Shkollës me familjet e nxënësve ndihmon në informim, kuptim dhe realizim të politikave arsimore dhe shoqërore, në funksion të të mirës tonë të përbashkët: fëmijët dhe të rinjtë.

Nëntor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qendra e Bashkëpunimit Fetar dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive zhvilluan në kryeqytet një konferencë mbi menaxhimin e rasteve kur përdoret gjuha e urrejtjes me sfond fetar, në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit. Z. Elvin Luku, pedagog i gazetarisë në Universitetin e Tiranës, përshkroi diskriminimin në mediat vizive dhe online të shtetasve afganë gjatë ditëve të para të strehimit në Shqipëri. Ai theksoi se mungesa e informacionit dhe e transparencës prodhoi gjuhë urrejtje dhe diskriminuese.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në studimin *"Përtej përkufizimeve"*. Ky studim u zhvillua me mbështetjen e projektit të përbashkët të European Union in Albania dhe Council of Europe Office në Tirana. Një thirrje për veprim kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri, që i'u prezantua aktorëve kryesorë në vend së bashku me Aplikacionin e ri celular KMD_App projektuar për raportimin e gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes në vendin tonë.
- Në kuadër të projektit të BE dhe KiE *"Promovimi i Diversitetit dhe Barazisë në Shqipëri"*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë së bashku me kolegë të tjerë më një takim në Drejtorinë e Policisë qarku Tiranë. Temë e bashkëbisedimit ishte trajtimi i krimeve të urrejtjes dhe ndjeshmerinë e organeve policore në trajtimin e rasteve me grupet me të pamundura dhe vulnerabël të shoqërisë tonë.
- Komisioneri Z. Robert Gajda mirëpriti një grup të rinjsh që u informuan për veprimtarinë e institucionit të KMD dhe rolin e saj në luftën ndaj diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Në këtë takim u bë prezantimi i gjetjeve të monitorimit të zgjedhjeve parlamentare të Prill 2021 nga Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA); dhe prezantimi i gjetjeve të monitorimit të zgjedhjeve parlamentare të Prill 2021 nga Forumit Rinor Kombëtar i të Verbërve në Shqipëri.

Dhjetor

- Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi nga Shqipëria, mori pjesë në takimin e katërt rajonal në mes Avokatëve të Popullit të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë, në Prishtinë. Në këto takime u diskutua gjendja e përgjithshme e të drejtave të njeriut në shtetet respektive dhe puna në promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.
- Në përfundim të takimit rajonal në Prishtinë, Komisioneri Z. Robert Gajda dhe kolegët avokatë të Popullit të Maqedonisë së Veriut, Kosovës dhe Shqipërisë vizituan ekspozitën e fëmijëve *"Na ishte një herë që kurrë mos qoftë"* e dedikuar fëmijëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë, që gjendet në bibliotekën *"Hivzi Sylejmani"*.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me Shërbimin Ligjor Falas "TLAS" po zbatojnë projektin me objektiv përmirësimin e nivelit të zbatimit të legjislacionit kundër diskriminimit nga profesionistët. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti dhe në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës zhvillohen dhe disa trajnime me gjyqtarë e prokurorë për të rritur njohuritë lidhur me standardet më të fundit Evropiane në fushën e antidiskriminimit. Ky projekt mbështetet nga Ambasada Hollandeze në Shqipëri.

- Përfaqësuesit e Zyrrave Rajonale të KMD në Shkodër, Fier dhe Korçë morën pjesë në konferencën kombëtare me temë: *"Nxitja e integritetit në nivel lokal në Shqipëri"* e realizuar në qytetin e Vlorës. Qëllimi i kësaj konferencë është diskutimi me përfaqësues të pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe medias mbi rëndësinë e integritetit në leadership për të rritur besimin e publikut si dhe lidhur me zbatimin e kontratave sociale. Në këtë konferencë u diskutuan një sërë problematikash ku ndër të tjera ishte dhe tema e buxhetimit me pjesëmarrje, në veçanti pjesëmarrja më e gjërë e grave dhe kategorive vulnerable në konsultimet publike që Pushteti Lokal realizon. Ky aktivitet u organizua nga Rrjeti *"Përballja e Ofertave Politike"* (POP), në bashkëpunim me Ambasadën e Suedisë në Tiranë, mbështetur nga Olof Palme International Center. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga 12 bashkitë ku rrjeti POP zhvillon aktivitetet e tij në kuadër të Kontratës Sociale.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në një tryezë për institucionet e pavarura të barazisë dhe të të drejtave të njeriut, të organizuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri. Tema e takimi ishte *"Roli i institucioneve të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Drejtësi"*, në të cilën Komisioneri z. Robert Gajda trajtoi çështjen e *"Padive me interes kolektiv dhe mundësinë e Komisionerit që të nisë çështje në Gjykatën Kushtetuese"*. Përfaqësues nga Ballkani Perëndimor diskutuan, në një takim me prani fizike dhe online, për rolin dhe ndërveprimin mes tyre lidhur me proceset gjyqësore. Ky takim u zhvillua në prag të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.
- Në Ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mori pjesë në prezantimin e projektit sensibilizues kundër diskriminimit, *"Lexo Përmes Meje"*. Të ftuar të tjerë në panel ishin dhe zëvendësministri i Drejtësisë, drejtuese e projektit të përbashkët të Këshillit të Europës, si edhe studentë pjesëmarrës nga Universitete të ndryshme të Tiranës, të cilët ishin *"lexuesit"* e *"librave njerëzorë"* në këtë projekt.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, z. Robert Gajda zhvilloi një takim me studentët e Universitetit Marin Barleti, në kuadër të ditës për të drejtat e njeriut.
- Në kuadër të nismës SFIDO URREJTJEN: *"Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit"* - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me studentët e Universitetin Beder, në Tiranë. Komisioneri mbajti një Ligjëratë të hapur mbi legjislacionin e përbashkët, ofrimin e ekspertizës mbi trajtimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në aktivitetin e zgjeruar kulturor të Shoqatës *"Komuniteti malazez në RSH"*, e cila në bashkëpunim me Drejtorinë për Diasporën e Malit të Zi, organizuan në Universitetin *"Aleksandër Xhuvani"*, Elbasan: Promovimi i librit *"Ksenija Cicvariq – jeta dhe këngët"*, si dhe prezantimin kostumeve folklorike nga Mali i Zi (malazeze, shiptare, serbe, boshnjake etj) - Shoqata akademike artistike-kulturore *"Mirko Sërzentiq"*, Podgoricë.
- Komisioneri Z. Robert Gajda mori pjesë në takimin vjetor me drejtuesit e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, të organizuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Kryetarja Znj. Lindita Nikolli. Në këtë mbledhje, përveç

drejtuesve të institucioneve, morën pjesë edhe Ministrja e Marrëdhënieve me Kuvendin, Kryetarja e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, Kryetari i Komisionit për Ekonominë dhe Financat, Kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, Kryetari i Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, si edhe Kryetari i Prezencës së OSBE-së. Ky takim u zhvillua në zbatim të Vendimeve të Kuvendit, të cilat rregullojnë funksionimin e Mekanizmit të Monitorimit të zbatimit prej qeverisë të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.

- Në kuadër të nismës "*Sfido Urrejtjen*", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Z. Robert Gajda zhvilloi një takim me studentët e departamentit të Komunikimit në Universitetin e UET mbi Menaxhimin e rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit. Duhet forcuar respekti për të drejtat e njeriut dhe tolerancën e ndryshimeve në media, për të tërhequr vëmendjen ndaj diskursit diskriminues dhe gjuhës së urrejtjes kundër personave dhe grupeve të synuara për disa karakteristika të identitetit të tyre, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në takimin "*Youth Peace Talks*", në Elbasan, organizuar nga WCDCA së bashku me rrjetin e të rinjve "*Agjentët e Paqes për Ndryshim*", si dhe përfaqësues të instancave vendore, aktorë të shoqërisë civile. Ky event ishte aktiviteti përfundimtar në kuadër të projektit "*Një Qasje e Integruar për Promovimin e Grave dhe të Rinjve Paqëndrues në Shqipëri*". Projekt i cili startoi në Shkurt të 2021 dhe rezultoi në Trajnimin e 240 të rinjve për Paqe dhe Siguri dhe synon amplifikimin e zërave të të rinjve dhe një angazhim proaktiv të tyre për paqe në nivele të ndryshme.
- Arti si mjet edukues dhe ndërgjegjëses jo vetëm për të rinjtë, por për të gjithë opinionin publik. Komisioneri Z. Robert Gajda mori pjesë në aktivitetin "*Untold Stories*", i cili ka në fokus ndërgjegjësimin dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave - të organizuar nga Qendra "*Tirana Art*", në Kavajë. "*Untold Stories*" solli para publikut histori të vërteta të grave dhe vajzave shqiptare të interpretuara nga aktorë profesionistë në sallën e Pallatit të Kulturës "*Kavaljon*", në Kavajë.

3.10 Veprimtaria monitoruese e KMD

3.10.1 Projekte

- **Mbështetje për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në zbatimin e mandatit të tij për të mbrojtur gratë dhe burrat në Shqipëri nga diskriminimi.**

Ky projekt u realizua në kuadër të projektit: "*Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri*" në partneritet me UNDP Albania dhe me financim të Ambasadës Norvegjeze.

Me një kohëzgjatë prej 12 muaj, duke filluar në Qershor 2020 dhe finalizim Qershor 2021, fokusi i këtij projekti ishte përmirësimi i situatës së Klientëve në Nevojë në fushën e energjisë

elektrike, e shkaktuar nga mungesa e kuadrit ligjor rregullator për kategoritë vulnerabël dhe shtresat në nevojë.

Ky projekt përbëhet nga tre komponentë:

- Përmirësimi i mbrojtjes të “Konsumatorëve në Nevojë” ndaj diskriminimit, përmes forcimit të zbatimit të kornizës përkatëse ligjore dhe rregullatore.
- Rritje e ndikimit të vendimeve të çështjeve të KMD-së për të sjellë praktikën më të mira gjyqësore në jurisprudencë në lidhje me mbrojtjen e grave dhe burrave shqiptarë nga format e ndryshme të diskriminimit.
- Roli i forcuar i KMD-së në kontaktin me subjektet e prekshëm nga diskriminimi përmes referimit efektiv për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike falas dhe ndjekjes adekuate të rasteve të diskriminimit.

Komponenti parë ku KMD është lider u implementua në bashkëpunim me pesë OSHC të financuara nga KMD: Qendra T'REJA, Levizja Rinore Egjiptiane dhe Rome, Qendra për Advokim Social, Qendra Aksion Komunitar dhe Qendra Konsumatorit Shqiptar, dhe ka si qëllim mbrojtjen e Konsumatorëve në Nevojë në lidhje me energjinë elektrike. Në dy komponentet e tjerë implementimi bëhet nga UNDP Albania, dhe KMD si partner është përfituese e drejtpërdrejt nga rezultatet e tyre. Komponenti i dytë solli një qasje të re, atë të pasqyrit në jurisprudencë të vendimeve më të mira të KMD-së duke u bërë praktikë për t'u ndjekur.

Ky projekt u finalizua në 18 Qershor 2021 me takimin përmbyllës, në rang institucionesh qendrore, ministri të linjës, OSHEE, ERE, OSCE, shoqëri civile dhe pale të interesuara, etj.

Finalizimi i projektit solli si produkt tejet të vlefshëm, një studim të gjendjes së Klientit në Nevojë në 8 bashki, i cili solli në vëmendje problematikat dhe zgjidhjet, duke i adresuar ato tek ministrinë dhe agjencitë përgjegjëse.

➤ Sfidë Urrejtjes

“Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit”, është projekt i financuar nga AMA duke realizuar disa aktivitete lançuese dhe informuese, monitorim i gjuhës së urrejtjes në median e shkruar, audiovizive dhe online.

Synimi i projektit është të informojë gazetarët e medias së shkruar dhe vizive mbi rolin e institucioneve të pavarura si mbrojtës të të drejtave të njeriut; si dhe diskutim me gazetarët mbi mënyrën e raportimit të informacionit dhe problematikat që mund të krijohen në përcimin e tij, duke shmangur komunikimin që mund të krijojë shqetësim në komunitetet fetare në formën e stereotimizimit, denigrimit apo stigmatizimit.

Informimi i gazetarëve në këtë drejtim, synon që ti bëjë ata partnerë të Institucioneve të Pavarura në mbrojtje për një mbrojtje më afektive të të drejtave të njeriut dhe më të vetëdijshëm mbi impaktin social të komunikimit të informacionit.

Finalizimi i projektit solli si produkt një studim me temë “Monitorimi i gjuhës së urrejtjes me sfond fetar”, i cili është akoma në proces draftimi dhe formatimi.

➤ Horizontal Facility II


Horizontal Facility II është një program i përbashkët i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës dhe implementuar nga Këshilli i Evropës. Rezultatet e arritura në fazën e parë të programit, Horizontal Facility II do të sigurojë asistencë teknike dhe ekspertizë për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia dhe Turqia.

Programi mbështet reformën e përshtatur proceset në fushat e sigurimit të drejtësisë; luftimi i krimit ekonomik; luftimin e diskriminimit dhe mbrojtjen e të drejtave të grupeve të cënueshme (përfshirë LGBTI, pakicat dhe romët) dhe liria e shprehjes dhe liria e medias. KMD është pjesë në implementimin e këtij projekti.

➤ Aplikacioni “KMD App”

Kmd përgjatë vitit 2021 punoi për lançimin e aplikacionit “KMD App” të disponueshëm në Android në Google play dhe Iphone në App Store, i cili do të shërbejë si një mjet praktik dhe informues për publikun mbi antidiskriminimin, si dhe për të raportuar raste të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes në Shqipëri.

Aplikacioni KMD është zhvilluar gjithashtu në kuadër të projektit të përbashkët të BE-së dhe Këshillit të Evropës “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri”, zbatuar në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019- 2022”.



➤ Aleanca Kundër Gjuhës së Urrejtjes (AKGJU)

KMD së bashku me Avokaten e Popullit, Autoritetin e Mediave Audiovizive dhe Këshillit Shqiptar të Mediave kanë krijuar AKGJU për të luftuar fenomenin e “gjuhës së urrejtjes” në të gjitha dimensionet që ai shfaqet në shoqërinë Shqiptare. Në kuadër të këtij bashkëpunimi u hartua “Kodi i sjelljes së partive politike shqiptare gjatë fushatave zgjedhore”⁶⁵.

Ky Kod përcakton rregulla të qarta të sjelljes për Partitë Politike, subjektet konkurruese dhe mbështetësit e tyre, në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në procesin zgjedhor e cila duhet të garantojë zbatimin e standardeve më të larta demokratike. Kodi i Sjelljes u vlerësua dhe u mirëprit kryesisht nga përfaqësuesit e subjekteve kryesore zgjedhore, si një mjet i rëndësishëm për drejtimin e sjelljes etike në periudhën e zgjedhjeve dhe më gjerë, duke u pajtuar edhe me dispozitat e tij. Zbatimi i tij do të monitorohet nga anëtarët e Aleancës kundër Gjuhës së Urrejtjes dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në veçanti në lidhje me gjuhën e urrejtjes të përdorur në mediat tradicionale dhe sociale nga subjektet zgjedhore gjatë fushatës.

⁶⁵ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/04/Kodi-i-Sjelljes-AKGJU.pdf>

3.10.2 Publikime të KMD

➤ **“PARIMI I BARAZISË DHE MOSDISKRIMINIMIT - ANALIZË E PRAKTIKËS GJYQËSORE 2013 - 2020”**

Kjo analizë u krye nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) Shqipëri si pjesë e Projektit *“Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”* me kontributin financiar të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Qëllim kryesor i analizës është që të shërbejë si një instrument i parë për operatorët e së drejtës duke patur këtu parasysh Shkollën e Magjistraturës, gjyqtarët, avokatët, prokurorët si edhe departamente të interesuara të administratës publike. Gjithashtu, kjo analizë i adresohet edhe Universiteteve, lektorëve të së drejtës, kërkuesve shkencor dhe studentëve për nxitjen e një debati juridik dhe formësimin e një doktrine mbi parimin e barazisë dhe cenimin thelbësor që diskriminimi u shkakton të drejtave individuale dhe sociale.

Botimi i këtij studimi gjeti një mbështetje të vlerësueshme nga të gjithë aktorët të cilëve ju drejtohet, duke pranuar rekomandimet e dala si të domosdoshme dhe koherente, madje duke marrë përsipër angazhimin në realizimin e disa prej tyre sipas fushave të përgjegjësisë.⁶⁶

Rekomandime të këtij studimi:

- Të merren masa legislative për të siguruar harmonizimin e plotë të kuadrit ligjor lidhje me zhvendosjen e barrës së provës;
- Të rritet roli i gjykatave si garante të barazisë thelbësore dhe mbrojtëse të drejtësisë sociale;
- Të shtohen roli aktiv i gjykatave në drejtim të edukimit ligjor të komunitetit, të përdoruesve të gjykatave apo edhe të aktorëve të tjerë;
- Të sigurohet njëtrajtshmëria e praktikës gjyqësore si i vetmi mekanizëm për përmbushjen e parimit kushtetues të sigurisë juridike si dhe për parandalimin e praktikave diskriminuese në të ardhmen;
- Të përfshihen në kalendarin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës (SHM) tema që trajtojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Të mundësohet shtimi i fondit të literaturës së SHM me studime dhe botime apo përkthime në gjuhën shqipe të jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe GJED në lidhje me parimin e barazisë;
- Të organizohen trajnime tematike mbi barazinë dhe mosdiskriminimin me studentët e nivelit të studimeve master në Fakultetet e Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Avokatisë;
- Të organizohen takime ndërgjegjësuere dhe tryeza të rrumbullakta me pjesëmarrjen e KMD-së dhe organizatave të shoqërisë civile, me qëllim krijimin e një partneriteti më

⁶⁶<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/01/Analize-e-Praktikes-Gjyqsore-per-Barazine-dhe-Mosdiskriminimin-2013-2020..pdf>

të fortë në funksion të forcimit të kapaciteteve të tyre për mbrojtjen me efektivitet të iniciativave në mbrojtje të diskriminimit;

- Të organizohen takime rajonale midis KMD-së dhe Dhomave të Avokatisë pranë atyre juridiksioneve gjyqësore ku praktikat diskriminuese janë më të shpeshta, me qëllim diskutimin e elementeve të veçanta që duhet të përfshijë mbrojtja e ankuesve dhe njohja me standardet ndërkombëtare;
- Të rritet bashkëpunimi i KMD-së me Sindikatat e Punëmarrësve në fusha të ndryshme për aftësimin e tyre në advokimin e veprimeve pozitive që duhet të merren nga punëdhënësit ashtu dhe shërbimofruesit, si e vetmja mënyrë për të ndaluar diskriminimin e tërthortë dhe sigurimin e përshtatjes së arsyeshme;
- Të mbledhen periodikisht të dhëna statistikore nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe KMD-ja me qëllim analizimin për të identifikuar njëtrajtshmërinë e tendencave interpretuese dhe të diskriminimit, formave dhe shkaqeve, si dhe marrjen e masave për ndalimin e tyre;
- Të ofrohet mbështetje teknike e vazhdueshme nga organizatat ndërkombëtare, me qëllim forcimin e kapaciteteve të institucionit të KMD-së në sigurimin e barazisë thelbësore.

➤ **“PËRTEJ PËRKUFIZIMEVE. THIRRJE KUNDËR GJUHËS SË URREJTJES NË SHQIPËRI”**

Rëndësia e këtyre llojeve të studimeve dhe mjeteve monitoruese qëndron në faktin se lufta kundër gjuhës së urrejtjes nuk duhet të jetë vetëm ligjore, por edhe sociale dhe kulturore. Studimi, i përgatitur me mbështetjen e projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës *“Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Shqipëri”*.

Qëllimi i këtij studimi është t’u paraqesë palëve përkatëse të interesit një qasje përditësuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj gjuhës së urrejtjes, si dhe disa të dhëna përfaqësuese e të besueshme për perceptimin e gjuhës së urrejtjes në Shqipëri. Po ashtu, studimi u jep palëve kryesore të interesit disa rekomandime mbi mënyrën se si ta trajtojnë problemin e gjuhës së urrejtjes.⁶⁷

Rekomandime të këtij studimi:

- Ngritja dhe vendosja e prioritetit tek njësitë e veçanta dhe të specializuara për të parandaluar, gjurmuar dhe ndëshkuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes online që arrijnë kufirin e veprave penale do të shërbente për të organizuar një luftë më të shpejtë dhe efikase kundër gjuhës së urrejtjes online. Kjo e fundit, duke qenë aktualisht forma më e zakonshme e përhapjes së gjuhës së urrejtjes dhe për shkak të zhvillimit të teknologjisë më e vështira për t’u gjurmuar dhe ndëshkuar, kërkon mjete të veçanta dhe trajnime të posaçme për t’u adresuar, të përshtatshme për ndryshimet e vazhdueshme të teknologjisë online.

⁶⁷ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/11/Manual-shqip.pdf>

- Miratimi i një programi të veçantë nga ana e organeve publike (si p.sh.: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) që ka në fokus dhënien e ndihmës dhe ndërgjegjësimin mbi të drejtat e tyre të viktimave të gjuhës së urrejtjes. Diçka e tillë është shumë e nevojshme në shoqërinë shqiptare, duke qenë se në praktikën gjyqësore shqiptare ende mungojnë proceset civile për shpërblimin e dëmit (pasuror dhe/ose jopasuror) të shkaktuar nga përdorimi i gjuhës së urrejtjes. Kjo është dëshmi ndër të tjera e një ndërgjegjësimi të kufizuar të viktimave lidhur me mundësitë e tyre ligjore për të kërkuar drejtësi. Për këtë arsye, ofrimi i programeve të rehabilitimit dhe ndërgjegjësimi të viktimave të gjuhës së urrejtjes do të shërbente jo vetëm në përmirësimin e gjendjes dhe statusit të viktimave, por edhe në intimidimin e përdoruesve të gjuhës së urrejtjes në të ardhmen.
- Rritja e bashkëpunimit ndërmjet organeve publike shqiptare të cilat adresojnë problemin e gjuhës së urrejtjes (duke nisur nga gjykatat dhe duke vazhduar me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit etj.) dhe organeve apo organizatave ndërkombëtare të ngritura me po të njëjtin objekt. Për shkak të një eksperience më të madhe dhe shumëdimensionale në luftën kundër përdorimit të gjuhës së urrejtjes, bashkëpunimi dhe shkëmbimi i eksperiencave në luftën kundër gjuhës së urrejtjes do të jetë esencial në përditësimin e informacionit, trajnimin e stafit të këtyre organeve dhe përafrimit të qasjes ndërkombëtare lidhur me gjuhën e urrejtjes.
- Institucionet e pavarura për barazi, si Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi, Autoriteti i Mediave Audio-vizuale (AMA) dhe Avokati i Popullit duhet të zhvillojnë mekanizma për mbledhjen e të dhënave për të nxitur hulumtime empirike dhe të tjera për diskriminimin mbi baza të ndryshme, përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Çdo politikë gjithëpërfshirëse për të trajtuar pabarazinë, diskriminimin dhe forma të tjera të paragjykitimit kundër njerëzve LGBTI duhet të mbështeten mbi prova. Informacioni i mbledhur nga institucione për barazinë është me rëndësi për të identifikuar prioritetet e politikave, për të identifikuar aktorët kyçë si dhe pengesat, si dhe për të monitoruar dhe vlerësuar efektivitetin e politikave. Organizatat e shoqërisë civile duhet të inkurajohen që të luajnë rol aktiv në lidhje me incidentet e monitorimit të intolerancës dhe paragjykitimeve dhe t'u ofrojnë të dhëna organeve për barazi.
- Fushata për edukimin dhe informimin publik. Fushatat për edukim dhe informim publik janë thelbësore për të luftuar stereotipet negative të dhe diskriminimin ndaj personave LGBTI, romë dhe egjiptianë si dhe për të nxitur mjedise të sigurt për ta në shoqëri. Të pajisur me informacion, njerëzit mund të identifikojnë dhe me plot besim të kundërshtojnë manifestimin e intolerancës në ndërveprimet e tyre të përditshme. Në veçanti, fushatat për edukim dhe informim publik duhet të integrohen në edukimin parësor, dytësor dhe tretësor, por edhe të plotësohen me politika konkrete kundër bullizmit, përfshirë ofrimin e shërbimeve për viktimat e bullizmit, ndër to edhe nisma të udhëhequra nga kolegët apo bashkëmoshatarët. Organizatat e shoqërisë civile mund dhe duhet të inkurajohen që të luajnë rol qendror në udhëheqjen apo bashkëpunimin me Shtetet lidhur me fushatat për informim publik.
- Trajnim për barazi: Qeveria shqiptare duhet të ofrojë trajnime për zyrtarët publike dhe figura të tjerapublike për të drejtat e personave LGBTI, romë dhe egjiptianë sa i përket

barazisë dhe mosdiskriminimit, sidomos aty ku diskriminimi është institucionalizuar dhe ka histori të moskundërshtimit. Fushat me prioritet në këtë drejtim duhet të përfshijnë shkollat dhe mjedise të tjera të edukimit, profesionet mjekësore, forcat e armatosura, policinë, gjyqësorin, shërbimet juridike, shoqatat politike apo institucionet fetare.

- Politikanët shqiptarë dhe personat e tjerë me influencë në shoqëri duhet të udhëzohen për rëndësinë e shmangies së deklaratave që mund të nxisin diskriminim apo të minojnë barazinë dhe duhet të shfrytëzojnë pozitat e tyre për të promovuar mirëkuptimin, edhe duke kundërshtuar, aty ku është e duhur, deklaratat dhe sjellje diskriminuese. Kodet e etikës dhe politikat “jo diskriminim” të miratuara nga partitë politike duhet po ashtu të merren parasysh.
- Mobilizimi i aktorëve me ndikim dhe aleancave institucionale: Përmirësimi i të kuptuarit të publikut rreth çështjeve që kanë të bëjnë me racën, përkatësinë etnike dhe orientimin seksual apo identitetin gjinor dhe trajtimi i intolerancës dhe paragjyqimeve ndaj personave LGBTI, romë dhe egjiptianë kërkon nxitjen e dialogut dhe angazhimit ndërmjet qeverisë, shoqërisë civile dhe shoqërisë në përgjithësi. Aktorët kryesorë duhet të përpiqen të krijojnë aleanca për të bashkëpunuar në trajtimin e manifestimeve të intolerancës dhe paragjyqimit në shoqëri - në veçanti duke kërkuar mbështetjen e organizatave joqeveritare, organeve të barazisë, institucioneve fetare, policisë, politikëbërësve dhe organizatave ndërkombëtare për të bashkëpunuar në trajtimin e manifestimeve të intolerancës dhe paragjyqimeve në shoqëri.
- Sa i përket medias së transmetuar, çdo kornizë rregullatore duhet të promovojë të drejtën e njerëzve LGBTI, romë dhe egjiptianë për të hyrë dhe përdorur lirisht media dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit për prodhimin dhe qarkullimin e përmbajtjes së tyre dhe për marrjen e përmbajtjes së prodhuar nga të tjerët. Të gjitha format e masmedias duhet ta pranojnë se kanë përgjegjësi morale dhe shoqërore për të promovuar barazinë dhe mos-diskriminimin, përfshirë për shkak të racës, etnisë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual apo identitetit gjinor. Në lidhje me kushtetutat e tyre, subjektet e masmedias duhet të ndërmarrin hapa për të: Siguruar se fuqia e tyre punëtore ka diversitet dhe përfaqëson të tërë shoqërinë; Adresuar sa më shumë që është e mundur çështje që kanë të bëjnë me të gjithë grupet në shoqëri, përfshirë LGBTI, romët, egjiptianët dhe personat me aftësi të kufizuara; Kërkuar burime dhe zëra të shumëllojshëm brenda komuniteteve LGBTI, romë dhe egjiptianë në vend se t'i përfaqësojnë personat LGBTI, romë dhe egjiptianë si bllok i tërë; Respektuar standardet më të larta të dhënies së informacionit, që plotëson standardet e njohura profesionale dhe etike; Kodet profesionale të mirësjelljes për media dhe gazetarët duhet të pasqyrojnë parimet e barazisë dhe duhen ndërmarrë hapa efektive për të shpallur dhe zbatuar kode të tilla.
- Lidhur me luftimin e diskriminimit, subjektet e medias duhet të marrin parasysh: Të kujdesen që të raportojnë në mënyrë kontekstuale dhe faktike, duke siguruar se aktet e diskriminimit sillen para vëmendjes së publikut; Të jetë syçelë ndaj rreziqeve nga diskriminimi dhe stereotipet negative të personave LGBTI, romë dhe egjiptianë që mund të përhapen nga media; Të shmangin referencat e panevojshme ndaj orientimit

seksual apo identitetit gjinor që mund të nxisin intolerancë; Të rrisin ndërgjegjësimin për dëmin që shkaktohet nga diskriminimi dhe stereotipizimi negativ i personave LGBTI, romë dhe egjiptianë; Të raportojnë për grupe apo komunitete të ndryshme dhe t'u japin anëtarëve të tyre mundësinë që të flasin dhe të dëgjohen në mënyrë që nxit të kuptuarit më të mirë të tyre, ndërkohë që pasqyrojnë perspektivat e këtyre grupeve apo komuniteteve.

➤ **“MBROJTJA E PËRMIRËSUAR NDAJ DISKRIMINIMIT E KONSUMATORËVE NË NEVOJË PËRMES ZBATIMIT TË KUADRIT LIGJOR DHE RREGULLATOR”**

Kjo analizë monitorimi u krye si pjesë e projektit *“Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri”*, i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mundësohet me fonde nga Ambasada Norvegjeze, e cila ka për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në lidhje me energjinë elektrike duke sjellë në vemendje problematikat dhe zgjidhjet, si dhe duke i adresuar ato tek ministritë përgjegjëse.⁶⁸

Rekomandime bazuar në gjetjet e studimit, si masa paraprake janë:

- Paraprakisht, nisja e një fushate informimi të qytetarëve të cilët janë përfitues të kompensimit të VKM-ve në fuqi, me qëllim përfitimin e kompensimeve aktuale.
- Paraprakisht, shkëputja e përfitimit të kompensimeve të parashikuara nga VKMtë në fuqi nga koncepti i Kryefamiljarit.
- Paraprakisht, mosdiferencimi i llojit të aftësisë së kufizuar për përfitimin e kompensimeve të parashikuara në VKM-të në fuqi. Kompensimi të bëhet i mundur për të gjitha ato familje që kanë në përbërjen e tyre persona me aftësi të kufizuar sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*.
- Përfshirja në përfitimin e kompensimeve të të gjitha familjeve të parashikuara në VKM- të, të cilat jetojnë në banesa me qira (pa kontratë noteriale) dhe që nuk rezultojnë abonentë të OSHEE.
- Paraprakisht, përfshirja e në përfitimin e kompensimit të të gjitha familjeve me të ardhura më të pakta se 35.000 Lekë në muaj dhe jo vetëm të punonjësve buxhetorë.
- Përfshirja në këto VKM me qëllim kompensimi edhe e të papunëve të regjistruar si punëkërkues papunë në zyrat e punësimit.

Në lidhje me zbatimin e Ligjit Nr. 43/2015 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, i ndryshuar, rekomandohet:

- Nxjerrja e aktit nënligjor që do të bëjë të mundur përcaktimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.
- Në funksion të nxjerrjes së këtij akti duhet mbajtur parasysh që statusi i klientit në nevojë të ketë disa aspekte thelbësore të barabartë për të gjithë përfituesit, por dhe të

⁶⁸ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/06/Raporti-klienteve-ne-nevoje.pdf>

vendosë disa kritere elastikë për t'ju përshtatur më mirë veçantive të kategorive të ndryshme të përfshira.

- Si aspekt thelbësor i statusit të klientit në nevojë rekomandohet të jetë mosndërpreja e energjisë elektrike për arsye ekonomike (në funksion të kësaj Rregullorja e ERE është një pikënisje e mirë).
- Statusi i klientit në nevojë të parashikojë lehtësira për vendosjen e aparateve të energjisë elektrike, sidomos për familjet që kanë të ardhura më të vogla se paga minimale në shkallë kombëtare.
- Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e mbështetjes totalisht nga shteti të pagesës deri në një nivel konsumi kWh për familjet me të ardhura më të pakta se paga minimale në shkallë kombëtare;
- Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e shlyerjes totalisht të debisë energjitike nga ana e shtetit, për familjet me të ardhura më të pakta se paga minimale në shkallë kombëtare.
- Statusi i klientit në nevojë të parashikojë mundësinë e çmimit më të ulët për kWh për familjet që e përfitojnë këtë status.
- Si kriter për përcaktimin e statusit të klientit në nevojë, në mënyrë gjithëpërfshirëse, duhet të shërbejë gjendja ekonomike dhe përcaktimi i një niveli të ardhurash maksimal për përfitimin e statusit.

Rekomandime përfundimtare:

- Nisja e një fushate informuese të qytetarëve mbi energjinë elektrike, garantimit të saj, kategorive të përfshira në statusin e klientit në nevojë, procedurat për përfitimin.
- Informimi i qytetarëve në lidhje me efikasitetin e përdorimit të energjisë elektrike si dhe mbi rrezikun e përdorimit të mjeteve alternative si zjarri nëpërmjet drurit, gazit dhe materialeve djegëse të ndryshme.
- Shikimi i mundësive për financime nga shteti për sigurimin e energjisë elektrike nëpërmjet energjisë së rinovueshme.
- Mbajtja e të dhënave të rregullta në formën e Regjistrit, nëpërmjet një sistemi të detajuar dhe me lehtësira në kërkim.
- Ushtrimi i kontrolleve për abuzimet dhe abuzuesit.
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme për komunikimin ndër-institucional si dhe shkëmbimin dhe dërgimin e informacionit midis tyre.

➤ “LIGJI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI - PËRMBLEDHJE PËR FËMIJË”

Përmbledhje për Fëmijë, është një përpjekje e përbashkët me UNICEF në Shqipëri, me mbështetjen e Ambasadës e Norvegjisë, për t'ju ardhur në ndihmë fëmijëve, prindërve, mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, si instrument i nevojshëm në adresimin e shkaqeve të diskriminimit dhe promovimit të barazisë.

Botimi do të jetë i aksesueshëm në shkollë dhe online për të hapur sa më shumë dritare orientimi drejt mbrojtjes së drejtave të fëmijëve.⁶⁹

3.10.3 KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë

Equinet është Rrjeti European i Organeve të Barazisë, i cili promovon barazinë në Europë duke mbështetur organet e barazisë për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar barazi për të gjithë. Nëpërmjet Equinet, anëtarët e saj, institucione kombëtare barazie, sikundër është dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndajnë dhe shkëmbejnë ekspertizën e tyre në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, në nivel evropian si dhe mësojnë nga sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat përballen, gjatë zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Objektiv kryesor i Rrjetit është mbledhja e informacionit dhe krijimi i njohurive të reja mbi barazinë dhe mosdiskriminimin që para së gjithash mund të ndihmojnë anëtarët të përmirësojnë më tej praktikën e tyre në nivel kombëtar. Kjo njohuri vjen nga vetë anëtarët dhe përvoja e zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Çdo vit, organizohet Mbledhja e Përgjithshme Vjetore (AGM) e Equinet për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të rëndësishme si dokumentet strategjik, raportet e aktiviteteve, aderimi i anëtarëve të rinj, rinovimi i anëtarëve të Bordit të saj Ekzekutiv etj.

Strukturat e Equinet, të cilave u është deleguar menaxhimi i përgjithshëm i aktiviteteve, janë Bordi Ekzekutiv dhe Sekretariati i Equinet. Bordi Ekzekutiv është organi menaxherial i rrjetit dhe konkretisht është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe udhëheqjen strategjike të Equinet. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga nëntë përfaqësues të anëtarëve të Equinet të zgjedhur për një mandat dy vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve dhe kryesohet nga një Kryetar. Ai punon për të mbështetur punën e anëtarëve të Equinet dhe pozicionimin e tyre në nivel evropian dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të planeve të punës. Ai gjithashtu synon zhvillimin e vizioneve strategjike për të garantuar fuqinë, rritjen dhe qëndrueshmërinë e Rrjetit. Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Sekretariatit të Equinet, i cili është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara ndërmjet anëtarëve, duke kontribuar në rëndësinë unike të përvojës së organeve kombëtare të barazisë.

Më 9 nëntor 2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Z. Robert Gajda zgjidhet anëtar i Bordit Ekzekutiv të Equinet me një mandat dy vjeçar.

Stafi i KMD është përfshirë në shtatë grupe pune të rrjetit EQUINET gjatë vitit 2021, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimime të praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Evropës, konkretisht në:

- Grupin e Punës për Legjislacionin e Barazisë
- Grupin e Punës për komunikimin, strategjitë dhe praktikat

⁶⁹ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/02/LMD-permbledhje-per-femijet.-KMD-UNICEF.pdf>

- Grupin e Punës për barazinë gjinore
- Grupin e Punës për hartimin e politikave
- Grupin e Punës për kërkimet dhe mbledhjen e të dhënave
- Projekti mbi standartet e Organeve të Barazisë
- Grupin e Punës për Lëvizjen e Lirë

Për EQUINET-in nga grupi i punës në KMD është pregatitur një përmbledhje mbi bazën ligjore për aksesin në drejtësi dhe ndihmën juridike falas për personat me probleme të shëndetit mendor, si dhe plotësimi i formularit të dërguar nga ata për modelin *“Good practices in equality mainstreaming by equality bodies with a focus on equality duties and equality impact assessments - Equinet”*.

Gjithashtu, KMD ka marrë pjesë në:

- Grupin e fokusit: *“Equinet Focus Group on governance and management”*, zhvilluar në Zoom.
- Pjesëmarrje në Seminarin me temë: *“Tackling Discrimination and Intolerance against Muslim”*, zhvilluar në Zoom.
- Pjesëmarrje në takimin e grupit të punës së Equinet: *“Equinet WG Research and Data Collection | WG Policy Formation meeting on institutional racism”*.
- Pjesëmarrje në *“Virtual seminar on the role of the EU Charter of Fundamental Rights in the Work of Equality Bodies and National Human Rights Institutions”*.

3.10.4 Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstytucionale.

KMD është anëtar i Grupit Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin 2019 - 2022. Në kuadër të kësaj Strategjie, është kryer një studim për të vlerësuar kapacitetet institucionale për qeverisjen efektive të Migracionit.

Pjesëmarrje nga Institucioni i KMD në trajnimin me temë *“Monitorimi dhe Vlerësimi i Politikave Publike”*, i organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me GIZ - Programi Global *“Migrimi dhe Diaspora”* financuar nga Qeveria Gjermane, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit dhe efikasitetit të institucioneve për raportimin e Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2019-2022.

Gjithashtu, KMD ka qenë pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët *“Forcimi i kuadrit për migracionin e punës në Shqipëri, Zhvillimi i Rekrutimit Etik të punonjësve migrantë”* të organizuar nga IOM në Shqipëri, workshop-in *“Përmirësimi i Koordinimit të Qeverisjes së Migracionit në Shqipëri”*, organizuar nga Ministria e Brendshme në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin, si dhe në kuadër të rishikimit të planit të veprimit të strategjisë është zhvilluar takimi me prezencën e të gjithë institucioneve përgjegjëse/pikave të kontaktit të SKM 2019-2020, që janë pjesë e procesit të rishikimit.

KMD është anëtar i Grupit Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të kapitullit *“Kriteri Politik”* dhe Kapitulli 23 *“Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”*, për të cilin institucion lider është Ministria e Drejtësisë. Stafi i KMD ka dhënë kontributit për Kapitullin 23 *“Gjyqësori dhe të*

drejtat themelore", në kuadër të Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, si dhe "Mbi monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian, KSA dhe JFS".

Njëkohësisht ka marrë pjesëmarrja në Konferencën virtuale me temë "Negociatat e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe përvoja rajonale - Kapitulli 23 në fokus", e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, zhvilluar në Zoom. Në kuadër të GNPIE, KMD ka qenë pjesëmarrës në takimin e radhës i GNPIE lidhur me Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore dhe Kriterin Politik", organizuar nga Ministria e Drejtësisë, si dhe në konferencën virtuale me temë: "Takimet dypalëshe në kuadër të procesit "screening" – përvoja dhe përgatitjet e grupit negociues për kapitullin 23", online nëpërmjet platformës ZOOM.

KMD, anëtari Grupit Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të Kapitullit 2 & 19, për të cilin institucion lider është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Stafi i KMD ka dhënë kontributit për hartimin e PKIE 2022 - 2024. Dhe ka dërguar informacioni mbi pozicionin negociues për Kapitullin e 19, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe ka plotësuar anketën e dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, "Për përdorimin e udhëzuesit në përgatitjen e procesit screening".

KMD është pjese e institucioneve për monitorimin e zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2021 - 2025. KMD ka përcjellë rekomandime lidhur me Projektvendimin "Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021 – 2025", i cili është miratuar, duke reflektuar këto rekomandime.

Në përmbushje të detyrimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, KMD pasqyron në raportet e institucionit, të dhëna dhe informacione të posaçme lidhur me çështjet e diskriminimit për persona me aftësi të kufizuara. Në lidhje me ankesat e trajtuara dhe vendimet e dhëna për mbrojtjen nga diskriminimi për Persona me Aftësi të Kufizuara, Komisioneri është shprehur me 13 vendime.

KMD ka dhënë kontributit me raportim mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga Komiteti i Palëve të Konventës së Stambollit, Raporti i GREVIOs, Grupit të ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka dhënë kontributit në lidhje me zbatimin e "Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të saj të Veprimit", për periudhën Janar – Qershor 2021, si dhe ka dhënë kontribut për pyetjet shtesë të dërguara nga shërbimet e KE, në lidhje me takimin e 13-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri.

Gjithashtu, Stafi i KMD ka përgatitur statistika lidhur me Raportin e FRA për vitin 2021, dhe specifikisht për Kapitullin "Për racizmin, ksenofobinë dhe krimet e urrejtjes", si dhe Kapitullin "Për aftësinë e kufizuar", si dhe ka plotësuar pyetësonin për Organet Kombëtare të Barazisë "Mapping the capacity building needs of Equality Bodies and National Human Rights Institutions in better addressing Roma and Sinti issues within their work", për OSCE Office for Democratic Institutions and Human Rights (OSCE/ODIHR), Contact Point for Roma and Sinti Issues (CPRSI).

3.10.5 Trajnime dhe Webinare

Gjatë vitit 2021, Stafi i KMD-së ka qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga vetë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo në bashkëpunim me institucione apo OJF të ndryshme. Gjithashtu të shumta kanë qenë edhe pjesëmarrjet në Webinare dhe trajnime të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike:

- Pjesëmarrja në prezantimin e Guidës *“A Human Rights Guide for Researching Racial and Religious Discrimination in Counterterrorism in Europe”*, e Amnesty International dhe Open Society Initiative for Europe.
- Pjesëmarrje në prezantimin e Analizës: *“Sfidat demografike dhe shëndetësore të Shqipërisë në Shekullin 21”*, zhvilluar në Zoom, nga UNFPA Albania.
- Pjesëmarrja në aktivitetin *“Hate Speech on Social networks”*, zhvilluar në Zoom.
- Pjesëmarrje në Programin, Sesion informimi, *“Aftësia e kufizuar dhe Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi”*, zhvilluar në Zoom nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.
- Pjesëmarrje në Konferencë online ALRECO *“Final Conference. Hate speech, racism and xenophobia: alert mechanisms and coordinated response”*.
- Pjesëmarrje në Webinarin: *“COVID 19 përgjigje për AK”*, zhvilluar nga ADRF.
- Pjesëmarrje në Webinarin e organizuar nga KMD, Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit Republika e Shqipërisë, me temë: *“TAKIM RAJONAL LGBTI”*, në Ditën Ndërkombëtare LGBTI.
- Pjesëmarrje në takimin Konsultativ Online të zhvilluar nga MSHMS ora 10.00-13.30, ku u bënë diskutime mbi Matrixën Antigypsism të PKVRE.
- Pjesëmarrje në takimin tek *“REJA”* në bashkëpunim me organizatën TLAS si dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit LGBTI.
- Pjesëmarrje në *“Forum in rajonal për çështjet e minoritetit”* të organizuar nga OKB-ja.
- Deleguar nga Komisioneri për përfaqësimin e KMD në Workshop rajonal me GIZ, mbi përgatitjen për projektin e ri *“Strengthening the Rule of Law in the Western Balkans”*, me ekspertet e GIZ, online.
- Pjesëmarrje në takimin e parë të Grupit Këshillimor lidhur me projektin e Këshillit të Europës me 10 Bashkitë dhe MSHMS.
- Pjesëmarrje në Konferencën e Europës Juglindore mbi Krimet e Urrejtjes e organizuar nga misioni i OSCE në Bosnje Herzegovinë dhe ODIHR.
- Pjesëmarrje në *“Seminarin ligjor mbi mosdiskriminimin dhe barazinë gjinore”*, organizuar nga Komisioni European.
- Pjesëmarrje në Regional Round Table *“The Role of Equality Bodies and Human Rights Institutions in the Judiciary”*.
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga OSCE, me temë *“Monitoring Hate Speech and Gender-based Discrimination in Albania”*, zhvilluar në Zoom.

3.11 Programi i transparencës

Në përputhje me programin e transparencës, KMD ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit www.kmd.al, vendimet për diskriminim dhe mosdiskriminim, nga ankesat individuale dhe nga hetimet kryesisht.

Në dispozicion të publikut në faqen zyrtare janë të gjitha rekomandimet e KMD-së dhe vendimet e Gjykatave.

KMD publikon në faqen zyrtare kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna për vend-ndodhjen e zyrave të KMD-së dhe Zyra Rajonale, orarin zyrtar,
- Funksionin dhe kompetencat e KMD,
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë ankesë për diskriminim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave,
- Kuadrin ligjor, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore,
- Raportet e KMD,
- Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese të organizuara nga Zyra e KMD-së,
- Takimet e Komisionerit,
- Marrëveshjet e bashkëpunimit,
- Strukturën organizative të KMD-së,
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të programit të transparencës.

Në vitin 2021 në Programin e Transparencës pranë regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve janë regjistruar 38 kërkesa.

Kthim përgjigjet me shkresë ose me postë elektronike (sipas kërkesës) janë realizuar të gjitha brenda afatit të parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit.

Kryesisht kërkesat për informacion janë në lidhje me ankesat dhe tërheqjen e një kopje të dosjes.

Media, shoqata, qendra studimi kanë kërkuar informacione në lidhje me ankesat sipas shkaqeve të diskriminimit në periudha të ndryshme. Informacion është kërkuar edhe për përmushjen e pika të Rezolutës së Kuvendit gjithashtu dhe për rekomandimet që i kemi drejtuar Kuvendit.

4. Zyrat Rajonale

4.1 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër

Aktivitetet të zhvilluara nga Zyra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shkodër:

Janar

- Më 5 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A. Sh., për plotësim dokumentacioni.
- Më 6 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e shoqatës “Intelektualët e Rijnë Shpresë” znj. F. Ll.
- Më 11 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me T. P., për të diskutuar rreth rastit të tij, i cili pretendonte se ishte i diskriminuar.
- Më 11 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një subjekt për ta informuar rreth procedurës që KMD ndjek për shqyrtimin e një ankese, subjekti gjithashtu na njohu dhe me rastin e tij për tu informuar nëse mund të bënte ankese pranë Zyrës Rajonale.
- Më 13 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me drejtuesit e organizatës IRSH lidhur me mundësinë e realizimit të një interviste televizive me përfaqësues të kësaj organizate dhe përfaqësues së Zyrës Rajonale për të informuar publikun rreth Ndhmës Juridike Parësore Falas që ofrohen nga kjo shoqatë dhe rreth bashkëpunimit me Zyrën Rajonale Shkodër.
- Më 13 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e shoqatës “Dimensioni Human” për të bashkëpunuar në realizimin e një aktiviteti që organizata Qendra për Nisma Ligjore Qytetare do të realizojë në qytetin e Shkodrës, lidhur me Ndhmën Parësore Juridike Falas.
- Më 14 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me familjarë të ankuesit P. P për sqarimin e një shkrese të ardhur nga KMD, ku vendos ankuesin në dijeni për kërkesën për informacion dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
- Më 18 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një subjekt për të diskutuar rreth rastit të tij. Ky subjekt u referua nga Zyra për Ndhmë Parsore Juridike Falas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër.
- Më 26 dhe 27 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me subjektin I.L., për të diskutuar rreth rastit të tij, rast i referuar nga Zyra për Ndhmë Juridike Falas.
- Më 26 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur në takim një ankues, për të diskutuar rreth rastit të tij.
- Më 20 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër, me temë “Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve”. Ky takim u organizua nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, në kuadrin e projektit “Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Shkodrës”, me

mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD, i cili po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

- Më 22 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Indikatorët gjinorë"*, e organizuar nga ASPA.
- Gjatë muajit Janar specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me përfaqësues të shoqatave që operojnë kryesisht në Qarkun Shkodër konkretisht me përfaqësuesen e Shoqatës *"Gruaja tek Gruaja"*, përfaqësuesen e Shoqatës *"Intelektualët e Rinjë, Shpresë"*, përfaqësuesen e Qendrës për Këshillime dhe Shërbime Psikologjike dhe drejtuesen e Shoqatës *"Dimensioni Human"*. Këto komunikime kanë pasur si qëllim organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete, si dhe diskutimin e rasteve të ndryshme të diskriminimit.
- Gjatë muajit Janar specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka kontaktuar përfaqësues të institucioneve lokale për çështje që kanë të bëjnë në realizimin e detyrave të përditshme të zyrës.
- Gjatë muajit Janar specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka kontaktuar dhe ka pritur telefonata nga ankuesit për dhënie informacioni lidhur me rastet e tyre.

Shkurt

- Më 8 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një subjekt për rastin e tij.
- Më 5 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Gjykata Europiane e Auditorëve"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 9 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me 3 ankues për plotësimin e formularit të ankesës.
- Më 10 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Vendim-marrja racionale në administratën publike"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 12 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur dhe asistuar 2 ankues për plotësimin e dokumentacionit.
- Më 22 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur dhe asistuar një ankues për plotësimin e formularit të ankesës.
- Më 22 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me familjar të ankuesit P.P., për sqarim të shkresës së KMD dhe për informimin lidhur me inspektimin që Prokuroria ka realizuar në shtëpinë e tyre si rezultat i ankesës së ngritur pranë KMD.
- Më 23 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesit I.G., B.V., dhe A.Sh., për dorëzim dhe plotësim dokumentacioni bashkëlidhur me ankesën.
- Më 23 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për informim të mëtejshëm për procedurën e shqyrtimit të ankesës pranë KMD.
- Më 24 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen L.Sh., për plotësim të dokumentacionit lidhur me ankesën e saj.

- Më 25 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin me temë : “Së bashku në zbatim të Ligjit Nr. 9669, datë 18.12.2006 *“Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*, i ndryshuar, e organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL). Ky aktivitet u organizua në kuadër të projektit *“Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Shkodrës”*, i cili po zbatohet me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).
- Gjatë muajit Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar me përfaqësues të shoqatave për realizimin e takimeve në funksion të bashkëpunimit që zyra ka me OJF-të.
- Gjatë muajit Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër gjithashtu ka mbajtur kontakte me ankuesit për sqarim dhe informim mbi procedurat.
- Përgatitje dhe dërgim informacioni për trajtimin e rastit të pretenduar si diskriminim nga psikologët shkollorë për çështje ex-officio.

Mars

- Më 1 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin P.P., për seancën dëgjimore që do realizohet me datën 18.03.2021.
- Më 1 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.K., për asistimin në përgatitjen e kundërshtimeve ndaj përgjigjes së kthyer nga Bashkia Shkodër.
- Më 2 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *“Teknikat e negocimit në administratën publike”*, e organizuar nga ASPA.
- Më 3 mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *“Komunikimi efektiv me median”*, e organizuar nga ASPA.
- Më 3 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B për konsultimin e shkresave të ardhura nga KMD në adresë të tij.
- Më 8 dhe 10 mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., lidhur me ankesën e tij.
- Më 8 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me monitoruesen e rasteve të dhunës në familje në Bashkinë e Shkodrës, për plotësimin e një pyetësoi në lidhje me rastet dhe funksionet e Zyrës Rajonale.
- Më 12 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Av. E.B., që merret me rastet e dhunës në familje si dhe është kordinatore në disa projekte të OJF-ve për bashkëpunim me Zyrën Rajonale Shkodër.
- Më 10 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në sesionin informues e organizuar nga FSHDPAK në kuadër të projektit 1-vjeçar që ka filluar të zbatohet me fokus Barazinë, Mosdiskriminimin dhe Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara përmes vetë-avokatisë, që shtrihet në katër bashki: Tiranë, Elbasan, Shkodër dhe Vlorë.

- Më 16 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B për sqarim të procedurës së shqyrtimit të ankesës.
- Më 16 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Sh për shpjegimin e shkresës së dërguar nga KMD për dijeni tek ankuesi.
- Më 17 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin për konfirmimin e pjesëmarrjes në seancën dëgjimore të përcaktuar.
- Më 18 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me organizatën *"Intelektualët e Rinjës, Shpresë"*, ka realizuar një takim me nxënës të shkollës *"Shejnaze Juka"* në qytetin e Shkodrës.
- Më 18 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e rrjetëzimit të ofruesve të shërbimeve në qytetin e Shkodrës, me temë: *"Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve"*. Ky takim u organizua nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetarë. Pjesëmarrës në këtë takim ishin përfaqësues të OJF-ve dhe institucioneve.
- Më 23 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me drejtuesin e organizatës *"Intelektualët e Rinjës, Shpresë"* për të diskutur mundësinë e realizimit të një takimi ndërgjegjësues në bashkëpunim me Zyrën Rajonale.
- Më 26 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin e realizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku pjesëmarrës ishin përfaqësues të zyrave rajonale të të dy institucioneve dhe përfaqësuesit e zyrave që frojnë ndihmë juridike falas.
- Më 29 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin me temë: *"Përmirësimi i reagimit dhe koordinimit institucional ndaj diskriminimit gjinor në punë, praktika e mirë në bashkinë Lezhë,"* e organizuar nga organizata *"Sot për të ardhmen"*. Në këtë takim ishin pjesëmarrës drejtues të institucioneve lokale në Bashkinë Lezhë dhe punojës social.
- Më 31 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin me temë: *"Ekstremizmi i dhunshëm"*, organizuar nga organizata *"People in focus"* në platformën Zoom.
- Gjatë muajit Mars specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka pritur telefonata nga ankuesit për dhënie informacioni si dhe ka asistuar ankuesit në përgatitjen e informacioneve shtesë dhe shkresave të ndryshme drejtuar KMD në kuadër të ankesave të tyre.
- Gjatë muajit Mars specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar me përfaqësues të OJF-ve për pjesëmarrje në aktivitete.

Prill

- Më 6 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin P.P., për informacion lidhur me procedurat e vijimit të ankesës pas regjistrimit të saj.
- Me 8 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një ankuese mësuese në shkollën *"Pashko Vasa"*.
- Më 8 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në forumin civil me temë: *"Dëgjo zërin tim"*, të organizuar nga shoqata *"Intelektualët e Rinjës, Shpresë"*, në gjimnazin *"Oso Kuka"* në qytetin e Shkodrës. Forumi civil kishte si temë diskutimi

të drejten e votës si dhe gjithpërfshirjen në procesin e votimit. Specialistja e Zyrës Rajonale foli rreth kushteve dhe kriterëve që duhen të plotësohen nga shteti për tu dhënë mundësinë të gjithë subjekteve për të votuar pa dallim, si dhe në ofrimin e kushteve të barabarta për të gjithë.

- Më 12 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në mbledhjen online të DPA për të diskutuar rreth objektivave të KMD.
- Më 13 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me R.D për të diskutuar rreth rastit të saj.
- Më 13 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *“Risiti e Kodit Zgjedhor në fushën e barazisë gjinore”*, e organizuar nga ASPA.
- Më 14 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka takuar përfaqësues të Shoqatës *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”* për të diskutuar rreth Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas që ka kjo shoqatë dhe rasteve që ka pasur.
- Më 15 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin B.V., për përgjigjen e kthyer nga ZVA Shkodër.
- Më 16 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin online me temë *“Për më shumë vëmendje në përmbushjen e përgjegjësiave institucionale për zbatimin e ligjit “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”*. Ky takim u organizua nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër dhe Bashkinë Shkodër. Ky aktivitet u organizua në kuadrin e projektit *“Të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të përgjigjes ndaj dhunës në familje”*, që realizohet nga QNL në bashkëpunim me Organizatën The Advocates for Human Rights mbështetur nga Ambasada e SHBA-së, Tiranë.
- Më 19 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin B.V., për sqarim shkresë të KMD.
- Më 19 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në mbledhjen e DPA, me praninë e Komisionerit, ku u diskutuan objektivat e Zyrave Rajonale për vitin 2021.
- Më 20 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Sh.
- Më 22 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një vizitë tek Zyra për Shërbime Ligjore Falas ku ka realizuar dhe takime me subjekte.
- Më 23 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesit e shoqatës *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”* për realizimin e një takimi me të rijtë në Qendren Rinore Atelie.
- Më 26 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga organizata *“Intelektualët e Rinjë Shpresë”* me nxënësit e shkollës austriake *“Peter Maringer”* në qytetin e Shkodrës. Ky takim u organizua në kuadër të projektit *“Dëgjo zërin tim”*. Përfaqësuesja e Zyrës Rajonale foli rreth rasteve të ndryshme të diskriminimit dhe funksionimin e Zyrës Rajonale.
- Më 28 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin online me temë: *“Aspekte të zbatimit të nenit 48 të Konventës së Këshillit të Europës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”*, i organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare. Ky aktivitet u zhvillua nga QNL në kuadrin e projektit:

"Mbështetje rrjetit të monitorimit kundër dhunës me bazë gjinore", i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.

- Gjatë muajit Prill, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar me ankuesit për informimin e tyre rreth procedurës së shqyrtimit të ankesës.
- Gjatë muajit Prill, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar dhe me përfaqësues të OJF me përfaqësues të institucioneve lokale për diskutimin e rasteve të ndyrshme, si dhe me gazetarë të medias lokale për realizimin e intervistave.

Maj

- Më 4 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesit A.Sh., B.V., I.G., për konfirmim të pjesëmarrjes në seancën dëgjimore të përcaktuar nga KMD.
- Më 4 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në aktivitetin përmbyllës të projektit *"Aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrje në procese vendim-marrje në nivel vendor i familjeve të pastreha"*, financuar nga *"Lëviz Albania"*, *"Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome"* dhe *"Qendra për Advokim Social"*. Ky projekt synoi përfshirjen e familjeve të pastreha në pasqyrimin e nevojës për strehim pranë pushtetit vendor dhe adresimin e kërkesës së tyre me qëllim miratimin e programit 5 vjeçar të Strehimit në Bashkinë Elbasan dhe Tiranë, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 22/2018 *"Për strehimin social"*. Në këtë aktivitet u prezantuan procesi i ndjekur, arritjet dhe sfidat e projektit, pritshmëritë dhe hapat e mëtejshëm në të ardhmen.
- Më 6 dhe 7 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me J.B., për të diskutuar rastin e tij.
- Më 7 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e shoqatës së Invalidëve Dega Shkodër për problemin e transportit publik ndërqytetas.
- Më 10 dhe 11 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për sqarim të procedurës së ankesës.
- Më 11 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim prezantimi me përfaqësuesin e ri të Zyrës Rajonale Shkodër të Avokatit të Popullit.
- Më 11 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Sh., për seancën dëgjimore të datës 12.05.2021 në kuader të ankesës së tij.
- Më 12 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online takimin e organizuar nga Open Mind Spectrum Albania (OMSA) në bashkëpunim me organizatën rajonale ERA - LGBTI Equal Rights Association për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Ky takim kishte pjesëmarrës përfaqësues të partive politike dhe shoqërisë civile në Shqipëri për të diskutuar mbi fenomenin e gjuhës së urrejtjes nga lideret politike, veçanërisht kundër grupeve të tilla si gratë dhe vajzat, personat e komunitetit LGBTI, komuniteti rom e egjiptjan etj.
- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin online të organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuader të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë (IDAHOT), me përfaqësues të institucioneve dhe të organizatave të shoqërisë civile.

- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një aktivitet informues/ndërgjegjëses me temë: *"Të drejtat e personave LGBTI në Shqipëri"*. Ky aktivitet u realizua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Bifobisë dhe Transfobisë (IDAHOT), në bashkëpunim me Qendrën Rinore ATELIE, OMSA Albania dhe *"Intelektualët e Rinjë, Shpresë"*. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i të rinjve në qytetin e Shkodrës për të drejtat e personave LGBTI në Shqipëri.
- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale gjithashtu takoi dhe u prezantua me psikologun e burgut të Reçit, e cila ishte pjesëmarrëse në aktivitetin e 17 majit.
- Më 18 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka asistuar ankuesin A.K., në përpilimin e shkresës për informacion drejtuar KMD-së.
- Më 18 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me J.B., për dërgim informacioni dhe asistim në formulimin e shkresës për heqje dorë nga çështja e tij.
- Më 19 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin S.L., për të dorëzuar dokumentacionin shtesë të kërkuar në kuadër të ankesës Nr. 88 datë 12.05.2021. Dokumentacioni iu dërgua me email inspektorit të çështjes.
- Më 24 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një subjekt për të diskutuar rreth problematikës së tij, por rasti nuk ishte një rast diskriminimi. Subjekti u asistua nga Zyra Rajonale në përgatitjen e një kërkesë drejtuar Bashkisë Shkodër.
- Më 25 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Sh., i cili kërkonte një kopje të rregjistrimit të seancës dëgjimore. Ankuesi u asistua në dërgimin e emailit me kërkesën e tij tek info@kmd.al.
- Më 25 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.K., lidhur me kërkesën që i ka bërë Bashkisë Shkodër për paisje me leje si shitës ambulant.
- Më 26 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në aktivitetin përmbyllës të projektit me temë: *"Prezantim të gjetjeve të studimit i lidhur me aksesin në energji elektrike të familjeve në nevojë"* në kuadër të projektit *"Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri"*, i cili po zbatohet në partneritet me KMD, Qendra *"T'Reja"*, financuar nga UNDP. Takimi u realizua me banorë lagjes *"Liria"* në qytetin e Shkodrës, të cilët i përkasin komunitetit Egjiptian. Studimi është i lidhur me aksesin në energjinë elektrike të familjeve në nevojë.
- Gjatë muajit Maj specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar dhe asistuar ankuesit në ndjekjen e hapave të procedurave të shqyrtimit të ankesës së tyre pranë KMD.
- Gjatë muajit Maj specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka komunikuar me përfaqësuese të OJF-ve për realizimin e bashkëpunimeve dhe aktiviteteve të ndryshme. Gjithashtu specialisti ka komunikuar edhe me përfaqësues të institucioneve lokale për realizimin e takimeve të ndryshme pune.

- Më 1 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka asistuar ankuesin A.H., për plotësimin e formularit të ankesës.
- Më 1 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me avokaten e Shoqatës “Dimensioni Human” për diskutimin e një rasti diskriminimi.
- Më 8 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka sqaruar ankuesin A.Sh., lidhur me vijimin e procedurës së ankesës së tij.
- Më 9 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur disa subjekte të interesuar për mënyrën se si duhet paraqitur dhe plotësuar formulari i ankesës pranë KMD.
- Më 10 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur një ankues, të cilit i janë shpjeguar afatet ligjore se kur duhet të përfundojë çështja e tij pranë KMD.
- Më 11 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ishte e ftuar në prezantimin e projektit Work4Youth, i cili po zbatohet përmes programit të bashkëpunimit ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020. Projekti po zbatohet në një rajon ndërkufitar që mbulon komunat malazeze - Tuzi, Bar dhe Podgorica, si dhe rajonin e Shkodrës në Shqipëri. Partneri kryesor në projekt është Partnerët Shqipëri. Situata në rajonin ndërkufitar është shumë e ngjashme kur bëhet fjalë për punësimin e të rinjve. Pasiguria e tregut të punës konsiderohet të jetë arsyeja kryesore për shkallën e lartë të migrimit në rajonin ku po zbatohet projekti dhe veçanërisht në zonat rurale ose ato më pak të zhvilluara.
- Më 11 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin që Ministria e Drejtësisë ka zhvilluar me ofruesit e shërbimeve në Shkodër. Ky aktivitet organizohet në kontekstin e Projektit *“Zgjerimi i ndihmës juridike për gratë dhe burrat në Shqipëri”*, i cili zbatohet nga UNDP në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).
- Më 14 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në ceremoninë e promovimit të zyrës së re të Klinikës së Ligjit pranë Universitetit të Shkodrës *“Luigj Gurakuqi”*. Në këtë aktivitet u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Universitetit *“Luigj Gurakuqi”* Shkodër dhe *“Lëviz Albania”*.
- Më 16 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit për organizimin e një ditë të hapur për informimin e qytetarëve.
- Më 17 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një ditë të hapur në bashkëpunim me Zyrën Rajonale Shkodër të Avokatit të Popullit. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve si dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet zyrave.
- Më 18 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Drejtuesin e Inspektoriatit të Punës në qytetin e Shkodrës. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i nismave që mund të ndërmerren në bashkëpunim me Zyrën Rajonale dhe Inspektoriatin e Punës në qytetin e Shkodrës.
- Më 22 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e rrjetëzimit të ofruesëve të shërbimeve në Shkodër, me temë *“Roli i gjyqtarit në procesin civil për parandalimin e dhunës në familje”*. Ky aktivitet organizohet nga Qendra për Nisma

Ligjore Qytetare (QNL), në kuadrin e projektit *“Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Shkodrës”*, i cili po zbatohet me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas, me financim të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

- Më 24 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *“Shërbimi i ndihmës juridike parësore: parimet dhe kategoritë përfituese”*, të organizuar nga ASPA.
- Më 25 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesit e Shoqatës së *“Invalidëve të Punës”* Shkodër, për të diskutuar rreth problematikave të cilat mund të adresohen nëpërmjet një ankese drejtuar KMD.
- Më 28 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesin e Zyrës për Shërbimet Ligjore Falas për ankesat me objekt diskriminimin që kanë trajtuar gjatë kësaj periudhe.
- Më 30 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online, ceremoninë e hapjes së Forumit të Barazisë, organizuar në Paris, në datat 30 qershor- 2 korrik. Një ngjarje globale për të çuar përpara mekanizmat dhe investimet për barazinë gjinore, ku u prezantua Plani Global për Përsheptimin e barazisë gjinore.
- Gjatë muajit Qershor specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar vazhdimisht me përfaqësues të organizatave për çështje që kanë të bëjnë me bashkëpunimin e ndërsjellë mes OJF-ve dhe Zyrës Rajonale.

Korrik

- Më 2 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë konferenca kombëtare *“Puna me dhunuesit- Sfidë kundër dhunës me bazë gjinore”*, e organizuar nga *“Gruaja tek gruaja”*, *“Linja e këshillimit për burra dhe djem”* në qytetin e Shkodrës, që bëri bashkë për herë të parë, përfaqësues të organizatave kombëtare e ndërkombëtare, drejtues të institucioneve vendore dhe qendrore, ekspertë që kanë mbështetur ngritjen dhe zhvillimin e shërbimeve për dhunuesit në Shqipëri dhe profesionistë të ardhshëm të fushës në një diskutim mbi sfidat e shërbimit të këshillimit për dhunuesit në Shqipëri. Punimet e konferencës, me anë të sesioneve të ndryshme paralele nxitën diskutime dhe ndanë mes të pranishmëve, praktika të mira kombëtare e ndërkombëtare duke renditur sfidat dhe rëndësinë e bashkërendimit të punës së organeve ligjzbatuese në referimin e dhunuesve pranë shërbimeve të rehabilitimit.
- Më 6 dhe 7 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin G.S., për asistim në plotësimin e formularit të ankesës dhe diskutimin e rastit të tij.
- Më 8 dhe 9 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin përmbyllës të Komitetit Rajonal për Rritjen e Qasjes së Grave në Punësim zhvilluar në Prishtinë nën organizimin e Institutit *“Demokraci për Zhvillim”* (D4D) dhe Qendra *“Aleanca Gjinore për Zhvillim”* (GADC). Komiteti Rajonal përbëhet nga

përfaqësues të institucioneve, organizatave të shoqërisë civile dhe odave ekonomike nga Kosova dhe Shqipëria. Qëllimi kryesor i tij është shkëmbimi i informacioneve dhe rekomandimeve lidhur me politikat e punësimit, inicimi dhe udhëheqja e strategjive dhe nismave avokuese në nivel rajonal, të cilat kontribuojnë në rritjen e punësimit të grave.

- Më 12 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin G.S., për ofrimin e ndihmës në përgatitjen e argumenteve dhe informacioneve shtesë në kuadër të ankesës Nr. 124 datë 07.07.2021.
- Më 13 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e Klinikës së Ligjit Shkodër për realizimin e kërkesës drejtuar Bashkisë Shkodër dhe Këshillit Bashkiak lidhur me vendosjen e platëformës Seatrack System.
- Më 21 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin A.Gj., për asistim në plotësimin e formularit të ankesës dhe diskutimin e rastit të tij.
- Më 26 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B.
- Më 26 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka referuar rastin e J.B., tek Zyra për Ndihme Juridike Falas.
- Më 28 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Sh., për procedurën e ankesës së tij.
- Më 28 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.K., për lejen, e cila nuk i vihet ende në dispozicion nga Bashkia Shkodër.
- Gjatë këtij muaji, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me ankues lidhur me procedurat e ankesave. Gjithashtu specialisti ka komunikuar me përfaqësues të organizatave të ndryshme lidhur me realizimin e aktiviteteve të ndryshme në qytetin e Shkodrës.
- Gjatë muajit Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe përfaqësuesin e Inspektoriatit të Punës në qytetin e Shkodrës për problematika të ndryshme si dhe për mundësinë e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me ta.

Gusht

- Më 23 Gusht, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin J.B., për asistim në plotësimin e formularit të ankesës dhe diskutimin e rastit të tij.
- Më 25 Gusht, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin J.B., për plotësim dokumentacioni lidhur me ankesën.
- Më 3 Gusht, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me ankuesin T.P., për plotësimin e formularit të ankesës.
- Gjatë muajit gusht, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me ankuesit për informacion si dhe me organizata të ndryshme për pjesëmarrjen në aktivitete të realizuara nga ato.

Shtator

- Më 2 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me ankuesin J.B., për informim lidhur me procedurën e ankesës.

- Më 9 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me ankuesin J.B., lidhur me ankesën e tij.
- Më 10 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me përfaqësuesen e Klinikës së Ligjit zj. G.D.
- Më 10 Shtator, specialist i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve gjinorë mbi statistikat gjinore dhe indikatorët e ndjeshëm gjinorë"*, organizuar nga ASPA.
- Më 13 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., lidhur me procedurën e ankesës së tij.
- Më 13 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen F.K., për plotësimin e formularit të ankesës.
- Më 16 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesit e Zyrës për Shërbime Ligjore Falas.
- Më 20 dhe 21 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me ankuesin J.B., për asistimin në përgatitjen e informacioneve shtesë lidhur me ankesën e tij.
- Më 20 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me ankuesin G.S., për mundësinë e rihapjes së çështjes së tij.
- Më 21 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin online të organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi me temë: *"Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm"*. Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve të zyrave rajonale të AP dhe KMD për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit.
- Më 27 dhe 28 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me ankuesin J.B., për informim dhe ndihmë në përgatitjen e një shkrese drejtuar Spitalit Rajonal Shkodër.
- Më 29 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve civilë mbi kuadrin ligjor dhe procedural për mbrojtjen nga diskriminimi"*, të organizuar nga ASPA.
- Gjatë këtij muaji, specialist i Zyrës Rajonale ka komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me ankuesit për sqarim dhe dhënie informacioni si dhe ka realizuar komunikime të tjera në kuadër të realizimit të detyrave.

Tetor

- Më 12 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për dërgimin e provave të tjera lidhur me ankesën.
- Më 12 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një ankues për diskutimin e rastit të tij.
- Më 12 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin N.A., i cili u informua mbi procedurën që ndjek KMD për shqyrtimin e ankesës dhe u pajis me formularin e ankesës.
- Më 12 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen S.S., për dorëzimin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur.

- Më 13 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesit e Zyrës për Shërbime ligjore falas lidhur me rastet e trajtuara nga zyra.
- Me 13 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me juristin e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për rastet e trajtuara dhe problematikat që kanë paraqitur subjektet.
- Më 14 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin me temë: *“Së bashku për rritjen e aksesit në drejtësi të qytetarëve”*, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore dhe Qytetare në qytetin e Shkodrës. Gjatë këtij takimi u prezantua ecuria e projektit *“Mbështetje për ofrimin e ndihmës juridike parësore, efektive dhe cilësore për individët dhe komunitetet e marginalizuara në rajonin e Shkodrës”* si dhe praktikat e mira të kësaj Qendre, në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitutional për trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve.
- Më 18 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për dërgimin e provave të tjera lidhur me ankesën.
- Më 19 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Korrupsioni dhe diskriminimi i grave dhe vajzave”*, organizuar nga ASPA.
- Më 22 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: *“Përmirësimi i standardeve të të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar në Shqipëri”*, organizuar nga Qendra Europiane. Qëllimi i këtij aktiviteti konsistonte në mbështetjen dhe rritjen e kapaciteteve të shoqërisë civile përmes sub-gratimeve dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë së institucioneve publike, në rehabilitimin e të ndaluarve përfshi dhe ata që janë duke kryer shërbimin e provës.
- Më 25 dhe 27 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për informim reth procedurës së ankesës së tij.
- Më 25 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen S.S., lidhur me diskutimin e paraqitjes së provave të tjera.
- Më 28 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., dhe e ka asistuar në përgatitjen e kundërshtimeve lidhur me përgjigjen që Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër i ka dërguar KMD-së.
- Gjatë këtij muaji, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me ankuesit për dhënie informacioni si dhe me përfaqësues të organizatave për pjesëmarrjen në aktivitetet e realizuara prej tyre.

Nëntor

- Më 3 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për sqarimin e shkresës së ardhur për dijeni nga KMD.
- Më 3 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim në Zyrën për Shërbime Ligjore Falas, me punojësen e kësaj zyre znj. G.P., për rastet që ka trajtuar zyra.
- Më 4 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me përfaqësuesen e shoqatës së Invalidëve Shkodër për problematiken e transportit

publik në qytetin e Shkodrës dhe hapat e ndërmarrë nga institucionet për zgjidhjen e saj.

- Më 8 Nëntor, specialist i Zyrës Rajonale Shkodër ka marrë pjesë në takimin promovues që Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) organizoi në Shkodër për promovimin e metodologjisë së monitorimit *“Monitorimi dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”*. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve lokale dhe OJF-ve.
- Më 8 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një takim me ankuesin A.Z., për trajtimin e rastit të vajzës së tij, e cila nuk pranohet në shkollë për shkak të aftësisë së kufizuar.
- Më 8 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me drejtoreshën e shkollës profesionale *“Kol Margjini”* Shkodër për rastin e nxënëses F.Z., për të diskutuar mbi arsyet e mospranimit në këtë shkollë.
- Më 9 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me A.Z., për plotësimin e formularit të ankesës për rastin e vajzës së tij me aftësi të kufizuar, për t’u trajtuar nga KMD.
- Më 10 Nëntor, specialist i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin me temë: *“Të përmirësojmë kushtet e punës dhe produktivitetin në fabrikat e tekstileve në Shqipëri”*, i organizuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim në qytetin e Shkodrës. Në këtë takim u diskutua rreth situatës së punësimit në industrinë fason (sa janë të punësuar në total, sa gra, sa u prek industria nga pandemia, si është gjëndja tani, kushtet e punës në industrinë fason etj).
- Më 11 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për një problematikë të re.
- Më 11 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin S. L i cili adresoi një tjetër rast pranë zyrës.
- Më 12 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen e adresuar nga S. L., për të diskutuar rreth rastit të saj.
- Më 15 dhe 17 nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen M.T., për të diskutuar rastin e saj dhe për të plotësuar formularin e ankesës.
- Më 15 dhe 16 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin D.H., për të diskutuar rreth rastit të tij dhe për të plotësuar formularin e ankesës.
- Më 17 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Z., për informim rreth procedurës së ankesës.
- Më 18 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Z., për ta asistur në përgatitje të informacionit shtesë në kuadër të ankesës së tij.
- Më 24 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me sekretaren e Rektorës së Universitetit të Shkodrës *“Luigj Gurakuqi”*, për mundësinë e realizimit të një aktiviteti me pjesëmarrjen e KMD në Universitetin e Shkodrës.

- Më 24 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e Zyrës për Shërbime Ligjore Falas për të diskutuar mbi zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- Më 24 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin që shoqata “Intelektualët e Rinjë, Shpresë” realizoi në shkollën “Oso Kuka” në qytetin e Shkodrës, në kuadër të projektit “Edukimi për korrupsionin”. Specialistja në këtë takim foli për ndikimin e korrupsionit në diskriminimin e subjekteve.
- Më 25 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen L.Gj., për diskutimin e rastit të saj dhe paisjen me formularin e ankesës.
- Më 25 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Projekti Shpresa”, në kuadër të Ditës Botërore për Eliminimin e Dhunës dhe në kuadër të muajit “Fjongoja Blu”, dedikuar luftës kundër dhunës ndaj fëmijëve, me temë: “Të punojmë së bashku për t'i bërë komunitetet tona më të sigurta: “Të gjithë kanë një rol për të luajtur”. Pjesë e takimit ishte edhe ekspozita e përbërë nga 10 kuadro me punime të riciklikuara të shoqëruara, shoqëruar me mesazhe kyçe, me qëllim rritjen e vetëdijes publike për parandalimin e fenomenit të dhunës.
- Më 25 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin sensibilizues me temë: “Dashni në kohën e tashme” e organizuar nga Shoqata “Gruaja tek Gruaja” në qytetin e Shkodrës në kuadër të hapjes së programit për 16 ditët e aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
- Gjatë muajit Nëntor specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur komunikime të vazhdueshme me ankues, përfaqësues të organizatave dhe institucioneve lokale.

Dhjetor

- Më 1 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për sqarimin e shkresës së ardhur për dijeni nga KMD.
- Më 2 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen L.D., për diskutimin e rastit të saj dhe pajisjen me formular aplikimi.
- Më 3 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin online me temë: “Të drejtat e fëmijëve” organizuar nga Avokati i Popullit në bashkëpunim me KMD.
- Më 6 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në konferencën kombëtare me temë: “Nxitja e integritetit në nivel lokal në Shqipëri”, realizuar në qytetin e Vlorës. Qëllimi i kësaj konferencë ishte diskutimi me përfaqësues të pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe medias mbi rëndësinë e integritetit në leadership për të rritur besimin e publikut si dhe lidhur me zbatimin e kontratave sociale. Në këtë konferencë u diskutuan një sërë problematikash ku ndër të tjera dhe tema e buxhetimit, në veçanti pjesëmarrje më e gjërë e grave dhe kategorive vulnerabël në konsultimet publike që Pushteti Lokal realizon. Ky aktivitet u organizua nga Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” (POP), në bashkëpunim me Ambasadën e Suedisë në Tiranë, mbështetur nga Olof Palme International Center.

- Më 8 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takim në ndërgjegjësim me temë: *“Edukimi kundër korrupsionit”*, që Shoqata *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”* realizoi në shkollën *“At Gjon Karma”* në njësinë administrative Gur i Zi, Bashkia Shkodër. Në këtë takim specialisti foli lidhur me korrupsionin dhe si ndikon ai në diskriminimin kryesisht tek grupet vulnerabël.
- Më 9 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online nëpërmjet platformës zoom takimin me temë: *“The Role of Equality Bodies and Human Rights Institutions in the Judiciary”*. Ky takim në formën e tryezës së rrumbullakët u organizua nga prezenca e OSBE në Shqipëri dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Më 9 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online konferencën e Equinet me temë: *“Tackling Institutional Racism- The potential of equality bodies”*. Qëllimi i konferencës ishte të prodhojë një perspektivë për këtë çështje të ndihmojë organet e barazisë në marrjen e masave për këtë çështje dhe të identifikojë se çfarë kërkohet për të mundur barazinë e organeve që të japin kontributin e tyre të plotë në adresimin e kësaj çështjeje. Në këtë konferencë në panel ishin përfaqësues të organeve të barazisë të vendeve të ndryshme pjesë e rrjetit Equinet.
- Më 9 dhe 10 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për pjesëmarrjen e tij në seancën dëgjimore dhe për diskutimin e një rasti të ri diskriminimi të pretenduar.
- Më 9 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me përfaqësuesen e Zyrës për Shërbime Ligjore Falas lidhur me rastet e paraqitura pranë kësaj zyre.
- Më 13 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen L.D., për dorëzimin e ankesës dhe dokumenteve shoqëruese.
- Më 13 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Z., për asistim në përgatitjen e shkresës me kundërshtime në lidhje me përgjigjen e kthyer nga drejtoria e shkollës së mesme profesionale *“Kol Margjini”*.
- Më 13 dhe 15 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin J.B., për informim.
- Më 14 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin *“Pitching Event”* organizuar nga Association for Democratic Prosperity – Zid në partneritet me *“Shqipëri për ndryshim dhe zhvillim”* dhe *“Intelektualët e Rinjë, Shpresë”*, në Podgoricë të Malit të Zi. Ky event organizohet nga projekti *“Work4Youth”* që zbatohet në zonën ndërkufitare Shqipëri - Mal i Zi. Projekti *“Work4Youth”* financohet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet thirrjes së dytë të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014-2020.
- Më 16, 17 dhe 20 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin online me temë: *“Monitoring Hate Speech and Gender-based Discrimination in Albania”* të organizuar nga OSCE.
- Më 16 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen K.D., për referim rasti dhe për informacion.

- Më 17 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me grupin e ankuesve për plotësimin e formularit të ankesës.
- Më 20 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesen L.D., për informacion.
- Më 20, 21 dhe 23 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me ankuesin A.Z., për informim dhe për asistim në përgatitjen e shkresës me kundërshtime.
- Më 22 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin për prezantimin e projektit *“Së bashku të suksesshëm”* që u organizua nga shoqata *“Intelektualët e Rinje, Shpresë”*, në partneritet me shoqatën *“Zdravi Grad”* nga Kroacia. Qëllimi i këtij projekti është nxitja e sipërmarrjes së grave të pa puna duke shfrytëzuar resurset natyrore. Ky projekt mbështetet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Integrimit European e Republikës së Kroacisë.

Ndihmë dhe Këshillim Ligjor

Pranë Zyrës Rajonale Shkodër gjatë vitit 2022 janë paraqitur subjekte të cilët kanë kërkuar informacion për problematika të ndryshme. Konkretisht Zyra Rajonale ka asistuar dhe informuar subjektet lidhur me:

- Asistim në plotësimin e formularit të ankesës drejtuar KMD.
- Asistim në formulimin e shkresave të ndryshme për KMD dhe për institucione të tjera lokale.
- Sqarim të shkresave të ndryshme të ardhura për qytetarët nga institucione të ndryshme si Kadastra apo ISSH.
- Adresim të subjekteve pranë Zyrës së Avokatit të Popullit, Komisionerit për Informimin dhe Mbrojtjes të të Dhënave Personale si dhe Zyrave që ofrojnë Ndihmë Ligjore Falas.
- Asistim të subjekteve të cilët nuk janë në gjendje të mirë shëndetsore dhe që kanë të pamundur të presin në rradhë pranë qendres ADISA, për kryerjen e procedurave për hapjen e portalit e-albania dhe nxjerrjen e çertifikatës së vaksinimit.

Dalje në Media

- Më 1 Prill, Specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka qënë e ftuar në emisionin Info Plus në Star Plus TV, për të diskutuar lidhur me një rast konkret të një subjekti i cili pretendonte se ishte i diskriminuar.
- Më 1 Prill, Specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë për Star Plus Tv lidhur me numrin e ankesave dhe rasteve të paraqitura pranë Zyrës Rajonale Shkodër.
- Më 27 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale Shkodër ka realizuar një intervistë për televizionin lokal Star Plus TV lidhur me numrin e ankesave që ka pasur Zyra.

4.2 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë

Aktivitetet të zhvilluara nga Zyra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Korçë:

Janar

- Më 12 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Arti i të folurit në publik*", e organizuar nga ASPA.
- Më 15 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Aftësitë prezantuese*", e organizuar nga ASPA.
- Më 26 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Statistikat përshkruese*", e organizuar nga ASPA.
- Më 27 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Hartimi i projektit*", e organizuar nga ASPA.

Shkurt

- Më 3 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me koordinatoren e MEDPAK Korçë. Në takim është prezantuar hapja e qendrës për fëmijët me aftësi të kufizuara të cilëve do u ofrohen shumë shërbime psiko-sociale si terapi etj. Gjatë këtij takimi është diskutuar problematika e ngritur nga prindërit që nuk përfitojnë sigurime shoqërore ashtu si kategoria e tetraplegjikëve, edhe pse kjo problematikë është ngritur shpeshherë por nuk ka marrë zgjidhje.
- Më 4 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në konferencën "Prezantimi i modelit të punësimit rinor "*Qendra me një Ndalesë*". Qëllimi i konferencës ishte përgatitja e të rinjve për punësim nga edukimi drejt tregut të punës. Në takim morën pjesë përfaqësues të ministrive, OJF që punojnë me të rinj etj.
- Më 9 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Inteligjenca emocionale përballë mendimit objektiv*" dhe "*Komunikimi strategjik, pjesa "së brendshme"*", e organizuar nga ASPA.
- Më 9 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një dalje mediatike në RTSH Korça. Në këtë emision u fol për ecurinë e punës së Zyrës Rajonale, rastet e paraqitura dhe fushat më të prekshme në kohë pandemie si dhe ndryshimet në Ligjin Nr. 10 221/2010 "*Për mbrojtjen nga diskriminimi*".
- Më 10 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka organizuar në kuadër të javës kundër diskriminimit dhe në bashkëpunim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe Zyrën e Ndihmës Juridike Falas aktivitetin me temë: "*Ne mundemi! Thuaj jo diskriminimit!*" Ky takim u organizua me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe përfaqësues të OJF-ve. Qëllimi i aktivitetit është ndërgjegjësimi dhe informimi i subjekteve mbi Zyrën Rajonale dhe aktivitetin e saj.
- Më 10 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Sjellja organizative në administratën publike*", e organizuar nga ASPA.
- Më 15 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: "*Lidershipi dhe karakteri*", e organizuar nga ASPA.

- Më 16 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Vendim-marrja irracionale në administratën publike"*, e organizuar nga ASPA
- Më 17 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Modelet e marrjes së vendimeve në administratën publike"*, *"Nocioni i diskriminimit në administratën publike"* dhe *"Konflikti i interesit në nivel vendor"*, të organizuar nga ASPA.
- Më 24 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Detyrimet e administratës publike gjatë procesit të negocimit në BE"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 24 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me pesë familjet e strehuar pranë stadiumit Pogradec. Qëllimi i takimit: *"Problematika e strehimit, shqetësim i mbarur në vite"*.
- Më 25 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Procedura për ndjekjen e rasteve të diskriminimit në administratën publike"*, e organizuar nga ASPA.
- Gjatë muajit Shkurt specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takime me specialisten e zyrës së deputetëve Korçë. Qëllimi i takimit ishte për problematikat ekonomike-sociale të subjekteve dhe mundësia e zgjidhjes së tyre pa kaluar në diskriminim.
- Gjatë muajit Shkurt specialisti i Zyrës Rajonale Korçë ka kontaktuar përfaqësues të institucioneve të ndryshme si Avokati të Popullit, Drejtorisë Rajonale të Punësimit dhe të Klinikës së Ligjit për zgjidhjen e problematikave të ndryshme.

Mars

- Më 1 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Dita botërore pa Diskriminim"*, organizuar nga AWEN (Rrjeti i fuqizimit të gruas në Shqipëri). Në takim morën pjesë aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile dhe organizatave. Në takim u fol për tema të ndryshme një ndër të cilat ishte dhe *"Dhuna seksuale Realitet dhe sfidë"*.
- Më 1 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin e organizuar nga ASPA me temë: *"Ndikimi i fakteve dhe opinioneve gjatë të menduarit kritik"*.
- Më 2 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në Webinarin e organizuar nga ASPA me temë: *"Teknikat e negocimit në administratën publike"*.
- Më 3 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në Webinarin e organizuar nga ASPA me temë: *"Komunikimi efektiv me median"*.
- Më 4 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin online me certifikim, *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"*, organizuar nga ASPA.
- Më 5 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin e organizuar nga ASPA me temë *"Organizimi i dosjes së personelit"*.
- Më 26 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin me Avokatin e Popullit.
- Më 29 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialistin e zyrës së strehimit. Në fokus të takimit ishin problematikat dhe hasja e vështirësive të

anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në plotësimin e dokumentacionit për përfitimin nga programi i restaurimit të banesave të tyre.

- Më 29 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me nën/kryetarin e Bashkisë Pogradec z. Paskalino Ziko. Në fokus të takimit ishin problematika e strehimit të banorëve të shtetshëm të cilët kanë adresuar pranë KMD ankesën e tyre. Në takim u diskutua dhe problematika e strehimit të banorëve të Gurit të Kuq me Albminierën.
- Gjatë muajit Mars specialisti i Zyrës Rajonale Korçë ka realizuar komunikime të vazhdueshme me telefon dhe e-mail në kuader të realizimit të detyrave të përditëshme.

Prill

- Më 1 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e organizuar nga MEDPAK me temë: *“Rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional për ofrimin e shërbimeve për PAK”*. Qëllimi i takimit ishte diskutimi në lidhje me mundësitë për të forcuar bashkëpunimin institucional në mbështetje të Qendrës Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara dhe shërbimeve të tjera në këtë fushë.
- Më 12 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e punës me Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.
- Më 14 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në aktivitetin e organizuar nga Aleanca Gjinore e Grave Korçë, me mbështetjen e Shoqatës *“Gruaja në zhvillim”*. Në takim morën pjesë gra që vinin nga fusha të ndryshme, si dhe përfaqësues të OJF-ve. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte: *“Rritja dhe fuqizimi i gruas në vendim-marrje”*.
- Më 21 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin online të organizuar nga Aleanca Gjinore për Zhvillim. Në takim morën pjesë kandidatë të forcave të ndryshme politike të cilët shpalosën programin e tyre dhe u përgjigjën pyetjeve të ndryshme të pjesëmarrësve nga shoqëria civile dhe OJF të ndryshme.
- Gjatë muajit Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar takim me drejtorin e Drejtorisë Mbështetëse Korçë. Qëllimi i takimit ishte lidhur me shqetësimin e ngritur pranë zyrës nga një subject i cili i përkiste komunitetit egjiptian dhe nuk kishte gjetur mundësi për regjistrimin e fëmijës së tij në kopësht. Falë ndërmjetësimit u bë e mundur regjistrimi i fëmijës dhe përjashtimi nga tarifa e kopshtit.
- Gjatë muajit Prill specialisti i Zyrës Rajonale, gjithashtu ka realizuar komunikime me ankues për dhënie informacioni lidhur me procedurën e ankesës.

Maj

- Më 24 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me *“Drejtësi Sociale”*, organizuan në Pogradec dhe Korçë ditë të hapura me komunitetet në nevojë. Në qytetin e Korçës takimi u zhvillua në shkollën e mesme *“Faik Konica”*, ku nxënësit dhe bordi i prindërve ngritën si shqetësim infrastrukturën e shkollës. Gjatë diskutimeve me to dolën problematika si mungesa e kushteve: ngrohja, lagështira,

mungesa e palestrës, të cilat kanë bërë që kjo shkollë të mos frekuentohet nga nxënësit edhe pse ndodhet në një nga zonat më kryesore të qytetit.

- Më 4 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në konferencën online me temë: *"Aktivizmi qytetar dhe pjesëmarrja në procesin e vendimarrjes në nivel vendor"*, organizuar nga Qendra për Advokim Social, LRE. Në fokus të takimit ishin problematika e strehimit për komunitetet Rom dhe Egjiptian. Ndërhyrja e pushtetit qendror dhe atij vendor tek ligji për strehimin si dhe planet vendore të miratuara në disa Bashki.
- Më 5 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Sfidat dhe roli i lidershit, në zbatimin e politikave publike"*, organizuar nga ASPA.
- Më 5 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Parandalimi i konfliktit të interesit"*, organizuar nga ASPA.
- Më 6 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin me temë: *"Diversiteti kulturor në qytetin e Korçës"*, aktivitet i organizuar nga Drejtoria e Monumenteve të Kulturës, në mbështetje të Ministrisë përkatëse. Në takim morën pjesë specialistë të fushave të ndryshme, përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët diskutuan funksionimin e diversitetit kulturor në njohjen dhe vlerat e tij.
- Më 12 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online aktivitetin me temë: Adresimi i gjuhës së urrejtjes nga liderhipi politik në Shqipëri, angazhimi qytetar, politika & përfaqësimi. Diskutim mes përfaqësuesve të komuniteteve të ndryshme në Shqipëri, organizuar nga ERA -OMSA.
- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin Rajonal, me temë: *"LGBTI duhen trajtuar si individ"*. Ky takim u zhvillua online, në platformën zoom. Takimi u zhvillua në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit Republika e Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Në këtë takim online pjesëmarrësit patën mundësi të shkëmbejnë mendime, ide dhe pikëpyetje të ndryshme për të luftuar Diskriminimin ndaj Komunitetit LGBTI dhe promovuar barazinë.
- Më 18 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *"Buxheti i Përgjithshëm Gjinnor në nivel lokal"*, organizuar nga ASPA.
- Gjatë muajit Maj specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Drejtorin e Qendrës së Formimit Profesional, specialisten e Zyrës së Punës, koordinatoren e *"Dorcas Albania"*. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i politikave të ndryshme që kanë lidhje me punësimin e të rinjve, diskriminimi që hasin të rinjtë e grupeve vulnerabël, të cilët edhe pse janë me arsim përkatës nuk punësohen.
- Gjatë muajit Maj, specialisti i Zyrës Rajonale Korçë ka komunikuar me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave për zgjidhjen e problematikave dhe rasteve të ndryshme.
- Më 31 maj dhe 2 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me Qendrën T'Reja ka organizuar në Pogradec dhe Korçë takimin me banorët e këtyre dy Bashkive. Ky takim u organizua në kuadër të projektit: *"Për drejtësi më të aksesueshme"*

për gratë dhe burrat në Shqipëri”, i cili financohet nga UNDP dhe zbatohet në 8 Bashki të Shqipërisë. Në takim morën pjesë nën/Kryetarja e Bashkisë Pogradec, Avokati i Popullit, Drejtori i OSHE Pogradec, specialist të Qendrës Komunitare, përfaqësues të KMD, etj. Gjatë takimit u diskutua situata aktuale e klientëve në nevojë në lidhje me furnizimin me energji elektrike dhe efektet sociale e ekonomike të mungesës apo kufizimeve në marrjen e këtij shërbimi, si dhe mbi rëndësinë e nxitjes së institucioneve përgjegjëse për hartimin e VKM-së për statusin e Klientit në Nevojë.

Qershor

- Më 4 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me temë: *“Integrimi socio-ekonomik i të rinjve vulnerabël”*. Kjo tryezë organizohet nga Fondacioni Misioni Emanuel në bashkëpunim me organizatën SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri, në kuadër të projektit *“Perspektiva që Mundësojnë Punësimin e të Rinjve (YEEP)”*. Qëllimi i tryezës është diskutimi dhe mbledhja e rekomandimeve për çështjet që lidhen me integrimin socio-ekonomik të të rinjve vulnerabël dhe prezantimi i rekomandimeve të mbledhura nga konsultimet e zhvilluara me të rinjtë mbi çështjet e punësimit dhe politikave rinore. Në takim kishte përfaqësues të institucioneve të ndryshme, të rinj dhe OJF.
- Më 7 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialisten e Zyrës së Punës lidhur me ecurinë e ankesës së paraqitur nga ankuesi I.B., në të cilën ngrihet problematika e mos njohjes së ditëve të festave nga ana e punëdhënësit.
- Më 8 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesin e organizatës *“Drejtësi Sociale”* Z. Gentjan Sejrani. Gjatë takimit u diskutua për bashkëpunimin dhe ofrimin e shërbimeve ligjore falas që kjo organizatë jep në ndihmë të komunitetit, rastet që janë referuar pranë saj tek Zyra Rajonale Korçë dhe ecuria e tyre.
- Më 9 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me banorët e zonës së gjeologjikes të cilët janë drejtuar zyrës sonë për ngritjen e shqetësimit lidhur me situatën e krijuar nga rrëshqitja e dheut si rezultat i rënies së shirave të rrëmbyeshëm, ku pati dëmtime në banesat e tyre, specialisti i Zyrës Rajonale ka shkuar pranë tyre ku është njohur me situatën dhe më pas ka komunikuar me nën/Kryetarin e Bashkisë, të cilit i ka shpjeguar situatën dhe masat që duhet të merren.
- Më 10 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim pune me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit.
- Më 15 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me Fondacionin *“Misioni Emanuel”*, ka organizuar aktivitetin me temë: *“Jo shfrytëzim, pro arsimim”*. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të ditës kundër shfrytëzimit të punës të fëmijëve. Ky aktivitet u zhvillua në ambjentet e Qendrës Multifunkionale, ku morën pjesë nëna, të rinj si dhe përfaqësues të OJF-ve. Gjatë takimit u diskutua për të drejtat e fëmijëve dhe mekanizmat mbrojtës për ta.

- Më 16 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me koordinatoren e Qendrës Komunitare pranë Bashkisë Korçë. Gjatë takimit u diskutua për rastet e ndryshme të diskriminimit për grupet në nevojë, mundësinë e bashkëpunimit.
- Më 24 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me shoqatat egjiptiane në Korçë, me mbështetjen e Bashkisë organizuan takimin me temë: *"Sfidat dhe të drejtat e komunitetit egjiptian. Promovimi i vlerave dhe kulturës së tij"*. Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të 24 qershorit, ditës së Egjiptianëve të Ballkanit, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme të pushtetit qendror dhe atij vendor.
- Më 25 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale priti në ambjentet e Këshillit të Qarkut Departamentin e Diskriminimit pranë Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës. Në takim u fol për punën sfidat dhe rastet e diskriminimit, të sjella pranë saj nga qytetarë, OJF, rolin e zyrës në zgjidhjen e tyre.
- Më 28 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimim me temë: *"Teoria e ndryshimit"*, zhvilluar në kuadër të programit *"Korça Integrated Development (KID)"*, të zbatuar nga Fondacioni *"Misioni Emanuel"* dhe *"Dorcas Albania"*.
- Gjatë muajit Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale Korçë ka pritur një numër të konsiderueshëm subjektsh të cilët kanë shprehur problematikat e tyre për marrjen e shërbimeve në institucionet e ndryshme, në veçanti nga Bashkia.

Korrik

- Specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me organizatën *"Drejtësi Sociale"*, organizuan në Pogradec takimin me banorët e Gurit të Kuq dhe me nën/kryetarët e kësaj Bashkie. Gjatë takimit u diskutua problematika e godinës së Gurit të Kuq, e cila kaloi në pronësi të Bashkisë, e cila së shpejti do të fillojë restaurimin për të plotësuar kushtet e familjeve që jetojnë aty, duke e kthyer atë në banesë sociale.

Gusht

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialistin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social lidhur me ankesën e F.D.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësues të Shoqatës së Personave me Aftësi të Kufizuar për të diskutuar mbi problematikat e shumta që has kjo kategori.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me specialisten e Ujësjellës Kanalizime Korçë për rastin e ankueses M.R., dhe mungesën e ujit të pijshëm. U diskutua vendosja e matësit, pasi subjekti jeton në ambjentet e dikurshme të Bashkisë.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Rrjetin e Organizatave Rome dhe Egjiptiane, përfaqësues të ROMACTED dhe koordinatoren e Qendrës Komunitare, për të diskutuar mbi ecurinë e Planit Lokal të Veprimit për këtë kategori.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit për diskutuar mbi delegimin e ndërsjellë të ankesave.

Shtator

- Specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me fondacionin “Misioni Emanuel” ka zhvilluar takim me nënat e qëndrave ditore. Gjatë takimit është bërë prezantimi i punës së KMD në Korçë si dhe janë ngritur një sërë problematikash sociale nga ana e tyre, ku një rëndësi të veçantë zë arsimimi i fëmijëve në këtë kohë pandemie.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesin e World Vision. Qëllimi ishte diskutimi i problematikave social-ekonomike dhe diskriminimi kundrejt komuniteteve dhe individëve në nevojë, duke mos i mbështetur në ofrimin e shërbimeve të caktuara, kryesisht shërbimet online. U pa mundësia bashkëpunimit për të ndihmuar në zgjidhjen e këtyre problematikave.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me specialistin e KNK për ankesën e paraqitur tek Zyra Rajonale nga dy subjekte të cilëve u është ndërprerë energjia elektrike.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit për organizimin e përbashkët të një dite të hapur ndërgjegjësimin në qytetin e Korçës.
- Më 8 shtator, specialist i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në webinarin me temë: *“Publiku dhe politikat e tij”*, e organizuar nga ASPA.
- Më 14 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka qënë pjesëmarrës në aktivitetin me temë: *“Forum publik – Kontrata Sociale POP”*, nga Bashkia Korçë. Në këtë aktivitet u bë prezantimi i Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë, si dhe prezantimi i gjetjeve të problematikave nga vetë subjektet.
- Më 21 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin on-line zhvilluar me iniciativën e Avokati i Popullit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes Zyrave Rajonale respektive, në marrjen dhe delegimin e ankesave të publikut.
- Më 28 Shtator specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit, organizuan ditën e hapur me qytetarët e Korçës, ku u shpërndanë broshura informuese dhe prezantuan rolet e zyrave rajonale të KMD dhe Avokatit të Popullit, si dhe ndihma në delegimin e ankesave të tyre.

Tetor

- Më 7 Tetor, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi një sesion informues dhe trajnues me gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile me temë: *“Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit”*. Ky aktivitet u zhvillua në bashkëpunim me AMA.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialistet e Ujësllës Kanalizime Korçë, për të diskutuar mbi mundësinë e ndërmjetësimit për zgjidhjen e ankesës së znj. D.O.

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesen e MEDPAK, me fokus problematikat e ndryshme social-ekonomike që hasin personat me aftësi të kufizuara.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësues të Drejtorisë Mbështetëse të Arsimit dhe Kopshteve pranë Bashkisë Korçë; Zyrës së Punës; Drejtorisë së Kujdesit Social për ankesën e paraqitur pranë KMD nga një grup subjektësh, lidhur me me përfitimin e minibursës për fëmijët e kategorive në nevojë të shkollave 9-vjeçare.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar me nënkryetaren e Bashkisë, lidhur me shqetësimin e një grupi subjektësh të cilët për shkak se nuk janë të regjistruar si punëkërkuar (të papunë), penalizohen për të marrë bonusin e kompesimit për fëmijët e tyre (kategori të veçanta). Përmbledhja e konkluzioneve të këtij takimi i është dërguar me email të gjithë aktorëve të institucioneve, për të reaguar dhe dhënë zgjidhje shqetësimit të ngritur nga subjektet.
- Më 11 - 14 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin e certifikuar, me temë: *"Angazhimi proaktiv i paraligjorëve në kuadër të rritjes së aksesit të kategorive vunerabël në shërbimet e ndihmës juridike të garantuar nga shteti"*, organizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë.
- Më 18 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka qënë pjesë e seminarit informues me temë: *"Fuqizimi i Diversitetit dhe Qëndrueshmëria e Medias Vendore"*, në kuadër të programit "Media for All", financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe i lëvruar nga Këshilli Britanik. Ky seminar u organizua nga RTSH Korça.
- Më 20 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët organizuar me nënkryetaren e Bashkisë Korçë, drejtorin e Drejtorisë së Kujdesit Social dhe përfaqësues të OJF Rome dhe Egjiptiane. Tema e takimit ishte lidhur me zbatimin dhe monitorimin e Planit Vendor për Romët dhe Egjiptianët në Korçë.
- Më 21 dhe 22 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin me temë: *"Teoria e ndryshimit dhe ndryshimi socila në komunitet"*, organizuar nga *"Misioni Emanuel"* dhe *"Partners Albania"* me mbështetjen e *"Dorcas Aid International"*. Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi i komunitetit për të qënë pjesë e vendim-marrjes në zgjidhjen e problematikave të ndryshme sociale.
- Më 22 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur webinarin me temë: *"Korrupsioni dhe diskriminimi në bazë të racës dhe përkatësisë etnike"*, e organizuar nga ASPA.

Nëntor

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Kryetarin e Rajonit Nr. 3. Takimi kishte në fokus ankesat e ndryshme ekonomike-sociale të subjekteve referuar pranë zyrës së KMD Korçë dhe mundësinë e bashkëpunimit për zgjidhjen e tyre.
- Specialistja e Zyrës Rajonale ka organizuar një tryeze me nënkryetaren e Bashkisë, Drejtorinë e Kujdesit Social, Drejtorinë Rajonale të Punësimit. Kjo tryezë është

zhvilluar në ambjentet e Bashkisë. Shqetësimi i ngritur nga specialistja e Zyrës Rajonale të KMD ka qënë lidhur me ankesat e paraqitura nga nje grup i madh subjektsh të cilët nuk mund të përfitonin dot nga VKM Nr. 666 dt. 10/10/2019, e rishikuar, për përfitimin e bursave për nxënësit e shkollave të mesme profesionale dhe ato 9-vjeçare. Në bazë të këtij udhëzimi përfitojnë disa kategori ku midis tyre ishte dhe kategoria si punëkërkues i papunë dhe ata që trajtohen me ndihme ekonomike. Shqetësimi i ngritur nga ana jonë ishte për atë kategori që është e papunë, por nuk figuron e regjistruar tek zyra e punës si punëkërkues i papunë ose nuk përfitojne ndihmën ekonomike për disa arsye: Nuk kanë informacionin e duhur që duhet të regjistrohen; Nuk marin këtë shërbim tek ky institucion (numri për këtë shqetësim, ishte tepër i lartë nga vetë subjektet); Nuk janë përfitues nga skema e ndihmës ekonomike sepse nuk i ka marrë sistemi i saj. Mbasi u njohën me këtë shqetësim, nga institucionet u ra dakort që të shtyhet afati mbasi edhe kjo ishte një mënyrë penalizimi, të mblidhen listat me emrat e këtyre subjekteve dhe të futen në sistem.

- Më 9 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin e zhvilluar me nënkryetaren e Bashkisë, një grupim social për prezantimin e gjetjeve të projektit të zbatuar nga Bashkia Korçë *"Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen"*, si dhe për të diskutuar mbi vazhdimësinë dhe objektivat për të ardhmen.
- Më 9 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur webinarin me temë: *"Pjesëmarrja e sektorit publik dhe privat në ofrimin e shërbimeve publike"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 10 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur webinarin me temë: *"Fazat e procedurës administrative"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 11 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur webinarin me temë: *"Masat disiplinore dhe etika në administratën publike"*, e organizuar nga ASPA.
- Më 23 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur webinarin me temë: *"Monitorimi dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave në luftë kundër trafikimit të qenieve njerëzore"*, e organizuar nga *"Qendra për nisma Ligjore"*. Gjatë takimit u prezantua raporti i monitorimit.
- Më 25 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në aktivitetin me temë: *"16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore"*, për të dhënë mesazhin se dhuna ndaj gruas është na prek të gjithëve dhe ajo duhet të marrë fund.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në ciklin trajnimit WOMEP (Women Municipal Excellence Programme), organizuar nga OSCE.

Dhjetor

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga Avokati i Popullit me temë: *"Të drejtat e fëmijëve"*, vazhdim i ciklit të përbashkët të trajnimeve mes Zyrave rajonale të dy institucioneve.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me një grup familjarësh në nevojë të cilët kanë ngritur shqetësimin e tyre lidhur me VKM Nr. 666 datë 10.10 2019. Sipas tyre kjo VKM përjashton fëmijët e familjeve në nevojë ekonomike, të cilët e ndjekin shkollën rregullisht dhe favorizon ata fëmijë që nuk e ndjekin shkollën fare,

pavarësisht nivelit ekonomik që mund të kenë familjet e tyre. Këtë shqetësim specialistja e Zyrës Rajonale e ka ngritur në Këshillin Bashkiak, ku ka marrë mbështetjen e Kryetarit të Bashkisë dhe anëtarëve të këshillit, nga të cilët është propozuar rishikimi i mundësisë për përfshirjen edhe të fëmijëve që vijnë nga familje të nivelit të ulët ekonomik dhe financiar.

- Specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në konferencën kombëtare me temë: *“Nxitja e integritetit në nivel lokal në Shqipëri”*. Qëllimi i kësaj konference është diskutimi me përfaqësues të pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe medias mbi rëndësinë e integritetit në lidhje me rritur besimin e publikut si dhe lidhur me zbatimin e kontratave sociale.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me banorët e zonës së *“Gjeologjikes”*. Gjatë takimit u diskutua për problematikën e mospërfitimit të minibursës në bazë të VKM Nr. 666, datë 10.10.2019.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialisten e Zyrës Rajonale të Punësimit Korçë, ku u diskutua çështja e personave me aftësi të kufizuara, që kanë ngritur shqetësimin e tyre pranë zyrës së KMD, për ndërprerjen e kempeve dhe mospërfitimin nga programi i punësimit për këtë kategori.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me përfaqësuesin e organizatës *“Drejtësi Sociale”*. Gjatë takimit u diskutuan problematika të ndryshme social-ekonomike që prekin komunitetin rom dhe egjiptian, diskriminimi që ata hasin nga institucionet, në veçanti në fushën e ofrimit të shërbimeve.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me lehtësuesen e programit ROMACTED. Gjatë bisedës me të u diskutua ecuria e Planit të Veprimit për këtë kategori, sa të përfshirë janë në këtë plan dhe përfitimi që kanë aptur deri tani, përkthyer në rezultate konkrete.
- Specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me specialistin dhe juristin pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Korçë, me fokus problematika e ankës së subjektit A. H., për mospërfitimin e pensionit social edhe pse ka mbushur moshën 70 vjeç.

Zgjidhja e çështjeve me ndërmjetësim

1. Ndërmjetësim në fushën e punësimit

- Rasti i shtetases I.B., e cila u paraqit pranë zyrës për të bërë ankesë kundrejt firmës *“Elda SHPK”*, pasi kjo e fundit nuk i ofronte pagesën e lejes vjetore dhe ditët e festave duke shkelur në këtë mënyrë kontratën e firmosur si dhe kodin e punës. Kjo shtetase ka qenë edhe më parë ankuese pranë KMD, drejtuar nga grup personash (grash) për mospërfitimin e pagës së luftës dhe pagesën e papunësisë. Sipas saj, kjo ka qenë arsyeja e vërtetë e penalizimit nga punëdhënësi. Rasti u zgjidh në bashkëpunim me Inspektoriatin Rajonal të Kontrollit, me ndihmën edhe të organizatës *“Drejtësi Sociale”*, duke bërë të mundur që jo vetëm ankuesja, por të gjitha punonjëset të përfitonin pagën e ditës së festave.

- Tre (3) raste të ndërmjetësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Punësimit Korçë për përfshirjen në programin e nxitjes së punësimit familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Njëzet (20) subjekte janë ndërmjetësuar për pajisjen me kartonin si punëkërkues. Zgjidhja e rastit është inicuar nga VKM Nr. 666, datë 10/10/2019, në bazë të të cilës fëmijët e arsimit bazë të cilët janë në risk braktisje ose braktisës së shkollës përfitojnë një minibursë, bazuar në kriterin që prindërit duhet të jenë të regjistruar si punëkërkues (të papunë) pranë Zyrës së Punës. Në bashkëpunim me këtë të fundit u bë e mundur që këto familje të regjistroheshin si punëkërkuese dhe fëmijët të futeshin në listën e përfituesve të minibursës së shkollës.
- Ndërmjetësim për punësimin e shtetases A.K., e cila është person me aftësi të kufizuar. Problematika e saj qëndron në faktin se personi është me aftësi të kufizuar (mungesa e dorës), por ajo nuk gëzon disponon dokumentin përkatës nga KMCAP. Ky fakt e ka penalizuar, që të përfitojë nga skema e punësimit për personat me aftësi të kufizuar. Për këtë arsye janë organizuar disa takime me përfaqësuesit e Drejtorisë së Zyrës së Punësimit në Korçë, me qëllim që të shihet mundësia e ndryshimit të praktikës ligjore për personat me aftësi të kufizuar, por që janë në gjendje të ushtrojnë një profesion të caktuar.

2. *Ndërmjetësim për përfitimin e ndihmës ekonomike*

- Një grup përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian janë paraqitur pranë Zyrës Rajonale për të parashtruar ankesën e tyre, pas përjashtimit nga skema e ndihmës ekonomike. Në komunikim të vazhdueshëm me Administratorët e Rajoneve dhe Zyrën e Punës është bërë i mundur kthimi në skemë i disa anëtarëve që në mënyrë jokorrekte u ishte ndërprerë ndihma ekonomike.
- Për shkak të pandemisë, subjektet po përballen me një tjetër problem i cili është i lidhur me gjenerimin e dokumentave nga portali E-Albania. Duke hasur vështirësi në përdorimin e portalit, bëhet i pamundur sigurimi i dokumentave që ata kërkojnë, siç është ai i gjenerimit të kartonit të punëkërkuesit (i papunë) për përfitimin e ndihmës ekonomike. Si pasojë e kësaj, subjektet e papunë nuk kanë arritur të dorëzojnë në kohë kartonin, ndaj janë përjashtuar nga mundësia e aplikimit. Për këtë arsye u zhvilluan dy takime me Zyrën e Punësimit dhe Administratorin Social për Ndihmën Ekonomike. Në bashkëpunim edhe me Njësitë Administrative të Rajoneve, 5 raste kanë marrë zgjidhje.

3. *Ndërmjetësime në fushën e arsimit*

- Ndërmjetësuar nga Zyra Rajonale Korçë për problematikën e 4 fëmijëve të fshatit Shtyllë, Vithkuq, të cilët çdo ditë ecnin në këmbë 7 km, për të shkuar në shkollë. Rasti në fjalë u bë mediatik. Pas komunikimit me administratorin e zonës, drejtoreshën e shkollës si dhe me vetë prindërit e fëmijëve, në bashkëpunim me aktivistët e Fondacionit Soros u bë e mundur mbështetja financiare për transportin dhe pajisja me

2 kompjutera. ZR në bashkëpunim me një kompani interneti ka arritur të sigurojë internet falas për këta fëmijë.

- Zyra Rajonale ka ndërmjetësuar në përjashtimin e 2 fëmijëve nga tarifa e kopshtit (I.D., M.M.). Rasti u paraqit si ankesë pranë DPA, por nga komunikimi me specialisten e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, rasti u zgjidh me ndërmjetësim.
- Gjatë muajit tetor pranë Zyrës Rajonale është paraqitur në grup prindërisht të cilët kanë shprehur shqetësimin e tyre lidhur me frekuentimin e shkollës për fëmijët e tyre. Fëmijët vinin nga familje në nevojë dhe studionin prej 2 vitesh në një nga shkollat me emër të qytetit. Për shkak të rritjes së numrit të nxënësve në klasë, mësuesja u kishte njoftuar largimin nga kjo shkollë dhe dërgimi në një shkollë periferike. Zyra Rajonale ka ndërhyrë dhe ndërmjetësuar në zgjidhjen e rastit dhe evitimin e situatës së segregimit për këta fëmijë.
- Ndërmjetësim me Ndërmarrjen Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve pranë Bashkisë Korçë për shtyrje afati në dërgimin e listave pranë Këshillit Bashkiak për një grup fëmijësh të cilët gëzonin statusin si braktisur ose në risk braktisje. Zyra ka asistuar prindërit në plotësimin e dokumentacionit përkatës për të përfituar nga kjo praktikë.
- Zyra Rajonale ka referuar 4 raste gra të dhunuara, pranë Zyrës së Dhunës në Bashkinë Korçë dhe në Zyrën e Ndihmës Juridike Falas në Pogradec, për të lehtësuar procedurat e divorcit për to.

4. *Ndërmjetësim për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar*

- Gjatë kësaj periudhe Zyra Rajonale Korçë ka referuar pranë TLAS dhe Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, Maliq, 6 raste të mos regjistrimit të fëmijëve, për shkaqe si divorci, martesat e hershme ose lindja e fëmijëve jashtë territorit të Shqipërisë, duke bërë të mundur zgjidhjen e problemit të tyre.
- Është ndihmuar shtetasja E.C., për regjistrimin e 2 fëmijëve, të cilët kanë lindur jashtë Shqipërisë. Po ashtu kjo shtetase, për shkak të gjëndjes së vështirë ekonomike është ndihmuar me procedurat e zgjidhjes së martesës.
- Është ndihmuar shtetasja E.O., për regjistrim 3 fëmijëve të lindur në Kosovë. Familja vjen nga komuniteti rom.
- Shtetasi J.R., student, i cili jeton i vetëm mbasi prindërit i kanë ndëruar jetë, prej shumë vitesh nuk ka qënë përfitues i statusit të jetimit. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit Social, J.R., tani është përfitues i këtij statusi dhe trajtohet me bursë universitare.
- Dy raste janë referuar pranë Qendrës mbështetëse për familjet dhe fëmijët në nevojë. Është zhvilluar takim me përfaqësuesit e kësaj qendre, me të cilët u bë e mundur që fëmijët e këtyre familjeve, por jo vetëm, të përfitojnë bursë shkolllore.

Nga ana e Zyrës Rajonale janë asistuar për zgjidhjen e problematikave të ndryshme:

- Dy familje në plotësim dokumentacioni për përfitimin e bonusit të qerasë.

- Shtetasi H.Xh., i vetmuar 62 vjeç, i cili jeton vetëm me ndihmë ekonomike është ndihmuar për plotësimin e dokumentacioni për përfitimin e bonusit të strehimit, si dhe është ndërmjetësuar me Zyrën e Strehimit për ta përfshirë në skemën e bonusit të qerasë.
- Ndërmjetësim me zyrën e strehimit për t'u parë mundësia e strehimit të shtetases E.C., kryefamiljare e divorcuar, me 2 fëmijë, njëri prej tyre me aftësi ndryshe. Po ashtu është ndihmuar për plotësimin e dokumentacionit të bonusit të strehimit, si dhe për ndryshimin e vendbanimit nga bashkia Devoll në bashkinë Korçë, mbasi jeton prej vitesh në këtë qytet, bashkë me fëmijët e saj.
- Ndërmjetësim për shtetasen E. I., për përfitim bonusit si kryefamiljare e ve.
- Ndërmjetësim me nënkryetarin e Bashkisë Korçë për të ndërhyrë në rregullimin e ambjenteve tek zona e njohur si ish-gjeologjika. Puna është në proces.
- Rasti i banorëve të Gurit të Kuq të cilët janë strehuar tek godina e ALB Minierës. Në bashkëpunim me Klinikën Ligjore falas është arritur që këto familje deri tani të jenë fituese të procesit gjyqësor. Falë bashkëpunimit me organizatën "*Drejtësi Sociale*" u bë i mundur zgjidhja e problemit ku godina e ish ALB Minierës Pogradec të kalojë në pronësi të Bashkisë Pogradec, ku nga kjo e fundit është premtuar restaurimi e godinës për banorët.
- Pranë Zyrës Rajonale Korçë janë paraqitur subjekte të ndryshëm të cilët kanë bërë ankesa në lidhje me ndërprerjen e ujit të pijshëm, për shkak të pa mundësisë ekonomike për të paguar faturat e ujit. Këto familje jetojnë në kushte shumë të vështira ekonomike. Specialisti i Zyrës Rajonale realizoi ndërmjetësim për lidhjen e akt-marrveshjeve për këto subjekte.
- Pranë Zyrës Rajonale është paraqitur një grup subjektesh të cilët janë ankuar për ndërprerjen e ujit të pijshëm. Ky grup jeton me të të ardhura nën minimumin jetik dhe për pasojë nuk kanë mundur të paguajnë faturat e ujit. Zyra Rajonale në bashkëpunim me Ujësjellës Kanalizime Korçë kanë mundësuar rilidhjen e ujit si dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje mes ketyre subjekteve dhe UKK për të kryera likuiditetet e faturave të prapambetura me këste mujore. Emanuela Rakipi rilidhje të ujit të pijshëm dhe vendosje matësi.
- Zyra Rajonale ka ndërmjetësuar për vendosjen e matësive të ujit dhe shtrirjen e tubacioneve për 24 familjeve që jetojnë tek zona e ish-gjeologjikes. Familjet i janë drejtuar KMD me ankesë dhe rasti është zgjidhur me ndërjetësim.
- Janë referuar 4 raste ankesash pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Pogradec.

Dalje në media

- Më 9 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një dalje në medja në RTSH Korça. Ecuria e punës së Zyrës Rajonale, rastet e paraqitura dhe fushat më të prekshme në kohë pandemie dhe ndryshimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në emisionin e mëngjesit në TV Korça, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë.
- Më 24 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka qenë i ftuar në emisionin e mëngjesit, të TV Korça, për të folur në kuadër të 24 qershorit, Ditës së Komunitetit Egjiptian, sfidat e këtij komuniteti si dhe politikat sociale të pushtetit qendror dhe atij vendor në fusha të ndryshme.
- Më 12 Gusht, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një dalje në media tek TV Korça.
- Më 8 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka qenë e ftuar tek MNCTV AL.
- Më 6 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një dalje mediatike në TVKorça. Tema e trajtuar ishte: *"Frekuentimi i shkollës 9 vjeçare nga fëmijët e komunitetit Rom dhe Egjiptian. Sfidat e tyre në këtë vit shkollor"*.
- Më 2 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka qenë e ftuar në emisionin e mbasdites pranë RTSH Korça ku tema e diskutuar ka qenë *"Sfida dhe arsimimi i komunitetit Rom dhe Egjiptian"*.

4.3 Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier

Aktivitetet të zhvilluara nga Zyra Rajonale e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Fier:

Janar

- Më 5 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me specialistin e Ndhmës Ekonomike, në Bashkinë Fier, për t'u njohur me ligjin dhe kategoritë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, si edhe marrjen e një informacioni të përgjithshëm për trajtimin e rasteve PAK.
- Më 6 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Performanca individuale"*, organizuar nga ASPA.
- Më 7 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin on-line në platformën Zoom me DPA, për të diskutuar mbi hartimin e raportit vjetor si dhe diskutimi i problematikave të ndryshme.
- Më 10 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me mjeken e personave PAK në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për të diskutuar mbi rastin e 3 (tre) vëllezërve PAK (parapëlqjik), në lidhje me dosjen e tyre si PAK, të cilëve u është ndërprerë trajtimi me KEMP. Mjekja sqaroi se çështja e tyre ndodhet në proces shqyrtimi në KMCAP Eprorë.
- Më 26 Janar, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Statistikat përshkruese"*, organizuar nga ASPA.
- Më 29 janar, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në workshopin Rajonal (Elbasan-Berat-Korçë) për nxitjen e Rrjeteve Qytetare Lokale dhe avancimin e çështjeve në Parlament, organizuar nga IDM Albania.
- Gjatë muajit Janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur komunikime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit, që operojnë në Vlorë, Berat dhe Sarandë, për të diskutuar mbi problematika të përbashkëta dhe adresimin e

zgjidhjes së tyre, si edhe ka inspektuar raste në bashkëpunim me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit Vlorë, në qarkun e Fierit. Po ashtu ka pasur komunikime dhe takime me Juristen e Ndhmës Ligjore Falas në kuadër të bashkëpunimit dhe organizimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere si dhe adresimin reciprok të çështjeve. Gjatë këtij muaji, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar dhe pritur telefonata nga publiku për informim në lidhje me procedurën e ankesës, si dhe çështje që lidhen me diskriminimin.

Shkurt

- Më 3 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Drejt një dialogu më të madh Ndërkulturorë, Ndërbesimtarë dhe Ndërfetarë në Ballkanin Perëndimor"*, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
- Më 3 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Konsultimi publik në kohë pandemie"*, organizuar nga ASPA.
- Më 9 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Komunikimi strategjik, pjesa së brendshme"*, organizuar nga ASPA.
- Më 10 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Vendim-marrja racionale në administratën publike"*, organizuar nga ASPA.
- Më 11 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në ëorkshopin Rajonal, (Fier, Vlorë, Gjirokastrë) me temë: *"Nxitja e Rjeteve Qytetare Lokale dhe avancimi i çështjeve vendore në Parlament"*, organizuar nga IDM Albania.
- Më 12 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Komunikimi strategjik, pjesa së jashtme"*, organizuar nga ASPA.
- Më 12 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në Aktivitetin online me temë: *"Aspekte të zbatimit të nenit 52 dhe 53 të Konventës së Këshillit të Europës, për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje"*, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), në kuadër të projektit *"Mbështetje Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore"*, financuar nga KE dhe mbështetur nga UN Women.
- Më 15 dhe 16 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: *"Programi i Angazhimit Qytetar për Përparimin e të Drejtave të Komunitetit LGBTI në Shqipëri, Politika dhe Përfaqësimi"*, organizuar nga *"Open Mind Spectrum Albania"* (OMSA), me mbështetjen e Republikës Federale të Gjermanisë, organizatë e cila po realizon një program me fokus angazhimit qytetar, të drejtat, përfaqësimin dhe politikat për promovimin e diversitetit dhe të barazisë në Shqipëri. Takimi i radhës ishte në Vlorë dhe Sarandë, me përfaqësues të Forumeve Rinore të Partive Politike në këto qytete, me pjesëmarrjen e Zyrës Rajonale të KMD-së në Fier si edhe Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në Vlorë. Ky program synon të nxisë gjithëpërfshirjen brenda partive politike dhe të zbusë diskriminimin dhe stigmatizimin ndaj komunitetit LGBTI.
- Më 17 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Modelet e marrjes së vendimeve në administratën publike"*, organizuar nga ASPA.
- Më 17 Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Nocioni*

i diskriminimit në administratën publike", organizuar nga ASPA.

- Më 18 shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Rëndësia dhe përfitimet e konsultimit publik", organizuar nga ASPA.*
- Më 22 shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim pune me Juristen e Ndihmës Ligjore Falas dhe Monitoruesen e PNUD-it, me fokus organizimin e ditëve të hapura në institucionet lokale dhe takime në 3 komunitete të Qarkut Fier, për informim dhe ndërgjegjësim.
- Më 25 shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Procedura për ndjekjen e rasteve të diskriminimit në administratën publike", organizuar nga ASPA.*
- Më 26 shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online në platformën Zoom me temë: *"Dhuna seksuale-Realitet dhe Sfidë", organizuar nga AWEN- Albanian Women Empowerment Network.*
- Gjatë muajit Shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur komunikime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Zyrave Rajonale të Avokatit të Popullit, në Vlorë dhe Berat, me Juristen e Ndihmës Ligjore Falas Fier dhe Lushnje, si dhe me përfaqësues të OJF-ve për angazhim dhe bashkëpunim në aktivitete të përbashkëta informuese dhe ndërgjegjëse. Po ashtu ka shpërndarë për informim dhe ndërgjegjësim materiale të KMD-së si dhe ka komunikuar dhe pritur telefonata nga ankues për dhënie informacioni lidhur me rastet e adresuara prej tyre.

Mars

- Më 3 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin paraprak mbi zhvillimin e kursit të trajnimit: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative", organizuar nga ASPA.*
- Më 4 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin online me temë: *"Konceptet kyçe të procesit administrativ", organizuar nga ASPA.*
- Më 5 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Ndikimi i inteligjences emocionale tek individit dhe organizata", organizuar nga ASPA.*
- Më 08 Mars, në kuadër të javës së gruas, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin me temë: *"Unë jam ndryshimi", organizuar nga rrjeti vullnetar "Platforma Kombëtare për Gratë".* Gjatë aktivitetit specialistja e Zyrës Rajonale dha edhe një mesazh për një shoqëri pa diskriminim ndaj gruas, pasi të drejtat e gruas janë të drejtat e njeriut.
- Më 9 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"* mori pjesë në sesionin e dytë me temë: *"Parimet e Kodit të Procedurave Administrative", organizuar nga ASPA.*
- Më 10 mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online në platformën Zoom, workshopin Kombëtar Tematik me temë: *"Mbështetja e nismave qytetare në veprimtarinë vendimarrëse të parlamentit".* Ky aktivitet vjen në kuadër të një nisme që IDM Albania dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH) po zbatojnë dhe që ka si objektiv krijimin e një mjedisi lehtësues për përfshirjen aktive të subjekteve në proceset legjislativ dhe

- vendimmarrëse në Parlament si një mjet për të rritur llogaridhënien dhe transparencën e këtij institucioni dhe përfaqësuesve të zgjedhur (deputetët). Kjo iniciativë është në kuadrin e "Mbështetjes për Parlamentin dhe Edukimin Qytetar në Shqipëri" (PACEP), një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), zbatuar nga Instituti Demokratik Amerikan (NDI).
- Më 10 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në seancën informuese online, në kuadër të projektit me fokus: *"Barazinë, Mosdiskriminimin dhe Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara përmes vetë-avokatisë"*, mundësuar nga *"Programi i Shoqërisë Civile për Shqipërinë dhe Kosovën"*, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqërinë Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA), organizuar nga FSHDKAP.
 - Më 11 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mireadministrimi i procedurave administrative"*, mori pjesë në sesionin e tretë me temë: *"Fazat e procedurës administrative (Fillimi i një procedure administrative)"*, organizuar nga ASPA.
 - Më 16 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"* mori pjesë në sesionin e katërt me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"*, organizuar nga ASPA.
 - Më 17 Mars, Zyra Rajonale Fier organizoi aktivitetin me temë *"Për një shoqëri pa diskriminim"*, me pjesëmarrjen e Organizatave të Shoqërisë Civile të qytetit të Vlorës dhe Fierit si edhe me pjesëmarrjen e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Vlorë. Në këtë takim u diskutuan ndryshimet dhe risitë e Ligjit Nr. 10 221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" si dhe nxitja e bashkëpunimit të Komisionerit me aktorët e Shoqërisë Civile për përmirësimin e situatës së diskriminimit në vend.
 - Më 18 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me znj. I.H., monitoruese e rasteve të dhunës në familje, përfaqësuese e Zyrës së Shtypit në Bashkinë Fier, në lidhje me veprimtarinë e KMD-së, rastet e adresuara dhe funksionet e Zyrës Rajonale.
 - Më 18 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"* mori pjesë në sesionin e pestë me temë: *"Akti Administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative"*, organizuar nga ASPA.
 - Më 23 Mars specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"* mori pjesë në sesionin e gjashtë me temë: *"Njoftimi dhe ekzekutimi i një procedure administrative"*, organizuar nga ASPA.
 - Më 23 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online me temë: *"Qasja në shërbime ndaj grave e vajzave nga komuniteti Rom/Egjyptian, LGBTI dhe atyre me aftësi të kufizuara, specifikisht në situatën e krijuar nga Covid-19"*. Sesioni trajnues realizohet në kuadër të zbatimit të projektit: *"Promovimi i të drejtave të grave nga grupet e disavantazhuara për informacion dhe akses në shërbimet e vlefshme për gratë të mbijetuara nga të gjitha format e dhunës dhe diskriminimit"*. Ky projekt është pjesë e

programit rajonal kundër dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, financuar nga KE dhe zbatuar nga UN Women.

- Më 26 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin e përbashkët me Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit, Zyrrave Rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Zyrat për Ndihmë Juridike Falas. Fokus i këtij trajnimi është roli dhe funksioni i Zyrrave Rajonale të KMD-së dhe rëndësia e bashkëpunimit me Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit dhe Zyrat për Ndihmë Juridike Falas.
- Më 31 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online webinarin me temë: *"Gjithëpërfshirja e Personave me Aftësi të Kufizuar në Arsimin dhe Formimin Profesional në Shqipëri"*, organizuar nga Aftësi për Punë S4J dhe Doën Syndrome Albania.
- Më 31 Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online Konferencën Rajonale me temë: *"Një themel i të Drejtave të Njeriut: Institucione Kombëtare Efektive të të Drejtave të Njeriut për Ballkanin Perëndimor"* organizuar nga Instituti i Politikave Evropiane – Shkup në bashkëpunim me Mbrojtësit e të Drejtave Civile.
- Gjatë muajit Mars, specialisti i Zyrës Rajonale ka komunikuar dhe ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me institucionet lokale dhe përfaqësuesit e organizatave të Shoqërisë Civile që ushtrojnë veprimtarinë në Fier dhe Vlorë, si edhe me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në Vlorë. Po ashtu, specialisti i Zyrës Rajonale ka informuar subjektet dhe ankuesit lidhur me procedurën e shqyrtimit të ankesave nga KMD.

Prill

- Më 6 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të trajnimit online me temë: *"Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"* mori pjesë në sesionin e fundit të trajnimit, (testim dhe dorëzim detyrë) për tu pajisur me certifikatë në përfundim të këtij trajnimi.
- Më 7 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në Konferencën për prezantimin e raportit të monitorimit, në kuadër të projektit: *"Monitorimi qytetar i transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore"*, i cili zbatohet nga IDM Albania dhe mundësohet nga *"Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën"*, financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga KCSF në partneritet me Partners Albania për Ndryshim dhe Zhvillim.
- Më 9 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me QNJ (Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Falas), në kuadër të nismës "ditë të hapura", realizuan një takim me Komunitetin Rom në Njësinë Administrative Mbrostar, me fokus informimin e këtij komuniteti mbi veprimtarinë e institucioneve përkatëse; si mund të referojnë një ankesë në secilin prej institucioneve si dhe u diskutuan problematika të ndryshme me të cilat përballlet ky komunitet.
- Më 12 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online në Zoom, organizuar nga DPA, në kuadër të analizës për punën e bërë gjatë vitit 2020, si dhe problematikat e hasura gjatë kësaj periudhe.
- Më 14 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim pune me një grup Avokatësh nga qyteti i Vlorës, të cilët ishin të interesuar për veprimtarinë e KMD-së dhe në veçanti për kompetencat e KMD-së.

- Më 14 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online në Zoom me temë: *"Standartet e Punës me Dhunuesit"*, në kuadër të projektit *"Një Burrë i vërtet nuk lëndon një Grua"*, organizuar nga LKBD dhe financuar nga IAMANEH Zvicër.
- Më 16 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në sesionin informues online, organizuar nga FSHDPAK në kuadër të projektit: *"Mbështetje e vazhdueshme për shërbim cilësor dhe të pandërprerë të ndihmës juridike falas në qarkun e Fierit"*, i cili u fokusua në ndihmën juridike që i ofrohet personave me aftësi të kufizuara; mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, përmes financimit të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA).
- Më 19 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online në Zoom, me Komisionerin dhe DPA-në, në kuadër të objektivave të institucionit për vitin 2021 dhe diskutimit të problematikave të ndryshme.
- Më 20 Prill, specialisti i Zyrës Rajonalerealizoi një takim pune me Koordinatorin e PKG (Platfotma Kombëtare për Gratë) dhe nismës për të rinjtë znj. K.Zika, me qëllim inspektimi i një rasti të adresuar nga mediat lokale; ku u diskutua një problematikë konkrete e disa banorëve të njesisë administrative Bubullimë, Bashkia Lushnje.
- Më 20 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale priti në zyrë, në një takim pune përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlorë, ku ndër të tjera pati konsultim për zgjidhjen e një rasti konkret të një subjekti dhe ku u diskutuan problematikat e rasteve të adresuara.
- Më 22 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Inteligjenca emocionale dhe vazhdimësia"*, organizuar nga ASPA.
- Më 23 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin e organizuar nga OJF-ja PKG (Platforma Kombëtare për Gratë) në bashkëpunim me KRIIK Albania, në kuadër të nismës *"Të rinjtë për Integritetin"*, me mbështetje të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë. Në takim u diskutua për aksesueshmërinë e personave PAK në procesin e votimit.
- Më 28 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në konferencën online në Zoom me temë: *"Drejt përmirësimit të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës"* organizuar nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqiperinë në bashkëpunim me Olofe Palm Center dhe qendra për të Drejtat në Punë.
- Më 28 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin online me temë: *"Aspekte të zbatimit të nenit 48 të Konventës së Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"*, organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në kuadrin e projektit: *"Mbështetje Rrjetit të Monitorimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore"*, i cili financohet nga Komisioni Evropian dhe zbatohet me mbështetjen e UN Women.
- Më 29 Prill, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Përdorimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nga nëpunësit publik"*, organizuar nga ASPA.

- Më 30 Prill Specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në takimin e prezantimit të gjetjeve të studimit kombëtar: *“Dhuna në marrëdhëniet intime dhe dhuna seksuale tek të rinjtë në Shqipëri”*, organizuar nga AWEN-Albanian, Women Empowerment Network, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze.
- Gjatë muajit Prill, specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur konsultime me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në Vlorë dhe Berat, në lidhje me rastet e paraqitura pranë tyre, si edhe janë zhvilluar takime të vazhdueshme me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që operojnë në Qarkun e Fierit dhe bashkitë përreth. Po ashtu, dhënie asistence në plotësimin e formularit, sipas rubrikave përkatëse, për ankuesit që i janë drejtuar zyrës.

Maj

- Më 4 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në aktivitetin përmbyllës të projektit: *“Aktivizëm qytetar dhe pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes në nivel vendor i familjeve të pastreha”*, organizuar nga Lëvizja Rinore Egjiptiane & Rome në partneritet me Qendrën për Advokim Social, financuar nga *“Lëviz Albania”*.
- Më 5 maj, specialisti i Zyrës Rajonale zhvilloi trajnimin me temë: *“Mbrojtja nga Diskriminimi në Fushën e Punësimit, Diskriminimi Gjinnor”*. Ky takim u fokusua në njohjen dhe informimin mbi Ligjin “Per mbrojtjen nga diskriminimi”, ku mund të drejtohem në rast se ndihemi të diskriminuar në fushën e punësimit dhe jo vetëm; fazat dhe procedurat e një ankese si edhe masat që meren nga Komisioneri në rastet e trajtimit të ankesave me pretendim diskriminim. Target grup i këtij trajnimi ishin gra dhe vajza të cilat merrnin kurse profesionale pranë Pastërisë Sociale “Che Buono” (shoqatë e cila ka në fokus gratë dhe formimin profesional në fushën e pastërisë). Në këtë takim ishte e ftuar dhe përfaqësuesja e Ndihmës Juridike Falas në Fier e cila foli për shërbimet që ofrohen nga kjo zyrë.
- Më 10 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale priti në zyrë E.D., punonjës social pranë Qendrës Sociale “Murialdo”. Qëllimi i takimit kishte në fokus bashkëpunimin me Zyrën Rajonale për të realizuar disa takime sensibilizuese dhe informuese në disa komunitete Rome në qarkun e Fierit.
- Më 11 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Hartimi i indikatorëve të ndjeshëm gjinnorë”*, organizuar nga ASPA.
- Më 12 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në aktivitetin me temë: *“Adresimi i gjuhës së urrejtjes nga lidhësi politik në Shqipëri, angazhimi qytetar, Politika dhe Përfaqësimi”*, organizuar nga OMSA në bashkëpunim me organizatën Rajonale ERA- LGBTI Equal Rights Association.
- Më 14 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Të drejtat që mund të kufizohen gjatë gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”*, organizuar nga ASPA.
- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Siguria Kibernetike në Punë”*, organizuar nga ASPA.
- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin online me temë: *“Matja dhe Vlerësimi i Impaktit të punës së OSHC-ve”*, organizuar nga Qendra Kombëtare e Burimeve për Shoqërinë Civile në Shqipëri.

- Më 17 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin rajonal online me temë: *"LGBTI duhen trajtuar si individ"* - me pjesëmarrjen e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, Avokatit të Popullit Republika e Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësive të huaja diplomatike në Shqipëri, si dhe zyra rajonale të KMD-së. Në këtë takim pjesëmarrësit patën mundësi të shkëmbenin mendime, ide për të luftuar Diskriminimin ndaj komunitetit LGBTI dhe promovuar barazinë.
- Më 18 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin me temë: *"Let's Talk About the Rainbow"*, organizuar nga OMSA dhe mbështetur nga Ambasada Hollandeze në Shqipëri. Në këtë takim u diskutua për të Drejtat e Njeriut të Personave LGBTI në Shqipëri.
- Më 19 Maj, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, Zyra Rajonale Fier e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bashkëpunim me Zyrën e Ndihmës Juridike Falas dhe Organizatën *"Act Now Albania"*, zhvilluan aktivitetin me temë: *"Respektimi i të drejtave të komunitetit LGBTI dhe pranimi në shoqëri"*. Ky takim u zhvillua me pjesëmarrjen e aktorëve lokalë, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe një grup të rinjsh, nxënës të shkollës së mësme *"Janaq Kilica"*, në Fier. Në këtë aktivitet pjesëmarrësit u njohën me veprimtarinë e KMD-së si edhe patën mundësi të shkëmbenin mendime e të përcillnin mesazhe për diversitetin si pjesë e jetës, pjesë e të qenit të ndryshëm, por të barabartë.
- Më 21 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë online në Konferencën me temë: *"Bota e Punës drejt Integritetit Europian-Rritja e dialogut social dhe përmirësimi i politikave të punësimit në Shqipëri në procesin e Integritetit Europian"*, organizuar nga Qendra për të Drejtat në Punë, CLR.AL.
- Më 25 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin me temë: *"Fuqizimi i marrëdhënieve familjare përmes aktiviteteve gjithpërfshirëse"*, realizuar nga Qendra Sociale *"Murialdo"*, mbështetur përmes programeve të migracionit nga GIZ Albania dhe Terre des Homes. Në këtë aktivitet ishin të ftuar Ndihma Juridike Falas dhe Zyra Rajonale Fier e KMD-së, të cilët prezantuan funksionin dhe veprimtarinë e institucioneve përkatëse. Takimi u zhvillua me pjesëmarrjen e prindërve, fëmijëve dhe të rinj të komunitetit Rom të fshatrave Drize, Levan si dhe Koordinatorja e Banesave Sociale, në qytetin e Fierit.
- Më 26 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin përmbyllës me temë: *"Prezantim të gjetjeve të studimit i lidhur me aksesin në energjinë elektrike të familjeve në nevojë"*, në kuadër të projektit *"Për drejtësi më të aksesueshme për gratë dhe burrat në Shqipëri"*, i cili po zbatohet në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Qendra *"T'reja"*, financuar nga UNDP. Takimi u realizua me pjesëmarrjen e komunitetit Rom në fshatin Drizë, të njësisë administrative Qendër, Bashkia Fier.
- Më 27 Maj, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me Zyrën e Ndihmës Ligjore Falas, organizuan *"ditë të hapura"* me komunitetin Rom, në fshatin Hamil të njësisë administrative Qendër, Bashkia Fier; me fokus informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për luftën kundër diskriminimit si dhe qasja ndaj institucioneve përkatëse për zgjidhjen e problematikave dhe adresimin e çështjeve diskriminuese.

- Gjatë muajit Maj, specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur komunikime të vazhdueshme me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në Vlorë, Berat dhe Sarandë si edhe me OSHC-të në Fier, po ashtu ka pasur takime pune me Monitoruesen e PNUD dhe Juristen e Ndhmës Ligjore Falas; si edhe telefonatat nga publiku për informim në lidhje me procedurën e ankesës, si dhe çështje që lidhen me diskriminimin. Po ashtu gjatë këtij muaji specialisti i zyrës Rajonale ka shpërndarë materiale informuese të KMD-së.

Qershor

- Më 1 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me Psikologun N.S., e cila referoi një rast diskriminimi pranë KMD.
- Më 2 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim pune me Av. A.Xh., i cili kërkoi informacion në lidhje me veprimtarinë dhe kompetencat e KMD-së.
- Më 8 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim pune me Sekretarin e Përgjithshëm të Prefekturës Fier, ku u diskutua për tu bërë pjesë e “tryezës antitrafik” ku janë të përfshira të gjitha njësitë e shërbimit social.
- Më 11 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me Qendrën Sociale Murialdo, organizuan aktivitetin me temë: “Të drejtat e fëmijëve”, me rastin e 12 qershorit, *"Ditës Ndërkombëtare kundër Punës së Fëmijëve"*. Ky aktivitet u zhvillua në Qendrën Komunitare Drizë, Njësia Administrative Qendër, në Bashkinë Fier, me pjesëmarrjen e Zyrës së Ndhmës Ligjore Falas, aktorëve lokal si dhe prindër e fëmijë të komunitetit rom. Aktiviteti kishte si qëllim ndërgjegjësimin e prindërve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve, në identifikimin në mënyrë aktive të rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve në punë, si dhe trajtimi i tyre duke ndërmarrë veprime konkrete për çdo rast të raportuar.
- Më 17 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale, ka ndjekur online konferencën *“Përpyjekje të Përbashkëta për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri”*, organizuar nga *Prezenca e OSBE-në Shqipëri*, me pjesëmarrjen e Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri; Zëvendësministria e Brendshme e Shqipërisë; Ambasadorja Suedeze kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Përfaqësuesi i Posaçëm dhe Koordinatori i OSBE-së për luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore; Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri; Ambasadori i Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.
- Më 18 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin e zhvilluar nga Bashkia Fier, në kuadër të projektit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit me UNDP-në, për riintegrimin dhe përfshirjen sociale të familjeve të rikthyera nga migracioni, pjesë e komunitetit Rom dhe Egjiptian.
- Më 21 Qershor, pati një vizitë në Zyrën Rajonale Fier nga përfaqësuese të PNUD-it në kuadër të bashkëpunimit dhe adresimit të problematikave dhe çështjeve diskriminuese që prekin komunitetin Rom në qarkun e Fierit.
- Më 23 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Menaxhimi i aseteve të vetëqeverisjes vendore”*, organizuar nga ASPA.

- Më 24 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Shërbimi i ndihmës juridike parësore: parimet dhe kategoritë përfituese"*, organizuar nga ASPA.
- Më 24 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Etika, Normat Sociale dhe Korrupsioni në Administratën Publike"*, organizuar nga ASPA.
- Më 25 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Natyra e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë"*, organizuar nga ASPA.
- Më 28 Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Zhvillimi i sigurisë profesionale dhe ndërtimi i besimit (vetë-besimit)"*, organizuar nga ASPA.
- Gjatë muajit Qershor, specialisti i Zyrës Rajonale ka dhënë asistencë në plotësimin e formularit, sipas rubrikave përkatëse, për ankuesit që i janë drejtuar zyrës. Informim dhe sqarim në lidhje me procedurën e ankesës. Gjithashtu ka pasur komunikim të vazhdueshëm me përfaqësues të Avokatit të Popullit në Vlorë dhe Sarandë, me Zyrën Ligjore Falas, OJF-të, me qëllim referimin e çështjeve reciproke si edhe komunikime me institucionet lokale.

Korrik

- Më 1 Korrik specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Roli i të rinjve në vetëqeverisjen vendore"*, organizuar nga ASPA.
- Më 2 Korrik specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Prezantimi i ligjit të ri për Mbrojtjen e të Dhënave personale i përafuar me EU ACQUIS"*, organizuar nga ASPA.
- Më 5 Korrik specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Përdorimi i metodave statistikore në punën e përditshme"*, organizuar nga ASPA.
- Më 7 Korrik specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve civile mbi buxhetim me pjesëmarrje gjinore dhe të bazuar në rezultate"*, organizuar nga ASPA.
- Më 12 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur në zyrë ankuesen B.L., për t'i përcjellë shkresën e OSSH sh.a., dërguar KMD-së, lidhur me ankesën e saj drejtuar KMD.
- Më 12 Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me operatoren në Zyrën e Kujdesit ndaj Klientit të OSSH sh.a., për të arritur në një marrëveshje për zgjidhjen e situatës së ankuseses znj. B.L.
- Gjatë muajit Korrik, specialisti i Zyrës Rajonale ka shpërndarë për informim dhe ndërgjegjësim materiale të KMD-së si dhe ka komunikuar dhe pritur telefonata nga ankues për dhënie informacioni lidhur me rastet e adresuara prej tyre. Gjithashtu ka pasur konsultime me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit Vlorë, lidhur me raste të adresuara pranë saj, kryesisht për procedurat dhe afatet gjatë hetimit administrativ të ankesave të mara në shqyrtim nga KMD.

Gusht

- Gjatë muajit Gusht specialisti i Zyrës Rajonale ka organizuar takime të ndryshme, të cilat janë në funksion të punës së përditëshme, ka dhënë informacion rast pas rasti për plotësimin e formularit të ankesës sipas rubrikave përkatëse, po ashtu ka pritur në zyrë subjekte të cilët kanë marrë informacionin e kërkuar, përfshirë konsulencë apo orientim drejt institucioneve përkatëse për të marrë shërbimin e kërkuar. Gjithashtu gjatë këtij muaji ka pasur komunikim me median lokale, për gjetje të kontakteve, për rastë të pasqyruara nga kjo e fundit, të cilat mund të ishin çështje referimi pranë KMD-së, si dhe komunikim të vazhdueshëm me zyrat rajonale të Avokatit të Popullit si dhe Zyrën e Ndhmës Juridike Parësore Falas.

Shtator

- Më 3 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve mbi ndryshimet ligjore lidhur me barazinë gjinore në të drejtat pronësore"*, organizuar nga ASPA.
- Më 9 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale priti në zyrë përfaqësuesen e Avokatit të Popullit Vlorë dhe në bashkëpunim kanë realizuar inspektime në institucionet lokale, për qasjen e PAK në marjen e shërbimeve të ndryshme në institucione, (pajisje me rampe apo shirita për të verbërit).
- Më 10 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve gjinorë mbi statistikat gjinore dhe indikatorët e ndjeshëm gjinorë"*, organizuar nga ASPA.
- Më 10 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: *"Përmirësimi i standarteve të të drejtave të njeriut brenda dhe jashtë sistemit penitenciar në Shqipëri"*, organizuar nga Qendra Europiane dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), me mbështetjen financiare të BE-së, në kuadër të projektit *"Përmirësimi i standarteve të të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar në Shqipëri"*.
- Më 13 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve mbi shërbimin e ndërmjetësimit si mjet alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve"*, organizuar nga ASPA.
- Më 14 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim në Drejtorinë Rajonale të OSSH sh.a., lidhur me rastin e shtetases B.L., e cila ka bërë ankesë pranë KMD-së, në mënyrë për të arritur një zgjidhje të situatës me ndërmjetësim.
- Më 15 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me znj. I.M., përfaqësuese e UNDP-së pranë Zyrës Ligjore Falas, me qëllim planifikimin dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- Më 17 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: *"Ngri zërin kundër gjuhës së urrejtjes"*, në kuadër të projektit me të njëjtin titull, organizuar nga Fondacioni Qendra Europiane, një organizatë jo-fitimprurëse që punon në fushën e të drejtave të njeriut, me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe Delegationit të Bashkimit Evropian.
- Më 20 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve gjinorë mbi analizën gjinore"*, organizuar nga ASPA.

- Më 21 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me operatorin e KNK-së (kujdesi ndaj klientit) në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar nga ankuesja B. L.
- Më 22 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Edukimi ligjor i nëpunësve publike: mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit në kuadër të ndihmës juridike parësore”*, organizuar nga ASPA.
- Më 22 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin online me temë: *“Ndërveprimi i aktorëve lokalë mbi frekuentimin shkollor të grupeve vulnerabel”*. Ky takim u realizua nga Qendra Sociale Murialdo në kuadër të projektit *“Mbështetje emergjence dhe rimëkëmbje për fëmijët dhe familjet e prekura nga situata pandemike e COVID-19 në Shqipëri”*, ku u diskutua mes aktorëve lokale mbi situatën aktuale të integritetit të fëmijëve në institucionet arsimore, me qëllim forcimin e rrjetit të bashkëpunimit për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të fëmijëve në situatë rruge.
- Më 23 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në *“Takimin informues mbi veprimtarinë e Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier dhe Kategoritë e Qytetarëve që përfitojnë nga ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*. Ky takim u realizua nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Bashkia Patos, ku pjesë e panelit ishte dhe Zyra Rajonale Fier, e cila bëri një prezantim informues dhe ndahu raste suksesi të trajtuara nga KMD.
- Më 27 Shtator, në ambjentet e Zyrës Rajonale Fier, pati një vizitë nga një grup të rinjsh të komunitetit Rom, me qëllim njohjen me të drejtat e fëmijëve, kompetencat dhe funksioni që ka KMD si dhe roli i Zyres Rajonale. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit *“Mbështetje emergjente dhe rimëkëmbje për fëmijët dhe familjet e prekura nga situata pandemike COVID-19 në Shqipëri”*, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Misioni Terre des Hommes në Shqipëri.
- Më 29 Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Edukimi ligjor i nëpunësve civilë mbi kuadrin ligjor dhe procedural për mbrojtjen nga diskriminimi”*, organizuar nga ASPA.
- Gjatë muajit Shtator, specialisti i Zyrës Rajonale ka pasur telefonata pune në kuadër të veprimtarisë së përditshme në zyrë, konsultime me ankuesit, komunikime me Qendra Komunitare, Organizata të Shoqëris Civile, Zyren Rajonale të Avokatit të Popullit në Vlorë, për pjesëmarrje në aktivitete.

Tetor

- Më 5 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me zyrën Ligjore Falas, realizoi një ditë të hapur në Qendrën Komunitare Levan; me qëllim njohjen me veprimtarinë e KMD-së, shërbimet që ofrohen nga të dy zyrat (ZR Fier dhe Zyra Ligjore Falas), si dhe marrjen e ankesave. Takimi u mbyll me diskutimin e rasteve personale të pjesëmarrësve.
- Më 6 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me Kryetarin e Shoqatës së Invalidëve Bashkia Patos, z. N. G, konsultim mbi disa raste të caktuara.

- Më 12 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Puna në distancë gjatë periudhës së pandemisë Covid -19 dhe rregullat në lidhje me përpunimin e të dhënave personale"*, organizuar nga ASPA.
- Më 13 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim pune me Av.R.M dhe përfaqësuesen e Ndihmës Juridike Falas, ndër të tjera është diskutuar në lidhje me rastin e një subjekti, referuar Zyrës Ligjore Falas.
- Më 19 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Korrupsioni dhe diskriminimi ndaj grave dhe vajzave"*, organizuar nga ASPA.
- Më 21 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka pritur në zyrë (ditë të hapur), përfaqësuesen e Avokatit të Popullit Vlorë si edhe Juristen e Ndihmës Juridike Falas, ku kanë bërë pritje me subjekte dhe referim ankesash nga ana e ZR Fier. Gjithashtu ka pasur konsultime për çështje, ankesa dhe problematika të ndryshme.
- Më 22 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Korrupsioni dhe diskriminimi në bazë të rracës dhe përkëtesisë etnike"*, organizuar nga ASPA.
- Më 27 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me specialisten e marrëdhënieve me publikun znj. A.A., në Zyrën e Punës. Qëllimi takimit ishte bashkëpunimi në evidentimin e rasteve të diskriminimit si dhe pjesëmarrja në aktivitete.
- Më 29 Tetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin informues dhe ndërgjegjëses, në shkollën 9 vjeçare "Dino Ismaili" Levan, me temë: *"Antitrafikimi i qënieve njerëzore"*, organizuar nga Qendra Sociale Murialdo. Në këtë aktivitet morën pjesë dhe aktorë të tjerë të pushtetit vendor për të informuar nxënës dhe mësues mbi trafikimin dhe njohjen e sistemit të mbrojtjes kundër Trafikimit të personave.

Nëntor

- Më 1 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale realizoi një takim me koordinatoren e Grupimit të sindikatave në Shqipëri z. M.Z. Informacion dhe kosulencë në lidhje me një çështje.
- Më 4 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale në bashkëpunim me Zyrën e Ndihmës Juridike Parësore Falas, organizuan një orë mësimore me nxënës të shkollës profesionale "Murialdo", dega "Menaxhim zyre". Zyra Rajonale bëri një prezantim të zyrës dhe Ligjit të Mbrojtjes nga Diskriminimi, shpjegoi mënyrën se si mund të plotësohet një formular ankese me gjithë rubrikat përkatëse, afatet dhe procedurat e hetimit administrativ të ankesës. Gjatë orës mësimore nuk munguan dhe pyetjet nga nxënësit të cilët patën interes për KMD-në.
- Më 4 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve publikë mbi njohjen e Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut"*, organizuar nga ASPA.
- Më 10 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Edukimi ligjor i nëpunësve civil mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut"*, organizuar nga ASPA.
- Më 12 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në inagurimin e inkubatorit për përpunimin e produkteve bujqësore, pranë Shkollës Bujqësore "Rakip Kryeziu", Fier.

Kjo nismë zhvillohet nga ENGIM në kuadër të projektit RISE-Alb, i financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim – AICS; si një mundësi punësimi për të rinjtë, veçanërisht të papunët dhe me aftësi ndryshe dhe garantimin e qasjes në treg të perimeve dhe frutave të freskëta të prodhuara në qarkun e Fierit.

- Më 18 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale, realizoi një takim me specialistin e ISSH-së Fier, lidhur me problematikën e subjektit G.P., për kompensim të energjisë elektrike, për shkak se kryefamiljari i papunë dhe jo në moshë për përfitimin e pensionit të pleqërise, kishte vajzën me aftësi të kufizuara. Pas takimit me specialistin e ISSH-së, subjekti u sqarua se nuk përmbushte kriteret ligjorë për përfitimin e kompensimit të energjisë elektrike në bazë të VKM Nr. 565 datë 09.08.2006 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”*.
- Më 19 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në takimin me Aktorët Lokal Fier për të reflektuar rreth problematikave dhe sfidave të Fëmijëve Rom në Kopësht dhe Shkollë. Ky takim u zhvillua në kuadër të projektit *“Kujdesi dhe zhvillimi i hershëm i fëmijëve në Shqipëri, për fëmijët romë/egjiptianë”* në Bashkinë Fier, implementuar nga organizata *Save the Children*.
- Më 24 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale, realizoi një takim me Drejtorin e Qendrës multifunkionale Horizont, me qëllim ftesën për pjesëmarrje në aktivitetin sensibilizues me rastin e Ditës ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar.
- Më 25 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale, në kuadër të ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore, mori pjesë në marshimin sensibilizues me slogane kundër dhunës ndaj grave, organizuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Fier.
- Më 26 Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin me temë: *“Roli i njësive administrative në identifikimin, referimin dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje”*, organizuar nga Bashkia Rroksvec me pjesëmarrjen e Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Patos; Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier; Sektori i Shërbimit Social, Bashkia Rroksvec, si edhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare.
- Gjatë muajit Nëntor, specialisti i Zyrës Rajonale ka shpërndarë materiale informuese të KMD-së, gjithashtu ka pritur telefonata nga subjekte të interesuar për procedurat e ankesës si edhe afatet dhe fazat e hetimit administrativ të ankesës.

Dhjetor

- Më 1 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale, realizoi një takim pune me kryetaren e shoqatës “Varga” (OJF), Lushnje, znj. Blerina Petro, në kuadër të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes në aktivitete të përbashkëta.
- Më 3 Dhjetor, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Qendrën Kulturore për Fëmijë, organizuar nga Qendra Multifunkionale Horizont, Bashkia Fier, me pjesëmarrjen e gjithë aktorëve lokalë.
- Më 3 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *“Masat ligjore dhe politikat institucionale për parandalimin dhe luftimin e seksizmit në sektorin publik”*, organizuar nga ASPA.

- Më 3 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në trajnimin me temë: *"Të drejtat e fëmijëve"*, organizuar nga Avokati Popullit.
- Më 6 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale, mori pjesë në *Konferencën Kombëtare* me temë: *"Nxitja e Integritetit në Nivel Lokal në Shqipëri"*, i cili u mbajt në qytetin e Vlorës, në kuadër të Javës së Integritetit 1-10 dhjetor 2021. Ky aktivitet u organizua nga Rrjeti *"Përballja e Ofertave Politike"* (POP), në bashkëpunim me Ambasadën e Suedisë në Tiranë, mbështetur nga Olof Palme International Center. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga 12 bashkitë, ku rrjeti POP zhvillon aktivitetet e tij në kuadër të Kontratës Sociale: Tiranë, Durrës, Pukë, Kukës, Vlorë, Fier, Pogradec, Kamëz, Shkodër, Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë.
- Më 7 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një takim me Drejtorin e Shërbimit Social, Njësia Administrative Qendër, konsultim lidhur me një rast paraqitur pranë kësaj drejtorie.
- Më 9 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale ka ndjekur online në platformën zoom, *Tryezën Rajonale të të Drejtave të Njeriut*, organizuar nga Prezenca e OSBE në Shqipëri, në prag të Ditës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut. Përfaqësues nga Ballkani Perëndimor diskutuan për rolin dhe ndërveprimin mes tyre lidhur me proceset gjyqësore.
- Më 10 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale, në bashkëpunim me zyrën e Ndihmës Juridike Falas, ka organizuar një takim informues dhe ndërgjegjësues me punonjës të një fasonerie në Fier.
- Më 14 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në webinarin me temë: *"Understanding and Implementing EU Policies in the national context"*, *"Kuptimi dhe zbatimi i politikave të BE-së në kontekstin kombëtar - Kërkesat e Kapitullit 23 dhe Kapitullit 24 në kontekstin shqiptar"*, organizuar nga ASPA.
- Më 16 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në Webinarin me temë: *"Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë"*, organizuar nga ASPA.
- Më 16-17 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në platformën zoom në trajnimin me temë: *"Monitorimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri"*, organizuar nga OSCE.
- Më 20 Dhjetor, specialisti i Zyrës Rajonale mori pjesë në platformën zoom në trajnimin me temë: *"Monitorimi i gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit me bazë gjinore në Shqipëri"*, organizuar nga OSCE.

Rastet e Ndërmjetësimit, ndihma dhe këshillimi ligjor i realizuar nga Zyra Rajonale Fier.

- Pranë Zyrës Rajonale Fier, u paraqit ankuesja M.A., bashkëshorti i së cilës kishte ndërruar jetë, nënë e vetme me 2 fëmijë (mosha 15 dhe 17 vjeç). Me vdekjen e bashkëshortit vetëm njëri nga fëmijët përfitonte pension familjar nga sigurimet shoqërore. Zyra Rajonale komunikoi me specialistë të ISSH-së si dhe me Juristen e Drejtorisë Rajonale të ISSH-së në lidhje me situatën. Ankuesja u sqarua në lidhje me rastin dhe të dy fëmijët përfitojnë pension familjar në bazë të viteve të punës së të ndjerit.

- Gjatë vitit 2021 Zyra Rajonale Fier ka organizuar takime të ndryshme, të cilat janë në funksion të punës së përditëshme, po ashtu ka organizuar ditë të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim, si dhe janë shpërndarë materiale promovuese.
- Zyra Rajonale Fier, gjatë kësaj periudhe ka pritur subjekte të interesuar për të marrë informacion për mënyrën e paraqitjes së një ankese, procedurën që ndjek institucioni, kriteret ligjore që duhen plotësuar nga ankuesi, si dhe asistencë në plotësimin e formularit të ankesës sipas rubrikave përkatëse, si edhe komunikim i vazhdueshëm me ankuesit gjatë gjithë procedurës administrative të ankesës.
- Po ashtu, kontaktet e Zyrës Rajonale Fier me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në qytetet Vlorë, Berat, Sarandë janë të vazhdueshme, bashkëpunimi ndërmjet zyrave ka konsistuar kryesisht në referimin e ndërsjelltë të rasteve konkrete por edhe për pjesëmarrje në aktivitete të përbashkëta.
- Një bashkëpunim tjetër, kryesisht në organizimin e aktiviteteve informuese dhe sensibilizuese, ka qenë ndërmjet Zyrës Rajonale Fier dhe Zyrës së Ndihmës Ligjore Parësore Falas Fier, po ashtu ka pasur komunikim të vazhdueshëm me Zyrat e Ndihmës Juridike Falas në qytetin e Lushnjes dhe të Vlorës, në kuadër të konsultimeve të rasteve konkrete apo referim çështjesh.

Gjatë vitit 2021 janë përgatitur dhe përcjellë për kompetencë nga Zyra Rajonale Fier:

- 8 (tetë) ankesa drejtuar Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas Fier;
- 4 (katër) ankesa drejtuar përfaqësueses së Avokatit të Popullit Vlorë;
- 18 (tetëmbëdhjetë) konsulenca ligjore dhe orientime në institucione përkatëse;
- Përfaqësuesja e Avokatit të Popullit Berat i ka përcjellë për kompetencë shqyrtimi ZR Fier, 2 (dy) ankesa.
- Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit Sarandë i ka përcjellë për kompetencë shqyrtimi ZR Fier, 1 (një) ankesë.

5. Aspekte të Shërbimeve

5.1 Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2021

- I. Janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve për vitin 2021, si dhe janë dorzuar pranë ILDKPKI- së dektarat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve ligjore për vitin 2020.
- II. Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara me anë të webinarëve nga, Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera.
- III. Në trajnimin e organizuar me webinar nga ASPA dhe institucione të tjera janë trajtuar tema si:
 - “Statistikat Përshkruese”
 - “Hartimi i Projekteve”
 - “Planifikimi dhe fazat e prokurimit publik”
 - “Vendimarrja racionale në administratën publike”
 - “Procedimi disiplinor në shërbimin civil”
 - “Sjellja organizative në administratën publike”
 - “Konsultimi public në kohe pandemie”
 - “Kriteret kryesore për hartimin e titullit të dosjeve arkivore”
 - “Modelet e marrjes së vendimeve në administratën publike”
 - “Lidershipi dhe karakteri”
 - “Komunikimi efektiv me median”
 - “Organizimi i dosjes së personelit”
 - “Teknikat e menaxhimit të konfliktit në administratën publike”
 - “Parandalimi i konfliktit të interesit”
 - “Menaxhimi i ndryshimeve në procesin e monitorimit”
 - “Disiplina në shërbimin civil”
 - “Konceptet kryesore të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe monitorimin e tij”
 - “Natyra e vendimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë.”
 - “Zbatimi i reformës në shërbimin civil”
 - “Karakterit strategjik i projekteve”
 - “Puna në distance gjatë covid- 19”
 - “Parimet e Kodit të Procedurave Administrative”
 - “Parimet e ligjit të shërbimit civil dhe perfundimi i mardhënieve në shërbimin civil”
 - “Plotësimi i deklaratave të pasurisë dhe interesave private në formatin elektronik”.

IV. Punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikatat më të mira si dhe në aktivitete të ndryshme të organizuarë në fushën e të drejtave të njeriut/diskriminimit me tema:

- "Planifikimi dhe fazat e prokurimit publik"
- "Statistikat përshkruese"
- "Aftësia e kufizuar dhe ligji për mbrojtjen nga diskriminimi"
- "Akti administrativ sipas Kodit të Procedurave Administrative"
- "Arsyet e klasifikimit të informacionit".
- "Barra e proves në rastet e diskriminimit në administratën publike"
- "Buxheti i përgjithshëm gjinor në nivel lokal"
- "Covid-19, Reagimi gjithëpërfshirës për aftësinë e kufizuar"
- "Edukim ligjor i nëpunësve civile: Të drejtat pronësore të grave"
- "Edukimi ligjor i nëpunësve civil mbi Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut"
- "Edukimi ligjor i nëpunësve civil mbi kuadrin ligjor dhe procedural për mbrojtjen nga diskriminimi"
- "Edukimi ligjor i nëpunësve civil mbi statistikatat dhe indikatorët e ndjeshëm gjinor"
- "Edukimi ligjor i nëpunësve mbi ndryshimet ligjore lidhur me barazine gjinore në të drejtat e pronësisë"
- "Edukimi ligjor i nëpunësve publikë mbi njohjen e Gjykatës Evropiane të të drejtave të njeriut".
- "Hartimi i indikatorëve të ndjeshëm gjinorë"
- "Korrupsioni dhe diskriminimi ndaj vajzave dhe grave"
- "Korrupsioni dhe diskriminimi në bazë të races dhe përkatësisë etnike"
- "Kuptueshmëria dhe mirë administrimi i procedurave administrative".
- "Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale"
- "Mbi qeverisjen e migracionit në Shqipëri"
- "Mbrojtja e të drejtave të njeriut në BE"
- "Menaxhimi i ndryshimeve në procesin e monitorimit"
- "Nocioni i Diskriminimit në administratën publike"
- "Parandalimi i seksizmit dhe dhunës ndaj grave"
- "Përdorimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të njeriut nga nëpunësit publikë"
- "Përdorimi i informacionit të klasifikuar në procese gjyqësore"
- "Politikat e zgjerimit të BE dhe negociatat për anëtarësim"
- "Procedura për ndjekjen e rasteve të diskriminimit në administratën publike"
- "Programi i angazhimit qytetar për përparimin e të drejtave të komunitetit LGBTI, në Shqipëri, politika dhe përfaqësimi"
- "Risitë e Kodit Zgjedhor në fushën e barazisë gjinore"
- "Risitë e legjislacionit të prokurimit" dhe "Procedurat e prokurimit dhe ankimimi administrativ"

- “Roli i aktorëve në nivel lokal për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm në Shqipëri”
- “Shërbimi i ndihmës juridike parësore, parimet dhe kategoritë përfituese”
- “Sigurimi i informacionit të klasifikuar”
- “Sistemi elektronik i prokurimit”
- “Të drejtat e subjekteve të të dhënave personale”
- “Teknikat e menaxhimit të konfliktit në administratën publike”
- “Vetqeverisja vendore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”
- “Mbrojtja e të drejtave të njeriut në BE”.

V. Punonjësit e Zyrës Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me tema:

- “Java kunder Diskriminimit”
- “Transporti për personat me aftësi të kufizuara”
- “Monitorimi i perfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në palestra”
- “Takim nga Equinet Working Group on Research and data collection”
- “Takim Rajonal LGBTI”
- “Për standartin e minimumit jetik në Shqipëri”
- “Transporti gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara”
- “Përtej përkufizimeve, thirrje kundër gjuhës së urrejtjes në Shqipëri”
- “Monitoring hate speech and gender-based discrimination in Albania”.

5.2 Menaxhimi i burimeve financiare

Në zbatim të Ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2021”, Komisioneri raporton mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2021, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej **58.815,96 (në mijë lekë)** për vitin 2021. Totali i vlerës së akorduar përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	35. 000	<i>mijë lekë (zëri 600)</i>
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	6. 000	<i>mijë lekë (zëri 601)</i>
Fondi për Shpenzime Operative:	10. 868,21	<i>mijë lekë (zëri 602-606)</i>
Fondi për Investime:	4. 000	<i>mijë lekë (zëri 231)</i>
Fondi i donatorëve:	3. 799,67	<i>mijë lekë (zëri 602)</i>

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është 59.667,88 (në mijë lekë), për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore 56.771,95 (në mijë lekë) ose **95,15 %** të buxhetit të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600 - 601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 "*Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar, numri mesatar i punonjësve është realizuar 33 nëpunës, nga 34 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej 41.000 (në mijë lekë) për këtë periudhë, është realizuar 39.644,56 (në mijë lekë) për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **96,69 %** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2021, është planifikuar në vlerën 10.868,21 (në mijë lekë). Për periudhën respektive është realizuar vlera prej 9.872,95 (në mijë lekë) ose **90,84 %**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231); nga vlera e përgjithshme prej 4.000 (në mijë lekë) për periudhën e raportuar, është realizuar vlera prej 3.861,28 (në mijë lekë) ose **96,53 %**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi i Donacioneve (zëri 602); për vitin 2021, është në vlerën 3.799,67 (në mijë lekë). Për periudhën respektive është realizuar në projektin me UNDP (Qershor 2020 - Maj 2021), vlera prej 2.303,17 (në mijë lekë) dhe në projektin me AMA (2021), vlera prej 1.089,98 (në mijë lekë) ose të marra së bashku **89.30 %**, e fondit të planifikuar.